Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 4 (199) PRILL - MAJ 2023. ÇMIMI: 50 LEKË. 0,5 €

BIG market
PESHKOPI MAQELLARË
Plot oferta dhe surpriza...

VENDLINDJA

Peladhia, fshati magjik rrëzë Temlës

Nga **ADRIATIK BALLA** — Faqe 12

HISTORI

6 maj, Dita Emrit të Gjergj Kastriotit

Këshilli Bashkiak i Dibrës vendos ta kthejë këtë datë në një festë të përvitshme — Faqe 5

PROFIL

Jeta dhe puna e Petrit Ramës, shembulli për t'u ndjekur

Nga **SHAQIR SKARRA** — Faqe 17

BOTIME

Eseistika e Kadaresë, libri i ri i Xhafer Martini

— Faqe 18

BELINDA BALLUKU, ZV. KRYEMINISTRE DHE MINISTRE E INFRASTRUKTURËS UDHËTON NË TUNELIN E MURRIZIT:

"Tuneli në 400 metrat e fundit, por nuk japim afate për mbarimin"

BALLUKU: "Studimi gjeologjik i cekët. Ecuria tani është konstante dhe ka rëndësi që të përfundojë hapja e tunelit. Ne sërish nuk do të japim afate për tunelin e Murrizit, pasi ky është rast, që siguria rrugore, çështjet e sigurisë në të ardhmen, janë shumë më të rëndësishme se dëshira për të mbaruar sa më shpejt".

BERBERI: "Gjatë kësaj vere kemi një përfundim total të punës në të gjitha kantieret e ngritura, përjashtuar tunelin. Në fund të muajit korrik, javën e parë të muajit gusht, ne hapim përfundimisht për regjimin e trafikut të plotë, rrugën nga dalja e tunelit në shkallën e Tujanit deri në Murriz dhe nga dalja e tunelit deri në Maqellarë." — FAQE 2

TURIZËM

Ngjitje në Korab, emocione që nuk duhen humbur

— FAQE 13

Foto: **Artur Xhediku**

NË BRENDËSI:

- **Seminari** bujqësor i Dibrës
- Shkolla e **Pocestit**
- Një botim i ri folklorik: **Në gjurmë të këngës dibrane**
- Vlerat e **Ujemujës** së Dibrës në librin e **Hidajet Lahit**
- "Jehona e Shqipes" dhe **Sakip Skepi** si histori suksesi!
- **Muharrem Gjoka**, "Mjeshtër i Madh" dhe "Qytetar Nderi" i Qarkut Dibër
- "Idioticus", cikël poetik nga **Artan Gjyzel Hasani**
- Poezia e **Canametit**, një kambanë e shqetësimit njerëzor
- Njeriu nuk kuptohet me vdekjen
- Shkolla e Ploshtanit merr emrin e respektuar **"Ramadan Gjorllaku"**
- Anekdota
- Lamtumirë nxënësi, shoku, miku im **Enver Laçi!**



Me rastin e 65-vjetorit: Shaban Sinani, studiuesi më në zë i kulturës shqiptare

SHABAN SINANI e ka emancipuar shkencën shqiptare

Nga **XHAFER MARTINI**

Shaban Sinani është një figurë e njohur mediatike; gazetarët dhe televizionet dëshirojnë ta kenë mik në emisionet dhe ekranet e tyre. Ai, pra, nuk ka nevojë t'ia bëj unë portretin me fjalë, me të vetmen me të cilën operojnë shkrimtarët. Por unë do ta bëj këtë, sa të mundem e si të mundem, se, të shkruash për yjet e pedagogjikes së Peshkopisë dhe të mos përmendësh yllin më të ndritur, nuk shkon.

(Lexoni në faqe 8-9)

KOMENT

Skavica nuk është çështje e një partie

Nga **BUJAR KAROSHI**

Çështja e Skavicës, më së pari, është çështje e atyre banorëve që dielli i mëngjesit i gjen në arë, duke punuar për të ndërtuar jetën e tyre në ato vende, pa u shkuar kurrë mendja për ta braktisur, siç kemi bërë shumë prej nesh.

Vota nuk duhet lexuar siç e lexojnë "profesorët" e Facebook-ut. Sepse çështja e Skavicës nuk ishte një çështje e koalicionit "Bashkë Fitojmë" e as më pak një çështje Partisë Demokratike të udhëhequr nga Sali Berisha. Skavica nuk është as një çështje e Partisë së Lirisë të udhëhequr nga Ilir Meta. Sepse, të dy këta liderë të tranzicionit shqiptarë, në kohën kur kanë qeverisur, kanë qenë "Pro" Skavicës, madje asaj më të madhes, 485 metra, që mbyt gjithë Dibrën.

Skavica nuk është çështje vote për një parti. Është çështje e gjithë popullit të Dibrës.

(Lexoni në faqen 6)

cyan magenta yelloë black 1

Gazeta “Rruga e Arbërit” është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur. Nr. 4 (199).
Prill - Maj 2023
Gazeta doli nga shtypi, 31 maj 2023.
Gjendet në treg deri në fund muajit qershor 2023.

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN “ë”.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Editor i faqes online: Agim Deva

Kontribuan për këtë numër:
Osman XHILI
Sami CURRI
Adem BUNGURI
Adriatik BALLA
Naim ZOTO
Hajri SHEHU
Zaim ELEZI
Bajram XHAFA
Gentjan TUFA
Mirdash SHEHU
Mina HYSA
Zabit LLESHI
Dali NOKA
Lavdrim BEQIRI
Kujtim ÇERPJA
Gëzim LOKA

KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.
Të interesuarit të shkruajnë email
në adresën <rrugaearberit@gmail.com>
ose të telefonojnë në numrin 069 20 68 603.

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t’i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t’i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit / NIPT: K82019002S
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. “Zenel Baboçi”,
Pall. “Ferar”, Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë
Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

BALLUKU: Studimi gjeologjik i cekët. Çështjet e sigurisë janë shumë më të rëndësishme se dëshira për të mbaruar sa më shpejt.

BERBERI: Gjatë kësaj vere kemi një përfundim total të punës në të gjitha kantieret e ngritura, përjashtuar tunelin. Në fund të muajit korrik, javën e parë të muajit gusht, ne hapim përfundimisht për regjimin e trafikut të plotë, rrugën nga dalja e tunelit në shkallën e Tujanit deri në Murriz dhe nga dalja e tunelit deri në Maqellarë.

Në foto: Znj. Belind Balluku (në mes) dyke inspektuar punimet brenda galerive të Tunelit të Murrizit. *Foto: MEI/FB*

“Puna në tunelin e Murrizit po vijon. Janë metrat e fundit që edhe kjo vepër, më e rëndësishmja e Rrugës së Arbrit, të jetë plotësisht e hapur dhe e aksesueshme për të gjithë drejtuesit e automjeteve. Gjeologjia solli vonesat në ecurinë e këtij projekti, por puna nuk është ndalur dhe nuk do të ndalet deri në përfundimin dhe hapjen e plotë të tunelit, i cili bën të mundur që i gjithë qarku i Dibrës të jetë akoma edhe më afër me Tiranën”, shkruante me datë 30 maj 2023 në profilin e saj në Facebook znj. Belinda Balluku, zv, kryeministre dhe ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Një ditë më parë, më datë 29 maj 2023, Balluku, e shoqëruar nga z. Evis Berberi, drejtor i përgjithshëm i Autoritetit Rrugor Shqiptar si dhe punonjës të kompanisë “Gjoka ‘87”, inspektuan punimet në tunelin e Murrizit, duke e përshkruar në këmbë dhe në makinë të gjithë gjatësinë e tunelit, si dhe duke sjellë për herë të parë para publikut një video mbi ecurinë e punës dhe problematikat e shfaqura.

Videoja prej 30 minutash u publikua në Facebook-un e ministres së Infrastrukturës, e cila, së bashku me drejtorin e ARRSH u munduan të japin sqarime për të gjitha vonesat e deritanishme në grafikun e punimeve në tunelin e Murrizit, duke e lidhur këtë me problemet gjeologjike të paparashikuara.

“PUNA NË TERREN NË DISA FRONTE”

“Ashtu siç e kemi premtuar, për të bërë një inspektim edhe për të informuar qytetarët, të cilët tashmë me përfundimin e pothuajse gjithë segmenteve të Rrugës së Arbrit, janë shumë të interesuar për të ditur ecurinë e këtij tuneli, i cili ka nisur në 2018, por për shkak të gjeologjisë shumë komplekse që kemi pasur këtu, na është dashur që të përballemi me situata që sigurisht kanë marrë më shumë kohë nga sa ishte parashikuar”, tha Balluku ndërkohë që po hynte në galerinë kryesore të tunelit të Murrizit në hyrjen nga Tirana.

Tuneli i Murrizit ka dy tuba kalimi, të gjatë 3.78 km secili, të cilat lidhen përmes tyre me 11 tunele bashkuese.

“11 tunelet bashkuese janë të gjitha të hapura ashtu siç është edhe tuneli i emergjencës i gjithi i hapur”, - tha Balluku.

Duke folur për punimet brenda tunelit, Evis Berberi tha se “në tunelin e emergjencës janë betonuar 650 metra dhe vazhdohet me ritme të mira për ta çuar deri në fund betonimin”, ndërsa në tunelin kryesor betonimi ka ecur më shpejt. Sipas tij, nga dy kantieret e ngritura në dy anët e tunelit “janë betonuar nga 1.1 km në secilën anët, në total 2.2 km, ndërsa është duke u punuar në 400 metrat e fundit në tunelin kryesor”. Berberi la të kuptohej se, meqë puna vazhdon në të dy frontet, tuneli avancon çdo ditë nga 3 metra.

Balluku gjatë vizitës në kantier tha se “është kënaqësi të shikosh se ka fronte të hapura gjithë kohën, duke filluar nga të gjitha makineritë dhe punëtorët, të cilët kryejnë procese të ndryshme nga gërmimi tek armatimi, tek ankorimi dhe gjithçka tjetër, dhe kjo është diçka që ne duhet ta themi”.

“Tuneli do të ketë dy korsi lëvizje me 3.75 metra si dhe trotuare me gjerësi 1.5 metra. të kombinuara me 11 galeritë lidhëse me tunelin e emergjencës. Parashikohet që trafiku në tunel të mos bllokohet asnjëherë, sepse nëse ndodh një defekt në mjete apo ndonjë aksident, ekziston mundësia të nxirren në anë të rrugës pa e bllokuar trafikun”, tha Berberi.

Punimet në brendësi të Murrizit janë komplekse dhe sipas drejtorit të ARRSH “janë të pavarur nga njëri-tjetri dhe vazhdojnë si me betonimet, gërmimet e transportin ashtu dhe me hapjen e themeleve”.

“Ne kemi bërë gati dhe porositë për pajisjet elektromekanike, pasi është një tunel i gjatë dhe pajisjet elektromekanike janë duke u prodhuar specifikisht për këtë tunel”, tha Berberi.

“Kur do të takohen të dyja portalet për të parë dritë në krahun tjetër, do të jetë një moment që ne do ta bëjmë live, ashtu siç kemi bërë dhe Llogoranë dhe Kardhiqin, për t’ua treguar të gjithëve, pasi do të jetë një moment shumë i rëndësishëm, duke qenë se Rruga e Arbrit është një nga arteriet më të rëndësishme të vendit tonë”, tha Balluku.

Balluku dhe Berberi nuk preferuan të japin afate për hapjen e galerisë kryesore, por duke pasur parasysh ecurinë e punimeve të fundit, besohet se në fund të shtatorit apo gjatë muajit tetor, dy tunelet të bashkohen, duke u hapur plotësisht si galeri drite.

BALLUKU: STUDIMI GJEOLOGJIK I CEKËT

Vonesat në ecurinë e punimeve, si Balluku ashtu edhe Berberi i shpjegojnë me problemet gjeologjike.

“Gjeologjia është e vështirë, prezenca e ujërave është shumë e lartë, kemi hapur kanalet anësore për të menaxhuar gjithë ujërat. Përdorim masa shumë të mëdha forcimesh me dopio armaturë, me dopio profile hekuri dhe mbajtëse”, tha Berberi.

Duke qëndruar te i njëjti argument, zv. kryeministrja Balluku theksoi se “Tuneli i Murrizit ka qenë një nga problematikat më të mëdha që ne kemi hasur”.

Sipas Ballukut, studimi gjeologjik nuk është bërë nga kompania fituese, por është bërë nga kompania, e cila ka bërë ofertën e pakërkuar në 2018. Sipas saj, ka qenë një studim i cekët, “i cili na vuri përballë një fakti që të gjendemi në shtresa gjeologjike argjilore”.

“Gjatë kohës që ne kemi nisur punën këtu, kemi identifikuar që jemi përballur në mënyrë të vazhdueshme me katarakte të tëra uji, të cilat binin mbi shtresat argjilore duke

Në foto:
Një stacion pompimi në brendësi të tunelit të Murrizit. Foto: MEI/FB

"Ecuria tani është konstante dhe ka rëndësi që të përfundojë hapja e tunelit. Ne sërish nuk do të japim afate për tunelin e Murrizit, pasi ky është rast, që siguria rrugore, çështjet e sigurisë në të ardhmen, janë shumë më të rëndësishme se dëshira për të mbaruar sa më shpejt".

Belinda Balluku, zv. kryeministre dhe ministre e Infrastrukturës udhëton në tunelin e Murrizit:

Tuneli në 400 METRAT E FUNDIT, por nuk japim afate për mbarimin

i shkrirë ato", tha Balluku.

Për të justifikuar problemet gjeologjike, Balluku dhe Berberi u ndalën te disa burime ujore, si për të thënë se është ky uji që ka sjellë vonesat e deritanishme.

"Këtu kemi disa pika ku ka vendosje të çarjeve që janë bërë për gërmime, shikoni që ka burime të vazhdueshme uji që nuk janë të lidhura as me shirat dhe as me diçka tjetër, pra, janë burime konstante ujore që rrjedhin dhe krijojnë problematikën që kemi shpjeguar", tha Balluku.

Ajo bëri një krahasim me punimet në tunelin e Llogarasë, duke argumentuar se prurjet e ujit kanë krijuar problematika të paparashikuara në tunelin e Murrizit, por sipas saj, "tashmë është e rëndësishme që këtu puna po bëhet me skrupulozitet, me parametra të larta sigurie për të gjithë".

NË GUSHT 2023, PJESA TJETËR E RRUGËS SË ARBRIT PËRFUNDON SIPAS TË GJITHA PARAMETRAVE TEKNIKË TË NDËRTIMIT DHE SIGURISË.

Nga brendësia e Murrizit Balluku premtoi se "gjatë kësaj vere për këtë rrugë kemi një përfundim total të punës në të gjitha kantieret e ngritura, përjashtuar tunelin".

"Këtë verë e kemi planin që në fund të muajit korrik, javën e parë të muajit gusht, ne hapim përfundimisht, jo më në regjimin e kantierit, për regjimin e trafikut të plotë, akse të cilat kanë qenë të aksesueshme sot. Nga dalja e tunelit në shkallën e Tujanit deri në Murriz dhe nga dalja e tunelit deri në Maqellarë në segmente të plota, jo më në regjimin e kantierëve", tha Berberi.

"Ndërkohë po përfundojmë edhe pjesët ku ka pasur problematika të vogla përgjatë aksit rrugor të Rrugës së Arbrit janë marrë masa për të bërë të gjitha riparimet e fundit në mënyrë që kur të hedhim shtresat e fundit të binderit dhe tapetit, çdo gjë të ketë marrë formën e vet dhe të mos kemi më nevojë për të ndërhyrë dhe të jetë çdo gjë ashtu siç është projektuar me një cilësi të mirë", tha Berberi.

Berberi tha se aktualisht po punohet përgjatë rrugës në Planin e Bardhë për të punuar në përforcimin e skarpateve.

"Duke qenë se kemi bërë vendosjen e mureve të pritjes në fillim, kjo na ka dhënë komoditetin për të vazhduar për të punuar në skarpate, pa pasur bllokime të shpeshta të rrugës", tha Berberi. Sipas tij, në të ardhmen nuk do të ketë më bllokime të rrugës, përveç bllokimit të një korsie në një gjatësi deri 50 metra".

Berberi konfirmoi se gushti i këtij viti do ta gjejë pjesën tjetër të Rrugës së Arbrit të përfunduar sipas të gjitha parametrave teknikë të ndërtimit dhe sigurisë.

KOSTO TË RRITURA?! BALLUKU MOHON: "NUK KA PASUR ASNJË SHTIM FINANCIAR NË KONTRATËN E RRUGËS SË ARBRIT"

Gjatë vizitës në kantier Balluku iu rikthye edhe akuzave të opozitës për shpërdorim të fondeve publike dhe kostove të rritura të rrugës.

"Kontrata e Rrugës së Arbërit është një kontratë e cila nuk ka ndryshuar formën e saj financiare nga dita e parë e deri më sot", tha ajo.

"Pavarësisht se çfarë është thënë nga

opozita apo edhe nga analistë, të cilët nuk besoj që nuk e dinë të vërtetën, por kanë pasur arsyet e tyre për të dezinformuar, nuk ka pasur asnjë shtim financiar në kontratën e Rrugës së Arbërit", theksoi Balluku.

Sipas saj, edhe kostot e punimeve në tunel, edhe kosto e ndërtimit të by-passit, është një kosto që e përballon vetë kompania.

"Madje edhe tuneli, pavarësisht kostos, është një kosto që i shkon kompanisë, duke qenë se kështu kanë qenë kushtet e kontratës. Duhet thënë që 9 km e pak më shumë të by-passit të Murrizit janë mbuluar me fondet e kompanisë dhe mirëmbahen rregullisht nga kompania", theksoi Balluku.

Sipas Balluku, by-passi "është një rrugë që bllokohet shpesh për shkak të trafikut të dendur, për shkak të ndonjë aksidenti, ndaj duhet mirëkuptim. Duhet të kemi parasysh që është vetëm diçka e improvizuar pa kosto për shtetin".

"Ka pasur zero kosto për shtetin, janë të gjitha ngarkesa që mbahen nga kompania koncensionare e Rrugës së Arbrit", theksoi Balluku.

BALLUKU: NUK JAPIM AFAT PËR MBARIMIN E TUNELIT.

Duke dalë në kantierin e Xibrit, Balluku bëri edhe një panoramë të përgjithshme të investimeve në infrastrukturë të qeverisë shqiptare.

"Republika e Shqipërisë krenarisht ka ndërtuar 5 tunele në Rrugën e Arbrit, një tunel në aksin Kardhiq-Delvinë, tunelin e Llogorasë që punohet me ritme shumë intensive dhe kemi pra edhe këtë tunel. Në Republikën e Shqipërisë mund them pa frikë që ka një ekspertizë të mirë dhe konsistente në ndërtimin e tuneleve, të cilat kanë gjeologji të ndryshme".

"Ecuria tani është konstante dhe ka rëndësi që të përfundojë hapja e tunelit. Ne sërish nuk do të japim afate për tunelin e Murrizit, pasi ky është rast, që siguria rrugore, çështjet e sigurisë në të ardhmen, janë shumë më të rëndësishme se dëshira për të mbaruar sa më shpejt".

Sipas saj, "do t'i mbetet Këshillit teknik të ARSH që të vlerësojë situatën për vazhdimësinë e këtij tuneli, por unë sot me të vërtetë kam parë progres të qenësishëm, që na bën besimplotë, që shumë shpejt gërmimi do të përfundojë. Në përfundimin e gërmimit me shumë skrupolozitet do të vazhdojë armatimi dhe betonimi i brendshëm, për të pasur pastaj afate konkrete se kur do mbarojë pjesa elektromekanike, shtrimi i pjesëve asfaltike dhe gjithçka tjetër", tha Balluku.

RRUGA NUK KA MBARUAR, POR QYTETARËT KANË NISUR TË MARRIN FRYTET E PARA

"Duhet thënë që Rruga e Arbrit është një nga veprat infrastrukturore më të rëndësishme në Republikën e Shqipërisë, pasi ka dhënë ndikimin e parë, pavarësisht se nuk është e mbaruar në të gjithë pjesën e saj, pra, mungon ky tunel. Që sot qytetarët e Dibrës, të Matit, të Klosit e të Bulqizës kanë nisur të marrin frytet e para të këtij projekti të jashtëzakonshëm infrastrukturor, ashtu siç ka ndodhur me të gjitha projektet e tjera. Ne do të vazhdojmë të punojmë me skrupolizitet dhe përgjegjësi të lartë sidomos kur veprat janë komplekse ashtu siç është ky tunel", tha Balluku.

Belinda Balluku, përveç dy posteve të rëndësishme në qeveri, ka edhe detyrën e përfaqësuesit politik të Partisë Socialiste në Qarkun e Dibrës. Ndaj edhe vëmendja e saj, në vizitën e zhvilluar brenda tunelit të Murrizit, nuk harroi të theksonte dobinë e kësaj rrugë për Dibrën dhe Matin.

"I gjithë zhvillimi që i ka sjellë zonës së Dibrës dhe zonës së Matit është me të vërtetë i prekshëm tashmë, por unë nga ana tjetër sigurisht sa më shumë segmente ne dorëzojmë, aq më shumë rritet kërkesa e qytetarëve, sidomos e vizitorëve dhe turistëve, që janë të shumtë në numër. Vetëm vitin e kaluar kemi pasur 40 mijë turistë të regjistruar në qarkun e Dibrës dhe kërkesa e tyre është legjitime për të pasur mundësi edhe për të hequr njëherë e mirë nga harta këtë by-passin provizor të Murrizit, që ne kemi krijuar me kosto të kompanisë, pa i rënduar fare projektit, thjesht për t'i dhënë mundësi që të kalojnë ndërkohë që punohet në tunel."

* * *

Duket se gjatë kësaj vere punimet për hapjen e galerisë kryesore të trafikut në tunelin e Murrizit do të jenë drejt fundit, ndërsa segmentet e tjera do të jenë të hapura për trafikun normal. Kur vizat e verdha të ikin nga rruga, mbetet të verifikohet nëse janë respektuar standardet e projektuara për këtë aks rrugor, cilësia e ndërtimit dhe elementët e sigurisë, shumë të rëndësishme jo vetëm për sigurinë e lëvizjes, por edhe për perspektivën e rritjes së trafikut të makinave në këtë aks. Deri atëherë, lëvizni me kujdes!

Korr. Rr.A.

DHJETË VITE PRITJE PËR DY MUAJ PUNË...

Para zgjedhjeve vendore të 14 majit 2023 në Shqipëri gjatë segmentit të Rrugës së Arbërit në Planin e Bardhë u punua intensivisht. Dhjetë ditë para zgjedhjeve, më 3 maj 2023, rruga u hap për qarkullim në regjimin e kantierit. Ky segment rrugor ka nisur të ndërtohet në vitin 2011 dhe në vitin 2013 duhet të kishte mbaruar. U desh një pritje 10-vjeçare për një punë pak mujore që ky segment të vihej në funksionim. Rruga përgjatë Planit të Bardhë, krejtësiht i ri, është shumë i rëndësishëm për cilësinë e udhëtimit nga Tirana në Dibër dhe anasjelltas, duke hequr përfundimisht nga harta rrugore rrugën e vjetër nga Qafa e Buallit në Klos. Kthesat e vështira të Klosit tashmë janë vetëm në kujtesën e udhëtarëve.

Rruga e Arbërit nr. 199

reportazh

PËR NJË ORË E GJYSMË NË TIRANË!

Dibranët gjatë fundjavave përmes Rrugës së Arbrit

Rruga e Arbrit, e cila ka një karakter mbarëkombëtar është një mundësi e madhe edhe për zhvillimin të krahinës së Dibrës por edhe qytetit të Dibrës. Këtë e pohojnë udhëheqësit vendor, biznesmenët por edhe qytetarët në përgjithësi. Rruga, e cila ka afruar qytetin e Dibrës me Tiranën për 1 orë e 30 minuta, është një garanci e mirë që dibranët të vizitojnë kryeqytetin shqiptar, por edhe qytete të tjera bregdetare, sidomos Durrësin

Nga **Vjollca SADIKU**

Dibër, 29 maj – Rruga e Arbrit, e cila u ndërtua nga qeveria shqiptare, ka ndryshuar dukshëm frekuentimin të dibranëve për të kaluar fundjavat jashtë Dibrës. Rruga në fjalë, e cila ka një karakter mbarëkombëtar, është një mundësi e madhe edhe për zhvillimin të krahinës së Dibrës, por edhe të qytetit të Dibrës. Këtë e pohojnë udhëheqësit vendorë, biznesmenët, por edhe qytetarët në përgjithësi. Rruga, e cila ka afruar tani qytetin e Dibrës me Tiranën për 1 orë e 30 minuta, është një garanci e mirë që dibranët të vizitojnë kryeqytetin shqiptar, por edhe qytete të tjera bregdetare, sidomos Durrësin. Gjallëria në këtë rrugë është gjatë fundjavave, meqë një pjesë e madhe e dibranëve fundjavat i kalojnë te të afërmit e tyre në Tiranë, por edhe në qytetin bregdetar të Durrësit. Në krahasim me të kaluarën, kur dibranët fundjavat i kalonin kryesisht në Strugë, Ohër, Mavrovë etj., me ndërtimin e Rrugës së Arbrit, dy vitet e fundit, drejtimi i dibranëve është Tirana dhe Durrësi.

Në vendkalimin kufitar në Bllatë, në kufirin të RMV-së dhe Shqipërisë në afërsi të Dibrës, ka frekuentim të lartë, por frekuenca është disa herë më e madhe e gjatë fundjavës. Biseduam me disa bashkëqytetar, të cilët ditën e shtunë udhëtonin në Shqipëri. Besim. O. na tha se "pothuajse dy herë në muaj, nga vendkalimi kufitar i Bllatës nëpërmjet rrugës së Arbrit udhëton me familjen katër antarshe në Tiranë ku ka të afërmit e tij".

"Kam shumë të afërm të mi, të cilët jetojnë në rrugën e Dibrës. Jemi të një trungu familjar dhe ata i vizitoj gjatë udhëtimit tim në Shqipëri. Në rrugën e Dibrës jeton kryesisht komuniteti dibran i cili është shpërngulur nga Dibra gjatë masakrave serbe 1913. Ardhja ime në Tiranë ka të bëjë edhe me blerjen të produkteve të ndryshme si dhe gardërobë", thotë Besimi.

Në vendkalimin kufitar të Bllatës takuam edhe anëtarët e familjes Klloboçishta. Ata na thanë se me përmirësimin e kohës pothuajse çdo fundjavë udhëtojnë nëpërmjet rrugës së Arbrit në qytetin turistik të Durrësit. Familja ka edhe banesën e vet, të cilën e ka blerë para pesë viteve.

Nga ky vendkalim kufitar udhëtojnë shumë dibranë. Dy vitet e fundit, në krahasim me situatën aktuale, dibranët për në Shqipëri udhëtonin kryesisht nga vendkalimi kufitar i Qaf Thanës. Tani, duke marrë parasysh aftësinë e Tiranës me Dibrën, me ndërtimin e rrugës në fjalë, e cila është më e shkurtër se 70 kilometra, kryesisht udhëtimet bëhen nëpërmjet vendkalimit kufitar të Bllatës.

Në lidhje me domethënien e kësaj rruge me kënaqësi shprehen edhe biznesmenët dibran. Sipas tyre, shkëmbimi i mallrave bëhet nëpërmjet këtij vendkalimi, por për shkak të mungesës së terminalit, pjesa më e madhe e tyre bëhet nëpërmjet vendkalimit kufitar Qafa e Thanës, meqë terminali është në Strugë. Biznesmenët dibran disa herë kanë kërkuar nëpërmjet Odave ekonomike që veprojnë në Dibër të ndërtohet terminal në afërsi të Dibrës dhe harxhimet për transport të mallrave do të jenë shumë më të vogla, meqë rruga e Arbrit mundëson atë. Edhe kompanitë për transport të udhëtarëve thonë se rruga e Arbrit dukshëm ka përmirësuar buxhetin e tyre. Tani kompanitë të transportit në Dibër pothuajse çdo ditë transportojnë udhëtarë në drejtim të Tiranës, Durrësit dhe qyteteve të tjera bregdetare të Shqipërisë edhe atë nëpërmjet rrugës së Arbrit. Kërkesat janë shumë të mëdha, thotë pronari i kompanisë "Unik turist", Azem Ballanca.

Ai shton se tani meqë funksionon rruga e Arbrit edhe shumë dibran realizojnë udhëtimet e tyre ajrore për në shtete të Evropës, por edhe në SHBA nga aeroporti i Tiranës. Odat ekonomike që veprojnë në Dibër thonë se rruga e Arbrit garanton edhe një zhvillim të përshpejtuar të Dibrës, sidomos në sferën e turizmit dhe zhvillimin e bizneseve. Kohëve të fundit, edhe banorët të Shkupit, Tetovës dhe Gostivarit për në Shqipëri udhëtojnë nga Dibra, e jo nga Struga. Shkurtimi i rrugës për në kryeqytetin shqiptar është joshës për të gjithë shtetasit e vendit tonë për të udhëtuar në qytete të ndryshme të Shqipërisë nëpërmjet rrugës së Arbrit. (koha.mk)

VËZHGIM / SHPËRNDARË ME **LIGJIN 7501** ALIAS **LARË ME GJAK E FLORI?**

Bërxulla dhe Dibra, toka në mes

A do të shkojnë dibranët të mësojnë se si mbrohet prona në Bërxullë?

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

Bërxulla është një fshat i Tiranës.
Kam qenë në Bërxullë.
Kur isha student kam bërë praktikën bujqësore.
Kam bërë edhe një reportazh për të rinjtë dhe të rejat në rrugën e transformimit shpirtëror e zakonorë me të kaluarën.
Kohë e largët, diku tek gjashtë dekada më parë...
Bërxullasit, si të gjithë fshatarët përfituan tokë sipas ligjit 7501, tokë e shpërndarë me "litar" mbi bazën e frymëve të secilës familje.
Se e kujt ishte toka me TAPI, blerë nga gjyshi me flori, nuk u mor vesh, as atëherë dhe as sot. Kush nuk e tha e askush nuk e thotë. Veçse në rastet kur ndonjë (shyqyr që janë pak se po të dalin të gjithë atëherë "kthim kompensimi i pronave" do të griste xhepat e mbarë popullit, mbase për dy apo tre breza) nxirrte nga çekmexhetë tapi të hershme turke.
Nëpër Bërxullë do të kalojë autostrada. Do marr toka buke e ndërtime të vjetra e të reja. Do marrë aq sa do të jetë traseja e saj me gjerësi dhe gjatësi. As më pak dhe as më shumë. Dhe kjo tokë duhet të kompensohet në lekë apo euro. Sa është çmimi i kohës për zonën. Sigurisht jo sa është çmimi i një metri katror në "Sheshin Skënderbeg" por më pak, mbase sa gjysma, e shumta sa treçereku. Por me siguri më shumë se sa u kompensua toka me zgjerimin e aerodromit të Kuçovës ku një metro katrore tokë u kompensua me 1.9 euro, as sa një paqetë cigare. Kuçovasit nuk e kundërshtuan aq sa po e kundërshtojnë Bërxullasit.
Mbase se nuk ishte tokë e tyre, tokë e baballarëve e gjyshërve, blerë me flori e dokumentuar me "tapi turke". Mbase ishte "tokë me litar", shpërndarë për frymë. Kush mori – mori. Kush mbolli – mbolli.
Në Bërxullë do të kalojë autostrada.
Autostradat lidhin njerëzit, vendin, vendet, janë kërkesë e kohës...
Në Dibër këto ditë shoh të organizohen tubime.
Në Muhurr...
Në Fushë Alie...
Në...
Atje ku toka mbytet...
Atje ku historia shuhet...
Atje ku eshtrat luajnë vendit.
Të trimave e trimëreshave
Që serbit Drinin s'ia dhanë
Me gjak truallin lanë...
Pak, disa dhjetëra janë.
Megjithatë bukur.
Me ta jam,
me ta do të jem.
Një këshillë e kam
Shkoni në Bërxullë
Është një shkollë rezistenca.
Bashkohuni me ta,
merrini me vete.
Zërin bashkoni,
në një front luftoni.
Dibra e vetme nuk ia del dot
Pa "dibranët" e Bërxullit,
Bathores, Kamzës, Paskuqanit,
Rrethinave të Durrësit, Kavajës, Fushë-Krujës,
jallisë mbarë.
Kur të mblidheni bashkë,
si gishtat në grusht,
do vijmë edhe ne,
mërgimtarët,
Nga Athina...
Nga Roma...
Parisi...
Berlini...
Londra...
NewYorku...
Washingtoni...
Melburni...
Bota mbarë...
Mos e nënvleftësoni Dibrën
E bashkuar, gjithnjë ia ka dalë
Dhe mos harroni:
Tokën kush nuk ua ka falë,
Me flori e keni blerë,
me gjak e keni larë...

Athinë, 30 maj 2023

6 maj, Dita Emrit të Gjergj Kastriotit

Këshilli Bashkiak i Dibrës vendos ta kthejë këtë datë në një festë të përvitshme, me synimin për ta shndërruar në një festë mbarëkombëtare, ku atdhetarë anembanë trojeve shqiptare do të vizitojnë trojet e heroit kombëtar, Gjergj Kastriotit

Dibër, 5 maj 2023. - Këshilli Bashkiak i Dibrës, në mbledhjen e radhës më 3 mars 2023, ka vendosur që dita e 6 majit të festohet si "Dita e emrit të Gjergj Kastriotit".

Në këtë kuadër, më 6 maj 2023, në Kastriot u mbajt ceremonia e parëinauguruese e kësaj feste të re në Dibër, në të cilën morën pjesë z. Rahim Spahiu, kryetari i bashkisë së Dibrës, deputeti Lavdrim Krrashi, këshilltarë, historianë, aktivistë, intelektualë dhe banorë të zonës.

"Prej sot, e në të ardhmen, më6 maj, dita e Shëngjergjit, festa e ringjalljes së natyrës, do të ketë edhe një kumtim tjetër, do të festohet, nderohet e kujtohet si "Dita e emrit të Gjergj Kastriotit", shenjtit, heroit të qenies e mbijetesës sonë kombëtare", u tha nga organizatorët në këtë tubim.

Për herë të parë,"Dita e emrit të Gjergj Kastriotit" është shpallur dhe festuarme 6 maj 2022, në Peshkopi dhe Sinë, në një veprimtari në nderimi të Gjergj Kastriotit, e cila u organizua nga akademia alternative "Rrënjët tona", ku morën pjesë shqiptarë të ardhur nga të gjitha trevat kombëtare.

"Nga sot e nëvazhdim, 6 maj, "Dita e emrit të Gjergj Kastriotit", do të festohet në Kastriotin e vjetër, nëKukaj, aty ku dhe gjenden shenjat e trojeve tëfamiljes së Gjergj Gjon Kastriotit-Dibranit", u tha nga organizatorët.

Në këtë ditë, të gjitha dyert e shtëpive të Kastriotit dhe Kukajtdo të jenë të hapura e mikpritëse për vizitorët (pelegrinët) nga mbarë trojet shqiptare, sipas traditës "bukë ...e zemër".

Veprimtaria nisinë orën 9 paraditete memoriali i Kastriotëvenë Kastriot, ku Sokol Sava, kryetari i Këshillit Bashkiak të Dibrës shpallivendimin. Studiuesi Haki Përnezha argumentoi vendimin e këshillit bashkiak dhe paraqiti argumentet se pse kjo festë duhet të jetë një festë e të gjithë shqiptarëve.

Vendimi nr. 40 i datës 3 mars 2023 i Këshillit Bashkiak të Dibrës, erdhi pas një propozimi nga disa qytetarë dhe organizata të shoqërisë civile, të cilët kanë mision çështje të historisë, kulturës dhe zhvillimit të Dibrës, si tërësi etnokulturore.

Në këtë ditë përshëndetën kryetari i bashkisë së Dibrës z. Rahim Spahiu, deputeti i zonës Lavdrim Krrashi, studiuesi dhe president i akademisë "Rrënjët tona" z. Sazan Guri, studiuesi Hysen Uka dhe të tjerë.

Në këtë tubim u vu theksi te rëndësia e kujtimit të Ditë së Emrit si dhe planet për ta kthyer këtë datë në një ditë të rëndësishme të historisë së shqiptarëve.

Kjo veprimtari, çdo datë 6 maj, konsiderohet e rëndësishme dhe synon të ketë një ndikim të jashtëzakonshëm në evidentimin, mbajtjen gjallëdhe edukimin brezave të rinj me dashurinë për vendin. Në pamundësi të të paturit të ditës së lindjes, brezat do të kenë dhe do të nderojnë ditën e emrit të heroit, "Ditën e Emrit të Gjergj Kastriotit".

Korr.Rr.A.

Shfaqet në Tiranë dhe Prishtinë opera "Skënderbeu, kryezot i Arbërit"

Skënderbeu nuk përton të ngrihet prapë

Nga **DASHNOR KOKONOZI**

Me qejf shkuam të shohim operën që muzikanti e muzikologu Vasil S. Tole i ka kushtuar Skënderbeut, me libret të punuar nga ai vetë mbi një tekst të F. Nolit.

Kisha kureshtje të shoh një opera shqiptare të ditëve tona sepse nganjëherë kemi përshtypjen se krijimtaria operistike ka përfunduar në muze, për t'u shijuar tashmë me rivëniet e veprave të dikurshme. Se koha jonë në rastin më të mirë mund ta perceptojë veçse të modernizuar në trajtën e një dramaturgjie lirike si West Wild Story, apo më këndej si operat "Niksoni në Kinë" e John Adamsit apo "Ajnshtajni në plazh" e Philip Glass (në versionin e festivalit të Avinjonit që kam patur rastin të njoh) etj.

E pra, me sa duket nuk është kështu. Opera ka të drejtë të ekzistojë dhe evolojë në të gjitha format e mundshme.

Tole nga ana e tij e ka sjellë si një "Opera solemne- koncertale".

Nuk shihen në të mizanskenat klasike, edhe pse gjuha muzikore është e tillë, kemi më fort një lloj "dialogu" midis solistëve, një kuarteti dhe korit masiv (bashkim i suksesshëm i Teatrit të Operas së Tiranës dhe korit të Filarmonisë së Kosovës)

Natyrisht, është punë e specialistëve të gjykojnë për të e veçanërisht strukturën e saj muzikore. Ne si spektatorë të thjeshtë kufizohemi në një perceptim të drejtpërdrejtë e bazik: "më pëlqen, nuk më pëlqen,".

Mua më pëlqeu, veçanërisht muzika dhe interpretimi i koraleve. Ishin të plotë, emocionues. Me interes m'u duk edhe dalja e një kuarteti (A. Vera, G. Murrja, E. Golemi, A. Papa).

Edhe pse mjaft profesionistë në kuartet, krijova përshtypjen se dy artistët e parë e ndjenin ca peshën e skenës dhe të premierës kur dilnin solo, gjë që i lejoi të shprehnin vetëm pjesërisht talentin e tyre. E di, një shfaqje duhet parë në daljen e saj të tretë apo të katërt në skenë dhe gjithnjë e kam shmangur premierën, por nuk e kam këtë mundësi.

Vetiu një vepër për Skënderbeun, të sjell në mendje muzikën me të vërtetë madhore të filmit që mban emrin e tij. Më pëlqeu që autori me zgjuarsi kishte sjellë ndonjë motiv të tij, por jo më shumë si reminishencë se sa si një lloj homazhi, si një intertekst muzikor, nëse mund të përdoret ky term.

Gjithsesi, gjykimi mbetet thjesht personal.

Marrë nga flasshqip.ca

NJË FTESË PËR TË GJITHË ATA QË DUAN TË KONTRIBOJNË PËR VENDLINDJEN

Pse u krijua Grupi i Aktivistëve Ruralë të Dibrës?

Përpos sfidave që shoqëria dibrane ka hasur këto 30 vite tranzicion, prej dy vitesh përballen me sfidën më të madhe; rrezikun e ndërtimit të Hec Skavica.

Kjo, jo vetëm i shkundi dibranët, por një pjesë të mirë e ndërgjëgjësoi se çfarë i priste. Pati shumë nga ata që nisën të jenë më aktivë dhe të duken ne media e terren. Ndërkohë që grupi i aktivistëve prej 20 vitesh vijonin luftën e tyre kundërshtuese.

Të gjithë këta aktorë nisën të krijonin lidhjet mes tyre për të vijuar një kauzë të fuqishme përballë një qeverie dhe një propagande mediatike tëpër e fuqishme duke përdorur edhe krizën energjitike të 2022-it.

Pa hyrë në detaje, mund të themi që ky rrjetëzim nisi të krijonte shkëputjet e para dhe vijuan kështu ndasitë dhe "lufta" për udhëheqje.

Pavarësisht përpjekjeve të njëpasnjëshme dhe bashkëpunimeve edhe me organizata ndërkombëtare, prap uniteti ishte jo ai i duhuri. Përpos kësaj, një tjetër fakt që na e bënte këtë bashkim edhe më të vështirë, ishte mospasja e një hapësire tonën ku të mblidheshim dhe të diskutonim mbi idetë e përbashkëta, ndasitë, qoftë për çështjen Skavica, por edhe për problematika të tjera.

Prandaj, pasi u diskutua gjatë mes një pjesë prej nesh, u vendos që duhej bërë i mundur ky mjedis, për t'u dhënë mundësinë të gjithëve të bëheshin pjesë e një grupi me të drejta të barabarta.

Dibra është një rajon me shumë potencial dhe tradita, por me një shoqëri civile jo shumë aktive. Kjo për shumë arsye dhe pa asnjë lënie faji.

Pas ndihmës që na dha EED me qendër në Bruksel, zyra e GARD u bë e mundur të hapej me 1 Mars 2023.

Përzgjedhja e emrit "Grupi i Aktivistëve Ruralë të Dibrës", nuk është i rastësishëm, por ka për qëllim ftesën ndaj të gjithë atyre që duan të kontribojnë për vendlindjen e tyre. Dhe mbi të gjitha, për të gjithë ata/o që jetojnë në zonat rurale dhe nuk kanë pasur diçka që t'u përkasë atyre.

Ky mjedis është një Qendër Komunitare në shërbim të shoqërisë civile dibrane dhe OJQ-ve, të cilat bëjnë një punë të pandalshme me komunitetin.

Pjesë e këtij grupimi aktivistësh janë organizata të ndryshme dhe aktivistë të pavarur që janë aktivë në kundërshtimin e projektit Skavica. Për t'i respektuar të gjithë, pasi ne nuk prononcohemi me emër të përveçëm, nuk do i përmendim këtu, por të gjithë këto do keni rastin t'i shihni në aktivitetet e ardhshme. Megjithatë, nuk mund të rrimë pa përmendur Shoqatën për Mbrojtjen e Drinit të Zi, si një ndër zërat kyç në këtë çështje dhe mjediset e GARD nuk do ishte asnjëherë të plota pa prezencën e tyre, me të gjithë kontributin 20-vjeçar për Dibrën.

Ne kemi qëndruar shumë neutralë gjatë kësaj periudhe meqë ishin zgjedhjet vendoe, sepse GARD është jopartiake. Duam që ky mjedis t'u përkasë të gjithëve njëlloj.

Zyra është e hapur çdo ditë për të na vizituar dhe t'iu bashkëngjitur nismave tona.

Çdo fundjavë do të mbahen takime me një numër më të madh pjesëmarrësish.

Jeni të mirëpritur të na vizitoni dhe të na bashkangjiteni në nismën tonë për të kontribuar sa më shumë për Dibrën!

Ju mirëpresim në adresën: rruga "Mit'hat Ademi', ngjitur me derën e pasme të shkollës "Demir Gashi".

Rruga e Arbërit nr. 199

koment

Çështja e Skavicës, më së pari, është çështje e atyre banorëve që dielli i mëngjesit i gjen në arë, duke punuar për të ndërtuar jetën e tyre në ato vende, pa u shkuar kurrë mendja për ta braktisur, siç kemi bërë shumë prej nesh.

Skavica nuk është çështje e një partie

Nga BUJAR KAROSHI

Çështja e HEC të Skavicës në fushatën e fundit lokale u kthye në një element thelbësor të fushatës elektorale. Grupimi politik "Bashkë Fitojmë" u përpoq shumë që me kartën e mbrojtjes së Skavicës të mblidhte çdo votë, duke premtuar se jo vetëm do ta ndalonte ndërtimin e Skavicës, por do t'i ndalonte edhe kryeministrit "Edi Rama të kalonte Qafën e Buallit".

Pas humbjes se zgjedhjeve nga ky koalicion, në rrjetet sociale filloi mllefi, sulmet dhe fyerjet ndaj banorëve të Dibrës, sidomos në ato fshatra përgjatë luginës së Drinit të Zi, të cilët kishin votuar kandidatin e PS-së.

"Mirë t'u bëhet. Tani të marrin leckat në krah dhe le t'u mbyten trojet, shtëpitë dhe varret e të parëve të tyre", - ishte pak a shumë refreni i atyre që rrahin gjoksin si "mbrojtësit e Dibrës" kundër atyre që votuan për kandidatin socialist.

Në qoftë se vota "Pro" ose "Kundër" kandidatit të koalicionit "Bashkë Fitojmë" do të lexohej si votë "Pro" ose "Kundër" Skavicës, në Dibër, përgjatë luginë së Drinit të Zi, Skavicën nuk e duan vetëm në Laçes dhe Blliçe. Ndërsa katundet e tjera, së paku 28 fshatrat e tjerë që mbyten, nga Gjorica në Reç, duket sikur duan që Skavica të ndërtohet një orë e më parë.

Por vota nuk duhet lexuar siç e lexojnë "profesorët" e Facebook-ut. Sepse çështja e Skavicës nuk ishte një çështje e koalicionit "Bashkë Fitojmë" e as më pak një çështje Partisë Demokratike të udhëhequr nga Sali Berisha. Skavica nuk është as një çështje e Partisë së Lirisë të udhëhequr nga Ilir Meta. Sepse, të dy këta liderë të tranzicionit shqiptarë, në kohën kur kanë qeverisur, kanë qenë "Pro" Skavicës, madje asaj më të madhes, 485 metra, që mbyt gjithë Dibrën.

"Propozimi i ndërtimit të HEC Katundi i ri me kuota maksimale deri në 400 metër, do të bënte të pamundur ndërtimin e Kompleksit Hidroenergjetik Skavicë me kuota shfrytëzimi 445 metër dhe kuotë maksimale 485 metër, duke sjellë për pasojë humbje të mëdha" thoshte në parlament në vitin 2016 Sekretari i Partisë së Metës.

Çështja e Skavicës është një problem mes qeverisë shqiptare dhe popullit të Dibrës. Atij popullit të Dibrës që voton edhe majtas, edhe djathtas. HEC Skavica është çështje e banorëve të Dibrës që kanë më shumë se 20 vite që kundërshtojnë fuqishëm planet e qeverive shqiptare, madje duke marrë edhe pasoja për këtë mbrojtje.

Çështja e Skavicës, më së pari, është çështje e atyre banorëve që dielli i mëngjesit i gjen në arë, duke punuar për të ndërtuar jetën e tyre në ato vende, pa u shkuar kurrë mendja për ta braktisur, siç kemi bërë shumë prej nesh.

Çështja e Skavicës është edhe çështje e atyre socialistëve e demokratëve që gjithë këto vite janë vendosur në ballë të mbrojtjes së Dibrës. Disa prej tyre kanë mbajtur dhe mbajnë funksione zyrtare, por kjo nuk i ka penguar ta ngrenë zërin aty ku duhet. Së paku kur flasin në publik.

Partia Demokratike në zgjedhjet parlamentare të vitit 2021nuk e kundërshtoi ndërtimin e HEC të Skavicës asnjë ditë. Kandidatët e saj në fushatë nuk e përmendnin këtë çështje, madje edhe kur u kërkohej nga votuesit të mbanin një qëndrim, ata premtonin se "do ta vendosnin në transparencë të plotë me banorët dhe se do t'i dëmshpërblenin kokërr më kokërr".

Çështja e Skavicës u kthye në një çështje elektorale në Dibër atëherë kur Partia Demokratike u nda në dysh. Kandidatët degës së partisë që ndiqnin liderin e tyre historik e bënë çështje elektorale që në zgjedhjet e parakohshme vitin e kaluar, dhe sidomos kur Berisha u tha se për Skavicën kishte pasur një ide "me tunel" në Bicaj, madje këtë ua kishte kërkuar edhe italianëve që më parë kishin marrë një miratim nga qeveria e Fatos Nanos në vitin 2005. Por Berisha nuk u tha dibranëve se pse në dhjetor të vitit 2008 zhvilloi një tender ndërkombëtar ku morën pjesë 6 kompani, pas premtimeve se "do ta ndërtonte Skavicën me forcat e veta". Pse dështoi tenderit i vitit 2008 nuk pati asnjë deklaratë publike nga qeveria, megjithëse në këndvështrimin e sotëm do të kishte qenë një justifikim i madh të thuhej që atëherë se "qeveria nuk ka në plan të mbysë Dibrën".

Berisha dhe deputetët e tij kishin në dorë edhe formalisht të kundërshtonin ligjin "Bechtel" në Gjykatën Kushtetuese, por edhe këtë as nuk e bënë dhe as nuk e premtuan.

HEC i Skavicës me tunel është një shpikje elektorale e liderit historik të PD-së, kështu që nuk mund të kishte asnjë ndikim elektoral në këto zgjedhje, siç nuk pati as në zgjedhjet e parakohshme.

Vitet e fundit ka një angazhim të disa shoqatave, dy prej tyre të krijuar kohët e fundit, të cilat kërkojnë të mobilizojnë publikun dhe të ndalojnë qeverinë të vazhdojë me projektin e Skavicës. Ndërsa në fillim pati një plan të mirë për unifikimin e qëndrimeve dhe organizimin e protestave të vazhdueshme dhe masive, dalëngadalë grupimet filluan të zënë pozicione të kundërta. Kërkohej bashkëpunimi dhe bashkimi, por disa grupime zgjodhën të rreshtohen në Partinë Demokratike dhe bashkimin e konceptonin vetëm nëse u shkohej pas atyre. Dhe kush nuk u shkonte pas, baltaxhinjtë e facebook-ut nuk përtonin të shpifnin, gënjenin, fyenin dhe denigronin ata që nuk mendonin si ata. Madje, për ta ishte rruga më e lehtë edhe t'i dënonin si tradhtarë, pse jo, me varje në litar. Ndërsa ushtarët e këtij grupimi natë e ditë sulmonin bashkëqytetarët e tyre, liderët e kësaj organizate u rreshtuan krah Foltores, duke e kthyer gjysmën e PD-së si shpresa e fundit për të mbrojtur Skavicën.

Por ja që kjo çështje nuk u dha vota. Sepse Skavica nuk është çështje vote për një parti. Është çështje e gjithë popullit të Dibrës. Ndaj duhet unifikim qëndrimi, hapje e debatit, dëgjimi i zërave të ekspertëve.

Me grupe të mbyllura në facebook dhe regjistrim online protestuesish, këto grupime ngjajnë si parti të dështuara politike akoma pa u themeluar. Dhe kështu po i bëjnë keq Dibrës dhe krah qeverisë.

Pamje nga Muhurri

> Vota nuk duhet lexuar siç e lexojnë "profesorët" e Facebook-ut. Sepse çështja e Skavicës nuk ishte një çështje e koalicionit "Bashkë Fitojmë" e as më pak një çështje Partisë Demokratike të udhëhequr nga Sali Berisha. Skavica nuk është as një çështje e Partisë së Lirisë të udhëhequr nga Ilir Meta. Sepse, të dy këta liderë të tranzicionit shqiptarë, në kohën kur kanë qeverisur, kanë qenë "Pro" Skavicës, madje asaj më të madhes, 485 metra, që mbyt gjithë Dibrën.

> Sepse Skavica nuk është çështje vote për një parti. Është çështje e gjithë popullit të Dibrës. Ndaj duhet unifikim qëndrimi, hapje e debatit, dëgjimi i zërave të ekspertëve. Me grupe të mbyllura në facebook dhe regjistrim online protestuesish, këto grupime ngjajnë si parti të dështuara politike akoma pa u themeluar. Dhe kështu po i bëjnë keq Dibrës dhe krah qeverisë.

Mbrojtja e Dibrës, takime në Durrës dhe Tiranë

Më datë 29 maj, Shoqata për Mbrojtne e Drinit të Zi mbajti takime konsultimi me banorë të Dibrës që jetojnë në Durrës dhe Bathore, por që zemrën, shpirtin dhe kokën e kanë në Dibër.

Takimet ishin informuese për punën e deritanishme të shoqatës dhe organizatave të tjera që po merren me kundërshtimin e Digës së Skaviës si dhe u mblodhën mendime dhe ide për hapat e në vazhdim.

Në këto takime u theksua nevoja e një bashkëpunimi të frytshëm jo vetëm me organizatat lokale, por edhe më shoqata dhe organizata të tjera që operojnë në Tiranë, të cilat janë marrë me sukses në fushatat për mbrojtjen e Vjosës.

Pak ditë më parë një sinjal për kundërshtimin e digës së Skavicës e dha edhe Parlamenti Europian, i cili miratoi një dokument ku i bën thirrje qeverisë "për përmirësim të transparencës, sjelljes, zbatimit dhe monitorimit të vlerësimeve të ndikimit mjedisor dhe strategjik mjedisor, veçanërisht në projektet me pasoja të mëdha mjedisore dhe socio-ekonomike, si projekti i hidrocentralit të Skavicës; shpreh shqetësimin e tij për ndikimin ekonomik dhe mjedisor të projekteve zhvillimore jokonkurruese të financuara nga jashtë". ***/Korr. Rr.A.***

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë. Komentet ose opinionet tuaja botohen bazuar mbi lirinë e gjithësecilit, pa qëllim fyerje apo denigrim të individëve apo grupeve të ndryshme shoqërore dhe politike. Për të botuar opinionin/komentin tuaj mund të na shkruani në <rrugaearberit@gmail.com>

bujqësi

Seminari bujqësor i Dibrës

Nga **OSMAN XHILI**

Në ditët e fundit të muajit maj në Dibër u organizua një takim shumë frytdhënës për fermerët e bujqësisë. Ishte një organizim perfekt i disa partnerëve të rëndësishëm, si projekti i *Giz*-it, Drejtoria e Bujqësisë, Fondacioni *NOA*, kompania *Sygenta* e mbrojtjes së bimëve, si dhe kompania greke *Vitros Hellas*, në lidhje me mekanikën bujqësore, por jo vetëm.

Merrnin pjesë fermerët më të mirë të rrethit të Dibrës, ata, që me punën, përkushtimin e pasionin e tyre kanë arritur nivele të larta profesionalizmi. Nuk do të mungonin Veip Salkurti, Premtim Agolli, Bedri Topuzi, Lulzim e Hamit Abazi, vëllezërit Zebi dhe shumë emra të tjerë, të cilët duan që njohuritë e tyre t'i freskojnë vazhdimisht me të rejat e fundit të shkencës e prodhimit. Si zakonisht, do të ishte i pranishëm dhe eksperti i bujqësisë dibrane dhe miku i fermerëve, Dali Horeshka.

Pas fjalëve të mirëseardhjes dhe përshëndetjeve, radhën e kishin lektorët, që me fjalën e tyre, shembujt e qartë, monitorin që shpjegonte deri në detaje, komunikonin me fermerët.

Njëri nga lektorët ishte nga Moldavia dhe quhej Ananie Pesteanu. Ai mban titullin e profesorit dhe është konsulent ndërkombëtar i frutikulturës. Fillimisht ai na tregon se si vendi i tij, edhe pse pak më i vogël në numër se Shqipëria, prodhon 800 mijë ton fruta, nga të cilat 600 mijë ton janë mollë. Vendi ynë prodhon shumë herë më pak, kur kushtet e mundësitë janë për nivele shumë të mëdha. Kjo duhet të jetë një kambanë alarmi për autoritetet shqiptare, që e kanë lënë disi pas dore këtë burim të rëndësishëm të ekonomisë shqiptare.

Më pas profesor Pesteanu flet për rolin e jashtëzakonshëm të rrallimit të pemëve e në veçanti, rrallimin kimik. Sipas tij, ngarkesa e frutave në një pemë nuk duhet të jetë më shumë se 80 deri në 100 kokrra. Nëse ne do ta përdorim rrallimin me korrektesë, efektet pozitive do të ishin të shumta.

-Rritja e masës së frutave dhe cilësia e tyre.

-Rritja e lulëzimit për vitin e ardhshëm.

-Ruajtja e shëndetit të pemës, fuqisë dhe strukturës.

- Rrallimi kimik është i shpejtë dhe kostoja e tij është minimale.

Duke parë të gjithë këto vlera të këtij procesi të rëndësishëm në hallkat e prodhimit, lypset që ai të bëhet në kohë dhe në cilësinë e duhur. Ai duhet të aplikohet në periudhën e lulëzimit dhe në përfundim të saj, duke bërë korrektimin përfundimtar.

Prof. Ananie Pesteanu, konsulent ndërkombëtar i frutikulturës, tregon se si vendi i tij Moldavia, edhe pse pak më i vogël në numër se Shqipëria, prodhon 800 mijë ton fruta, nga të cilat 600 mijë ton janë mollë. Vendi ynë prodhon shumë herë më pak, kur kushtet e mundësitë janë për nivele shumë të mëdha. Kjo duhet të jetë një kambanë alarmi për autoritetet shqiptare, që e kanë lënë disi pas dore këtë burim të rëndësishëm të ekonomisë shqiptare.

Së fundmi, profesor Pesteanu flet dhe për produktet kryesore që përdoren për rrallimin e frutave. Si më të mirët e tyre përmende ureja në masën 0,6 deri në 0,8 përqind, Ammonium Thiosulphat, që aplikohet në kohën kur lulëzimi është zhvilluar në masën 20 deri në 80 përqind. Preparate të tjerë për rrallimin mund të përmendim Ethephon, , N.A.D, Brevis, Regalis plus, Perlan e shumë të tjerë.

Ligjërata e profesor Pesteanus u ndoq me shumë vëmendje dhe u përcoll me pyetje të shumta nga fermerët.

Më pas fjalën e merr koordinatori i Giz-it, Aurel Grabocka. Edhe pse në profesion është ekonomist, leximet dhe trajnimet e shumta e kanë bërë atë një ekspert të fushës. Ligjërata e tij është në lidhje me elementet kimikë, që i duhen pemës dhe frutit e në veçanti,kalciumit. Ai bashkëvepron me elementë të tjerë ushqyes, duke stimuluar hormonet natyrale të të vegjetacionit dhe ato të riprodhimit. Ndikimi i këtij elementi kimik është i rëndësishëm, jo vetëm në rritjen e rendimentit dhe cilësisë, por dhe ruajtjen më mirë të frutave në frigorifer.

Kur theksojmë rëndësinë e kalciumit, nuk duhet të kalojmë në ekstremin tjetër. Dhënia me tepricë e çdo elementi ushqyes është shpesh shkaku i sëmundjeve apo presionit nga insektet. Mungesa e ekuilibrit ushqimor sjell më shumë probleme me imunitetin e bimëve, se sa mungesa e elementëve ushqyes në bimë. Që të bëjmë një punë sa më efikase dhe shkencore duhet të bëhen analizat e tokës, ku do mbjellim pemët frutore. Por, duhet theksuar, se dhe kur janë shifrat në parametrat normale, ata nuk janë gjithçka për një ushqim të garantuar, pasi ajo varet dhe nga aftësia thithëse e këtyre elementëve nga bima.

Përfaqësuesi i kompanisë "Sygenta", profesor Vasil Zafirati, flet për spërkatjet që duhen kryer te pema në faza të ndryshme të zhvillimit, si dhe cilët janë preparatet më të mira kimikë. Detyra e tyre është, jo vetëm të mbrojnë frutin nga sëmundjet dhe dëmtuesit, por të mos bëhen të rrezikshëm për konsumatorin. Fermerët i njohin një pjesë të tyre, por ka dhe të reja me shumë interes. Ndaj ata mbajnë shënime dhe pyesin ku mund të gjejnë të dhëna të mjaftueshme për ta.

Jo pak interesante ishte dhe paraqitja e Aris Konstandinis, përfaqësues i kompanisë greke, Vitros Hellas. Kompania e tyre, e themeluar në vitin 1986, është e njohur në promovimin e mekanikës bujqësore, por jo vetëm kaq. Arisi tregon se ata prodhojnë dy milionë fidanë hardhie, 30 përqind të tregut për pemët frutore dhe 70 përqind të tregut për kivin. Serioziteti dhe profesionalizmi e kanë bërë këtë kompani shumë konkurruese në shtetin grek e më gjerë akoma. Ata e bazojnë punën e tyre në kërkesat e konsumatorëve, që ndryshojnë vazhdimisht.

Së fundmi, përfaqësuesi grek paraqet në monitor një gamë të gjerë mjetesh mekanike të llojeve dhe përmasave të ndryshme, fushore dhe malore, që mund të jenë të nevojshme për fermerët në shumë procese pune.

Lektorët e kanë thënë fjalën e tyre. Fermerët kanë mbajtur shënime, bëjnë pyetje e diskutimi, paraqesin dhe ndonjë problem që kanë pasur në fermën e tyre dhe është momenti të konsultohen për zgjidhjen e tyre. Më pas shtrohet dhe një koktej, i cili shndërrohet përsëri në një mënyrë për të diskutuar akoma.

Ilir Pilku, eksperti i shquar i bujqësisë shqiptare, moderatori i takimit, premton se evente të këtij lloji do të ketë akoma për Dibrën dhe ndoshta do të zhvillohen në kushtet e fermës. Ndjekja rigoroze e këtyre hallkave të punës në fermë, shoqëruar me një mbështetje financiare, akoma më të madhe nga shteti, do të rrisin më shumë prodhimin, cilësinë dhe të ardhurat nga frutikultura, kjo degë kaq e rëndësishme e bujqësisë shqiptare.

Me rastin e 65 vjetorit:
Shaban Sinani e ka emancipuar shkencën shqiptare

SHABAN SINANI, studiuesi më në zë i kulturës shqiptare

Nga **XHAFER MARTINI**

Shaban Sinani është një figurë e njohur mediatike; gazetarët dhe televizionet dëshirojnë ta kenë mik në emisionet dhe ekranet e tyre. Ai, pra, nuk ka nevojë t'ia bëj unë portretin me fjalë, me të vetmen me të cilën operojnë shkrimtarët. Por unë do ta bëj këtë, sa të mundem e si të mundem, se, të shkruash për yjet e pedagogjikes së Peshkopisë dhe të mos përmendësh yllin më të ndritur, nuk shkon. Tani Shabanin e njohin të gjithë përmes shërbimeve që ofron televizioni. Në prill të këtij viti ai festoi gjashtëdhjetë e pesë vjetorin.

Kur flasim për botimet e Shabanit, ne kemi parasysh vetëm librat, kurse artikujt, referatet, kumtesat, intervistat dhe forma të tjera të shfaqjes së mendimeve, janë të pafundme për këtë autor. Më duket se të kohës kur ka punuar në Institut janë librat e tij: "Pengu i moskuptimit", 1997; "Sipërore", 1998; "Mitologji në eposin e kreshnikëve", 2000; "Kështjella e virtytit" (2001) e të tjera. Instituti i Kulturës Popullore kurrë nuk i ka pasur këto hapësira dhe as që ishte i orientuar ndaj tyre. Shaban Sinani kishte interesa të mëdha që nuk mund të plotësoheshin vetëm me punën që merrte rrogën. Këto vepra që përmenda do të shkruheshin prej tij edhe sikur ai të mos punonte në Institutin e Kulturës Popullore. Edhe sikur të punonte, fjala vjen, në një Qendër Kulturore që merrej me kulturën masive dhe shaptilografonte broshura për këtë qëllim, ai do t'i shkruante këto libra. Nuk e bënë vendet e punës Shabanin të madh, ai u dha ndriçim të ri vendeve të punës. Kudo që punonte, ai do ta ndjente veten ngushtë. Kultura që ka dhe mbi të gjitha intelekti i jashtëzakonshëm e bën që të jetë gjithëpërfshirës. Ai, nëse do të punonte, fjala vjen, në Institutin e Historisë dhe të Gjuhësisë, ta zëmë në sektorin e hartimit të fjalorëve, nuk mund të rrinte i mbërthyer vetëm pas kësaj pune. Ai nuk ishte "punonjësi shkencor tipik", që e ngarkonin me detyra dhe ai i kryen. Shaban Sinani e ka ngarkuar veten vetë, i ka zhvilluar vetë prirjet dhe aftësitë e veta.

Mbase i vetmi institucion që i shërbeu më shumë se të tjerët Shaban Sinanit është Arkivi i Shtetit, ku ai punoi shumë vjet si drejtues këtij institucioni. Drejtorët e tjerë të atij Arkivi mund të ishin drejtues të mirë si administratorë, por ata nuk e kishin aftësinë e Shaban Sinanit jo më për të punuar me arkivimin, por as për ta kuptuar pasurinë e tij. Shaban Sinani ishte një drejtor krejt tjetër. Duke qenë jo vetëm shkencëtar i aftë, por edhe nga natyra i zgjuar, ai kuptoi rëndësinë e artit që kishte nëpër duar dhe e shfrytëzoi atë në mënyrë të jashtëzakonshme për t'u pasuruar vetë, por edhe për të pasuruar të tjerët. Të gjithë librat e tij, kush më shumë dhe kush më pak, prej një mënyre ose në një mënyrë tjetër janë të lidhur me arkivin. Të gjithë librat e mirë janë të lidhur me arkivin. Nuk ka libër, i çfarëdo natyre qoftë, që nuk lidhet me arkivin. Këtu nuk duhet harruar se edhe populli është një arkiv i madh. Mbasi u njoh me gjendjen e fondit, ai përcaktoi drejtimin e punës së tij. Në Arkivin e Shtetit, ku kam pasur fatin të punoj për një kohë fare të shkurtër (kur merrja të dhëna për Elez Isufin), ka dokumente edhe për një gjel që i është marrë fshatarit pa të drejtë. Shaban Sinani u kap mbas majave. *Kodikët*, mbase, ishin maja më e madhe. Kadareja, që mbas fillimit të proceseve demokratike, u vu në qendër të opinionit shoqëror pothuaj më shumë se kushdo tjetër, ishte një tjetër majë. Por nuk ishte fjala vetëm për *Çështjen Kadare*, por për një vështrim më të gjerë: për raportet e shkrimtarëve me diktaturën në të cilën u detyruan të jetojnë.

STUDIMET PËR LETËRSINË SHQIPE

Shaban Sinani e ka studiuar letërsinë jo vetëm, si të thuash, drejtpërdrejt, nëpërmjet autorëve si De Rada, Camaj, Agolli, Kadare, por edhe me vepra të veçanta, si: "Për letërsinë shqipe të shekullit XX", Tiranë 2010; "Historia e letërsisë shqipe: çështje të hapura", "Letërsia në totalitarizëm dhe "Dossier K." e të tjera. Shaban Sinani nuk shkonte në zyrë për t'u kapardisur, ai shkonte me mendimin se çfarë të kërkoj dhe të gjej sot, se nesër më duhet të kërkoj dhe të gjej gjëra të tjera. Kishte një aftësi të jashtëzakonshme, siç thonë, për t'i orientuar studimet e tij dhe për të kërkuar edhe ndihmën e të tjerëve pa dëmtuar funksionimin e gjërave. Librat dhe shkrimet e tij me burim të drejtpërdrejtë me Arkivin janë të shumta dhe me vlerë të jashtëzakonshme. Shaban Sinani besoj është nga të parët në shkencën tonë që ka kuptuar se dokumentet nuk kanë vlerë si të tillë, pa interpretim. Ai di t'i interpretojë faktet, di që jetën e letrave, të shkresave, të dokumenteve ta përfytyrojë si prodhimtari, si një shtresë shumë e rëndësishme e jetës së gjallë që është pasqyruar në ato dokumente. Çdo fakt, çdo dokument është produkt i një kohe të caktuar, i një dore që e ka shkruar që ka bërë përpjekje për ta "ngrirë" dhe për ta bërë të përjetshme. Koha që jetohet, e tashmja, vetëm nëpërmjet dokumenteve, "ngrin", që të mos na bëhet ujë, vetëm nëpërmjet dokumenteve ajo "kthehet prapë". Në këtë shtresë shkresore, prej letre, depërtohet si nga një derë e madhe, për të hyrë në të kaluarën, në marrëdhëniet, interesat, luftërat, përpjekjet. Duhet që këtë shtresë shkresore ta zgjosh nga *memecllëku, t'i japësh jetë, ta vësh në lëvizje, ta ngresh si një perde të madhe të skenës ku janë luajtur tragjedi njerëzore dhe ku janë kryqëzuar dhe përplasur fate njerëzish, me qëllim që kohën e dikurshme, ta biesh në kohën tonë.* Kjo është një fjalë goje ta thuash, por ta bësh është shumë e vështirë dhe përpara se ta bësh, duhet ta kuptosh. Vetëm Shaban Sinani, nga të gjithë drejtuesit e atij institucioni, e kuptoi ç'ishte arkivi.

Në veprën "Kodikët kronografikë të Shqipërisë" - doreshkrime prej Rilindjes Europiane deri në Rilindjen tonë Kombëtare, me të dhëna të rëndësishme për kishën, si një pjesë e kujtesës kombëtare që shfaqet në shkrime të shumta letrare, historike, çka përbëjnë të gjitha tekstologjinë e kombit tonë, nëpërmjet të cilit del mënyra e organizimit shoqëror të jetës në atë periudhë historike, në qytetet më në zë të Shqipërisë që kanë pasur "Kanunet" e veta prej të cilave janë qeverisur, - është historia jonë për shumë shekuj. Historia e Shqipërisë dhe shumë shkenca të tjera albanologjike që kanë të bëjnë me të kaluarën e popullit tonë, nuk mund të studiohen pa studiuar Kodikët. Kodikët e kultit të krishterë janë jo vetëm dëshmi të mëdha shpirtërore, por edhe shprehje të emancipimit kulturor të studiuesit, i cili, ndonëse vetë është mysliman, nxjerr në pah dhe studion një ndër monumentet më të mëdha të kulturës sonë kristiane.

Librat dhe shkrimet e tij me burim të drejtpërdrejtë me Arkivin janë të shumta dhe me vlerë të jashtëzakonshme. Shaban Sinani besoj është nga të parët në shkencën tonë që ka kuptuar se dokumentet nuk kanë vlerë si të tillë, pa interpretim. Ai di t'i interpretojë faktet, di që jetën e letrave, të dokumenteve ta përfytyrojë si prodhimtari, si një shtresë shumë e rëndësishme e jetës së gjallë që është pasqyruar në to.

MBROJTJA E HEBRENJVE

Një kontribut i madh i këtij studiuesi lidhet me nxjerrjen në dritë me fakte e dokumente një prej të vërtetave të mëdha të shekullit të kaluar: hebrenjtë dhe fati i tyre në Shqipëri. Por ishte Shqipëria e asaj kohe që ishte e pushtuar nga gjermanët. Gjermanët, edhe pse pushtues, ishin dashamirës me qeverinë shqiptare që u ngrit dhe nuk do të përziheshin në punët e saj, por për çështjen e hebrenjve ata nuk lëshonin pé: do t'ia kërkonin qeverisë listat e tyre dhe do t'i mblidhnin hebrenjtë edhe nga Shqipëria, siç bënë në të gjitha vendet e tjera. Hebrenjtë u përndoqën dhe u persekutuan skajshmërisht në të gjitha vendet ku ata ndodheshin. Në këtë batak ranë shumë personalitete botërore nga më të shquarit. Vetëm Shqipëria e vogël dhe populli i saj krenar i ruajti dhe i mbrojti hebrenjtë, me çka i ka ngritur vetes një monument të madh lavdie. Ne flasim çdo ditë edhe sot e kësaj dite për holokaustin, por nuk e dimë mirë tragjizmin që shkaktoi ai dhe mënyrat e shfaqjes. Shaban Sinani i bën një shërbim shumë të madh çështjes kombëtare, kur para botës prezanton Shqipërinë me dokumente dhe fakte, si mbrojtëse të hebrenjve. Është nga studimet më të plota të këtij autori. Ambasadori i SHBA-së në Shqipëri, z. John L. Withers II, kur flet për këtë kontribut të madh të autorit shqiptar, thotë se "Në Shqipëri ndodhi një bashkim i të gjitha kaheve politike dhe të besimeve fetare-antifashistë dhe profashistë, komunistë dhe nacionalistë, myslimanë dhe të krishterë, besimtarë dhe jo besimtarë për të siguruar që asnjë hebreu të strehuar në Shqipëri nuk do t'i hynte gjemb në këmbë". Natyrisht, kjo ndodhi, por ky bashkim për të mbrojtur hebrenjtë nuk ka ndodhur gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe as që ka lindur vetëm për hebrenjtë. Ky humanizëm ka lidhje me kodin tonë zakonor, me *Kanunin*, i cili institucionin e *Mikut* e ka më të rëndësishmin dhe më të shtrenjtin. Për mbrojtjen e *Mikut* shqiptari ka dhënë jetën e djalit të vetëm. Strukturat shtetërore këtu nuk kanë asnjë rëndësi. Në vitet e para pas çlirimit në Peshkopi mbeti një doktor hebre, doktor Shyqyriu, i cili ka shërbyer në këtë qytet dhe në rreth për pesë-gjashtë vjet, derisa u arratis prej regjimit komunist po me ndihmën e shqiptarëve. Ai bëri tri orë në këmbë për të ardhur në Fushë Alie dhe për të vizituar një vajzë të re që ishte prekur nga tuberkulozi. Në një bisedim miqësor me fshatarët e këtij fshati, ai u shpreh kështu: "Ne izraelitët, çdonjëri prej nesh, ia ka borxh çdo gjë popullit shqiptar, lavdia e të cilit qëndron në faktin se asnjë nga bashkëkombasit e mi nuk u dorëzua te gjermanët, në një kohë kur ndër shtete të tjera janë dorëzuar të gjithë ata që u kapën ose u identifikuan. Lavdia juaj ka të bëjë me kodin tuaj zakonor, me Kanunin, i cili institucionin më të fortë ka atë të Mikut".

ZBULIMI I DOSJES SË KADARESË

Burim i Arkivit të Shtetit janë edhe veprat "Letërsia në totalitarizëm dhe "Dossier K", "Një dosje për Kadarenë". Në të dyja këto libra ka vëzhgime interesante. Dukurinë e shtypjes së personalitetit të shkrimtarit Shaban Sinani e ka vërejtur vetëm te Kadare. Ai ishte shkrimtari më i madh, por jo më i persekutuari prej regjimit. Këtë të gjithë e dinë. Autori me të drejtë preferon të merret vetëm me shkrimtarë të mëdhenj, por letërsinë shqipe nuk e kanë bërë vetëm ata. Nga ana tjetër, nuk mund të nxjerrësh konkluzione të drejta për procesin kur kapesh nga majat, nuk mund të nxjerrësh konkluzione të drejta kur e përcakton qëndrimin apriori dhe jo duke u nisur nga vepra. Kur merret posaçërisht me Kadarenë, autori, për mendimin tim merret në mënyrë të njëanshme: vetëm për të nxjerrë në pah meritat e tij. Kadare, nuk ka dyshim, është një gjeni, por gjenitë kanë edhe të meta dhe dobësi, nganjëherë të mëdha, në karakter, që duhen studiuar bashkë. Shaban Sinani është i kësaj linje mendimi që jeta e shkrimtarit dhe vepra e tij duhen parë në unitet. "Biografia, për shembull, ka qenë dhe mbetet një përbërëse themelore e krijimit në të gjitha kohërat, një shtysë parësore për krijimtari. Sepse, përderisa letërsia është shprehje e një gjendjeje të lartë shpirtërore, jeta e shkrimtarit nxit krijimtarinë". (Shaban Sinani: "Letërsia në totalitarizëm dhe "Dossier K", 2011: 133) Unë kam mendim të kundërt, por, meqë Shabani është i asaj linje, duhet t'i qëndronte besnik asaj. Vepra e Kadaresë shpeshherë është e ndryshuar. Ka disa variante për një vepër, duke e larguar secilën prej tyre nga shtrati fillestar. Nuk janë kurdoherë ndryshime artistike, kanë edhe

Një kontribut i madh i këtij studiuesi lidhet me nxjerrjen në dritë me fakte e dokumente një prej të vërtetave të mëdha të shekullit të kaluar: hebrenjtë dhe fati i tyre në Shqipëri.
Shaban Sinani i bën një shërbim shumë të madh çështjes kombëtare, kur para botës prezanton Shqipërinë me dokumente dhe fakte, si mbrojtëse të hebrenjve. Është nga studimet më të plota të këtij autori.

studim

Shaban Sinani, edhe pse merret me kulturën popullore, siç është eposi i kreshnikëve, ai sjell të dhëna me interes edhe për fusha të tjera, sidomos në fushën e historisë, për problemin më kardinal,- kalimin nga pavetëdija e arbërve në lidhje me kombësinë, kalimi në vetëdijen e një kombësie të dallueshme në periudhat e mëvonshme - gjë të cilën historianët nuk e kanë kryer ose e kanë kryer me konfuzion dhe të meta të natyrave të ndryshme.

veprat më të shquara të Shaban Sinanit i përkasin studimit të kulturës popullore. Këtu ai është, si të thuash, në shtratin e vet, shkruan me kompetencë, lirshëm dhe me stil elokuent, sa e bëjnë Shaban Sinanin një dijetar të madh, që komunikon me lexuesin jo nga pozita të ftohta akademike, por si një stilist i shquar.

motive të tjera. Shabani, ashtu si kalimthi shkruan: "Nuk mund të përjashtohet një fazë e tretë, ku është e vështirë të ndahet frymëzimi, pranimi vullnetar i realizmit socialist, prej ndikimit apo imponimit të kanoneve zyrtare. Në 1968 ai boton vëllimin "Motive me diell", me poezi të tilla, si: "Dalja e shqiptarëve nga Traktati i Varshavës" dhe "Shqiponjat fluturojnë lart", që "e vunë Kadarenë ndër shkrimtarët më pranë partisë". Dy poemat e njohura: "Shqiponjat fluturojnë lart" dhe "Përse mendohen këto male", si dhe romanet "Kështjella", i shkruar në 500 vjetorin e vdekjes së Gjergj Kastriotit, mbajnë shenjën e kësaj faze. Botimi i romanit "Kështjella" përkon njëherësh me daljen e Shqipërisë nga Traktati i Varshavës dhe fillimin e vetveçimit të vendit ndaj botës. Nëse në gjithë periudhën e mëvonshme historia ka qenë gjithnjë një shkas për aludim kundër bashkëkohësisë, në këtë roman aludimi - të paktën sipas receptorëve të parë - ishte për ta lartësuar epokën e re. Ikja prej historicizmit dhe aluzioni pozitivist për Shqipërinë e rrethuar, për qëndresën historike, për demonët e pafund përqark saj, bashkojnë vullnetarizmin me kanonizmin. "Dasma" do të ishte lëshimi i fundit i kësaj periudhe. Më vonë, Kadare romanin "Kështjella" do ta ripunonte thellë, kurse "Dasmën" do ta qortonte më shumë se gjithë kritikët e tij të marrë së bashku: Arshi Pipa, Martin Camaj, Bilal Xhaferi, Petro Marko, Rexhep Qosja dhe të tjerë". (Shaban Sinani: 2011: 94) Por përveçse këtu në këtë faqe dhe me aq sa citohet, Shaban Sinani nuk i fryn askërkund tjetër kësaj kundërshtie. Ai thotë se romanin "Kështjella" e ripunoi thellë. Po përse? Cilat qenë motivet? Dhe Kadare nuk e ka bërë këtë vetëm në një vepër!

SI STUDIUES I KULTURËS POPULLORE

Për mendimin tim veprat më të shquara të Shaban Sinanit i përkasin studimit të kulturës popullore. Këtu ai është, si të thuash, në shtratin e vet. Të marrim vetëm njërën prej tyre: "Pyetje në albanologji", Tiranë 2013. Në të janë përmbledhur një sërë shkrimesh për dukuri dhe personalitete të kulturës sonë, janë studiuar kaq thellë, kaq me kompetencë, janë shkruar kaq bukur, lirshëm dhe me stil elokuent, sa e bëjnë Shaban Sinanin një dijetar të madh, që komunikon me lexuesin jo nga pozita të ftohta akademike, por si një stilist i shquar. Përmendim disa artikuj dhe studime që janë përmbledhur në këtë libër, si: "Etnosi shqiptar dhe eposi shqiptar", "Beteja e Kosovës 1398 - një ep shqiptar", "Mbeçë, more shokë, mbeçë": këngë nizamësh apo pelegrinësh", "Një koleksion këngësh popullore nga dom Nikollë Kaçorri", "Letërkëmbimi i Dora d'Istrias me Angelo de Gubernatis, "Personaliteti i Hasan Cekës dhe fillimet e arkeologjisë shqiptare", "Lef Nosi dhe Margaret Hasluck" e shumë e shumë artikuj dhe studime të tjera, i japin këtij autori lavdinë e merituar.

Shaban Sinani këtu është në një truall të fortë prej guri, ka themele që nuk lëkunden. I trajton për herë të parë vetë këto tema, por, edhe kur ndonjë e kanë trajtuar të tjerët, ai del mbi të gjithë si për freskinë e trajtimit, ashtu edhe për përfundimet që nxjerr. Ai jep definicione dhe sqaron koncepte. Ai është i saktë në formulimet që i jep me superioritet. Kështu, si shembull, për të studiuar eposin dalin para lexuesit terma si parahistoria dhe historia, që janë dy disiplina të ndryshme. Ç'është historia njerëzit e dinë, por ç'është parahistoria, e thotë shumë bukur Shabani: "Parahistori në studimet për letërsinë gojore është gjithë ç'i përket kohës prej fillimeve të vetëdijes estetike njerëzore deri në shfaqjen e epikës historike". (Shaban Sinani: "Pyetje në albanologji", 2013, f. 9) Dhe më tej vazhdon të sqarojë koncepte të tjera: "Në vështrimin e A. Budës etnosi ilir dhe etnosi shqiptar janë dy nocione të ndryshme, të cilët i bashkon vazhdimësia gjenetike, historike dhe territoriale**.** Prej formimit të etnosit ilir deri tek formimi i etnosit arbër/shqiptar janë më shumë se njëmijë vjet, gjatë të cilave ndodh përveçimi, lulëzimi dhe shuarja e njërit qytetërim dhe lindja, mëkëmbja dhe pohimi i tjetrit". (Sinani: 2013: 9) Ka shumë njerëz që u bien në qafë studimeve nga fusha e kulturës popullore dhe i bëjnë gjërat lëmsh se nuk kanë asnjë koncept. Shaban Sinani është një mësues i madh për të gjithë ata që duan të mësojnë. Ai në veprat e tij ka shumë koncepte, formulime origjinale për shumë dukuri të fushave të ndryshme: "Fillimet e epikës historike Buda i gjen në ciklin e Gjergj Kastriotit që është ruajtur midis arbëreshëve, në formë popullore tradicionale dhe në formë të redaktuar prej romantikëve, si "Rapsodi e një poemi arbëresh" e De Radës". (Sinani: 2013: 12)

Dora-dorës, me një përsosmëri metodike, me një stil që vetëm sa vjen e bëhet më i qartë dhe më implusiv, Shaban Sinani jep koncepte të reja: "Në eposin legjendar ka vetëm heronj kulturorë, heronj historikë nuk ka. Në këngët heroike legjendare nuk ka as Shqipëri, as Arbëri, as atdhe të përkufizuar. Trojet, bjeshka, mali, janë nocione të përgjithshme që mundësojnë përfytyrimin e një atdheut poetik". (Sinani: 2013: 15)

Shaban Sinani, edhe pse merret me kulturën popullore, siç është eposi i kreshnikëve, ai sjell të dhëna me interes edhe për fusha të tjera, sidomos në fushën e historisë, për problemin më kardinal,- kalimin nga pavetëdija e arbërve në lidhje me kombësinë, kalimi në vetëdijen e një kombësie të dallueshme në periudhat e mëvonshme - gjë të cilën historianët nuk e kanë kryer ose e kanë kryer me konfuzion dhe të meta të natyrave të ndryshme. Shikoni sa bukur dhe qartë shprehet Shabani: "Vetëdallimi etnik i arbërve ka qenë një proces shumë i vështirë, për shkak të gjendjes së organizimit shoqëror të tyre, të ndërhyrjes së kufijve perandorakë dhe të shtyrjes së ndërsjellë të autoritetit të kishave. Kjo vjen deri në periudhën heroike të Gjergj Kastriotit, kur arbërit bëhen të njohur në Europë për qëndresën e tyre antiosmane, por duke u quajtur e vetëquajtur herë epirotë, herë maqedonas, herë albanë". (Sinani: 2013: 18) Sigurisht, Shaban Sinani nuk ka lindur i ditur, edhe ai ka mësuar si të gjithë të tjerët. Por ai din prej kujt mëson dhe atë që mëson di si ta shprehë. Për shembull, po të shikosh referencat e tij, ato janë jo referenca për referenca, por dëshmi e hulumtimit, studimit dhe përzgjedhjes së mënyrës së paraqitjes së veprave të mëdha të autorëve të mëdhenj. Shaban Sinani e ka shumë të lartë shkallën e asimilimit, përvetësimit, të thithjes dhe të absorbimit të asaj që merr prej të tjerëve. Formimi kulturor i tij ka ardhur sa prej shkollës, aq edhe prej studimeve; sa prej mendjemprehtësisë, aq edhe prej punës së palodhur dhe vullnetit të çeliktë.

Të shikojmë çfarë thotë Shabani për këngën shumë të njohur "Mbeçë, more shokë, mbeçë". Ne, sipas folklorit tonë, e kemi mësuar atë si këngë nizamësh. Kjo ide ka përshkuar studimet tona për këtë këngë. Kuptohet, se një nisje e gabuar të çon në përfundime të gabuara. Ajo nuk është këngë nizamësh dhe, duke mos qenë e tillë, komentet që i janë bërë janë të gabuara. Folkloristika jonë ka arritur në këto përfundime, se studimet e saj kishin një natyrë të klishetizuar, niseshin nga disa ide dhe përfytyrime abstrakte dhe nuk studiohej në imtësi vetë kënga, teksti i saj. Përfundimet jashtëtekstore janë gjithnjë të gabuara. Ja si shprehet Shaban Sinani për këtë këngë: "Por të dhëna dhe detaje brenda tekstit të këngës të çojnë në mënyrë bindëse në përfundimin se kjo është një këngë pelegrinësh, këngë e ritualit të haxhillëkut, përmes së cilës subjekti në mënyrë eufemike linte porositë e fundme në familjen e tij, duke qenë i pasigurt në fatin e rikthimit; një këngë dhimbjeje për mundësinë e humbjes së familjes, atdheut, vendit të të parëve". (Sinani: 2013: 47) Shaban Sinani tregon edhe arsyen pse ka rëndësi përcaktimi i saktë i tipologjisë së këngës, pra, që nuk është këngë nizamësh, por këngë për haxhillëkun. Sepse ajo, duke u konsideruar si këngë nizamësh, ka futur në hullinë e saj edhe krijimtarinë letrare të kultivuar të shekullit XX. Kujtojmë këtu, thotë Shabani, "Baladë nizamësh" e I. Kadaresë, me vargun hyrës "O ju korba që më hani"; "Kaloje urën, zemra ime" dhe "Këngëtari i maleve" të Xh. Spahiut; integrimi tërësor i këngës në poemën "Nënë Shqipëri" të D. Agollit..., si dhe dhjetëra këngë kushtuar Demir Zykos; janë vetëm prej pak ilustrimeve që dëshmojnë se si një *metatekst* mund të transmodelojë (unë do të thosha të fusë në rrugë qorre -xh.m), prej keqkuptimit krijimtarinë që mbështetet në të". (Sinani: 2013: 52) Po kështu, krejt i gabuar është përcaktimi i tipologjisë për këngën e njohur dibrane "Oj fusha e Korabit", si këngë mërgimi. Shabani për këtë këngë shkruan kështu: "Rasti më flagrant i largimit të motivit popullor prej kuptimit burimor është ai i këngës "Oj fusha e Korabit", e cila është një këngë e mirënjohur shtegtimi ("Bajne si t'ja bajsh / për Gjallajc t'më vajsh") janë dy vargje që shënojnë saktësisht kthimin e barinjve nga bjeshka në vërri), por studiuesit e paraqitën në skena festivalesh si këngë mërgimi, duke ia ndryshuar krejtësisht frymën". (Sinani: 2013: 63). Kështu shtrembërime pa fund ka në të gjitha këngët e tjera të Dibrës. Shumë veprime të kësaj natyre janë bërë jo nga padija, por nisur nga qëllime ideologjike. Për shembull, të heqësh nga një këngë historike disa protagonistë historikë të papëlqyer prej regjimit dhe t'i zëvendësosh ata me të tjerë "patriotë" është më shumë se një lajthitje shkencore. Kështu, si shembull, ka ndodhur me këngën për Hajredin Pashën, kur këngëtarët dhe përdoruesit e kësaj kënge kanë fshirë dhe kanë shtuar emra sipas oreksit të tyre. Gabimet në tipologji janë të ndryshme. Këto gabime i bëjnë jo vetëm amatorët e sotëm dibranë, por edhe Haki Stërmilli në ndonjë rast, kur fjala vjen, një këngë e trimërisë individuale merret si këngë trimërie atdhetare, një vrasje pas ferrave, sipas neneve të Kanunit, merret si akt trimërie i mirëfilltë, një hakmarrje personale interpretohet si veprim i madh atdhetar.

STUDIMET MBI KANUNIN

Ky autor është marrë edhe me problemet e Kanunit. Por ai ka parasysh vetëm Kanunin e Lekë Dukagjinit, pse ai është më i pari kanun i njohur, në një kohë kur janë botuar edhe shumë kanune të tjerë. Por këto Shaban Sinani i fut tek ndryshorët, domethënë te variantet e Kanunit të Lekë Dukagjinit. Në shenjimin nr. 122, në faqen 146 të librit "Etnos në epos", Tiranë 2011, f. 146, ai shkruan: "Ndër të tjera mund të veçohen këto botime: Xhemal Meçi, "Kanuni i Lekë Dukagjnit" - varianti i Pukës, Tiranë 1996; idem: "Kanuni i Lekë Dukagjinit në variantin e Mirditës", Tiranë 2002; Shefqet Hoxha, "Instituti i kuvendit në Lumë - punim etnologjiko-historik", Tiranë 2002; Xhafer Martini: "Kanuni i Maleve të Dibrës", Tiranë 2003; idem: "Kanun i Dibrës" , Tiranë 2007; ibidem: "Gjakmarrja: komente, raste, situata", Tiranë 1999 etj."

Shaban Sinani te "Kanun e kuvend", në librin "Kështjella e virtytit" bën konstatime të mprehta dhe origjinale, që orientojnë studimet tona të mëtejshme për kanunet shqiptare se ata, me të drejtë, shikohen prej këtij studiuesi jo vetëm si e drejta zakonore tradicionale, por edhe si modele të organizimit tradicional të jetës së shqiptarëve që nga koha kur ata kanë jetuar në këtë tokë. Njerëzit, sapo u dalluan nga kopja e kafshëve kishin nevojë për një rregullator të jetës dhe ky ishte kanuni, i cili as nuk u krijua përnjëherë, as u krijua nga një njeri. Ai është prodhim shkencor i shekujve dhe mijëvjeçarëve dhe i mijëra brezave njerëzorë. Prandaj mua nuk më duket e drejtë ajo që thuhet në librin "Etnos në Epos", Tiranë 2011, f: 66: "Rendi etnojuridik që sundon në epikën heroike legjendare dhe në statutet e qyteteve shqiptare të periudhës osmane është shumë më i hershëm se ai kanuneve". Nuk po flas për epikën heroike legjendare, se unë nuk e konceptoj se si në të të kishte një rend juridik, por e them me plot bindje se kanunet që kanë rregulluar jetën e shqiptarëve, janë shumë më të lashtë se statutet e qyteteve shqiptare. Derisa janë zhvilluar qytetet dhe ka filluar organizimi i tyre, sa janë hartuar rregullat e të tjera, kanë kaluar mijëra vjet që kur njerëzit kanë ndarë "imja" nga "jotja". Por unë i jap shumë të drejtë Shaban Sinanit kur ai e shikon kanunin jo vetëm si dëshmi e një rendi juridik, por edhe dëshmi e lashtësisë që shkon deri në papërceptim: "*Vetëm një popull i ngulitur prej kohësh mund të arrinte të përpunonte në atë shkallë me të vërtetë të lartë elementë të vetëdisiplinës dhe të autopërgjegjësisë. Një popull që arrin të krijojë një kod të normuar bashkëjetese duhet të ketë zotëruar më parë një kulturë të ngulitur etnike. Një mënyrë bashkëjetese e pranuar pa kushte nga të gjithë do shekuj të tërë të rregullohet me norma të njësuara. Kanuni shpreh ekzistencën e një jetë urbane qytetare dhe të një ndërgjegjeje bashkësie të hershme*" (Shaban Sinani: "Kështjella e virtytit", Tiranë 2001, f. 57) Mua më vjen mirë që Shaban Sinani si studiuesi më në zë i kulturës shqiptare ka këtë mendim për kanunin, ndryshe nga të ashtuquajtur "dijetarë" që tremben prej kanunit si prej djalli dhe e quajnë atë mjerimin e këtij populli, që nuk po i ndahen mjerimet**.** Në tej Shabani e pasuron këtë mendim kur thotë: "*Ishte ky kanun jo vetëm e drejta e rregullimit të bashkëjetesës (convente), por edhe e drejtë familjare, e drejtë civile, e drejtë pune e procedure, një ansambël i vërtetë drejtësie, ku përcaktoheshin në mënyrën më të sintetizuar raportet e njeriut me familjen, me fisin, me miqësinë, me flamurin dhe me atdheun*". (Shaban Sinani: "Kështjella e virtytit", Tiranë 2011, f. 58). Nuk ka si të thuhet më saktë dhe më bukur. Këto janë postulatet e Shabanit që i ka me dhjetëra në veprat e tij. Kemi të bëjmë me një autor orientues, përkufizues, formulues i koncepteve saktë, qartë dhe shkurt, çka përbën një bazë të shëndoshë për të ecur pa frikë se gabon në gjurmët e tij. Për mua, sado gabime të vogla të bëjë Shaban Sinani në lidhje me shfaqje të ndryshme të kanuneve, nuk kanë asnjë rëndësi përpara këtyre përcaktimeve bazë, përpara këtyre shinave që shtron ai në rrugën e kanuneve shqiptare.

Shaban Sinani e ka emancipuar shkencën tonë me luftën e drejtë që ka u bërë miteve, tabuve, klisheve dhe lloj-lloj *lëmyshqeve,* fryt i studimeve në periudhën e diktaturës.

Marrë me shkurtime nga libri "Pedagogjikja, personalitete", i autorit Xhafer Martini.

Jo vetëm aktivitetet kulturore e mësimore, por dhe ato sportive janë pjesë e përditshmërisë së kësaj shkolle.

Shkolla e Pocestit

Nga **OSMAN XHILI**

Pocesti është fshati më i madh i Maqëllarës dhe një ndër më të mëdhenjtë e Dibrës. I shtrirë në këmbët e vargmaleve, që e rrethojnë nga sipër, ai ngjan si një ballkon i madh, nga ku sodit lirshëm gjithë fushën pjellore të Maqëllarës. Pocesti është i madh jo vetëm në numër njerëzish e shtëpishë, por dhe në histori, kontribute e vlera njerëzore.

Breza të tërë arsimtarësh, madje nganjëherë dhe dy tre të tillë për familje dhanë më të mirën e tyre për edukimin e brezave. Ibrahim, Agron dhe Idajete Neziri, nga e njejta familje, lanë gjurmë në dekada në mësimdhënje. Shefki dhe Ferizate Bajraktari, bashkëshortët fisnikë të kësaj dere të shquar, jo vetëm edukuan gjenerata studentore, por rritën e shkolluan fëmijët e tyre në mënyrë të shkëlqyer. Po të tillë ishin dhe Ali e Tule Liçaj, të njohur dhe në zonë për kontributet e tyre. Ata, jo vetëm ishin mësues të mirë, por dhe drejtues e organizatorë të talentuar.

Një tjetër familje e shquar është dhe ajo e mësuesit Gëzim Hoxha. I jati i tij, Ilmiu, ishte një teolog i shquar i zonës, duke edukuar besimtarë të shumtë me njohjen e Zotit të Gjithësisë, me ndalesën nga e keqja e garimin për punë të mira. I biri Gëzimi, bashkëshortja e tij Servetja dhe dy fëmijët e mrekullueshëm, Artani dhe Blerimi, sikur e plotësojnë më së miri, portretin e kësaj familje intelektuale.

Lista e vlerave intelektuale të këtij fshati është e gjatë. Shpëtim dhe Nexhmije Kurtulla nuk mund të harrohen lehtë nga nxënësit e tyre të shumtë. Mësuesi e drejtuesi Xhevahir Hoxha është një nga vlerat e shtuara të këtij fshati me histori. Beqir Osmani ishte mësues dhe sportist i talentuar. Për disa vite drejtoi komunën e Maqëllarës, duke ndërtuar dhe shkollën e Pocestit, që është në qendër të shkrimit tonë. Për shumë kohë pata mundësinë të punoj nga afër me agronomin dhe mësuesin e shquar, Hashim Osmani, që bashkë me të shoqen rritën dhe edukuan tre fëmijë me shkollime të larta. Nuk mund të le pa përmendur Neki Hidrin, mikun tim dhe shokun e klasës në shkollë të mesme. Një aksident fatal i ndërpreu jetën, në një kohë që ai kishte dhe shumë për t'i dhënë shkollës dhe shoqërisë. Mahmut Burnazi, Sere Burnazi, Faik Neziri e shumë emra të tjerë, e çojnë në dhjetra e dhjetra numrin e intelektualëve të këtij fshati.

Nuk mund të lëmë pa përmendur dhe një kategori tjetër mësuesish të këtij fshati, ato të besimit. Stafetën e atyre burrave të shquar hoxhallarësh që nuk jetojnë më, po e përcjellin me dinjitet një brez i ri, ku spikasin, Muiz Kurtulla, myftiu i rrethit, Mexhit Rexha imami i nderuar i xhamisë së Maqëllarës, Meleq Hyseni,Vullnet Kurtulla e shumë të tjerë.

Kësaj liste të gjatë emrash të shquar e të nderuar, do të desha ti shtoj dhe emrat e drejtorëve të kësaj shkolle, në gati njëzetë vite. Avdi Neziri, Ramazan Piku, Besim Qoku, Hajri Xhili, Novrus Skuka, Artan Hyseni, Gëzim Qoku, Marsida Vishka, Shpend Pilafi dhe Nexhmie Sula, që vazhdon të drejtojë këtë shkollë me shumë kompetencë e dinjitet.

Këto janë vetëm një pjesë e atyre burrave e grave që bënë histori, pasi shumë shpejt do të botohet një libër historik për këtë fshat me kulturë e tradita të bukura.

SHKOLLË QENDËR KOMUNITARE

Duke pasur një status të tillë, shkolla e Pocestit është munduar ta përligjë më së miri këtë gjë, duke mbledhur, grumbulluar e sistemuar ajkën e mendimit, të kulturës e traditave të fshatit dhe zonës. Të gjithë nxënësit e stafi i mësuesve punuan fort për muaj të tërë, për ta konkretizuar këtë event në formën e një feste me të vërtetë të

Pocesti është fshati më i madh i Maqëllarës dhe një ndër më të mëdhenjtë e Dibrës. I shtrirë në këmbët e vargmaleve, që e rrethojnë nga sipër, ai ngjan si një ballkon i madh, nga ku sodit lirshëm gjithë fushën pjellore të Maqëllarës. Pocesti është i madh jo vetëm në numër njerëzish e shtëpishë, por dhe në histori, kontribute e vlera njerëzore.

mrekullueshme. Ndihmesa e prindërve dhe e komunitetit ishte e pakursyer, duke bërë që edhe rezultatet të ishin mbresëlënëse.

Do të ishte data 4 qershor e vitit, që sapo lamë pas. Shkolla ishte dekoruar në një mënyrë të shkëlqyer, ku nuk mungonin lulet, trëndafilat, banderolat dhe të ftuarit e shumtë. Ashtu si dhe shumë herë të tjera, dhe kësaj rradhe kisha një ftesë të veçantë, si mik i kësaj shkolle. Fëmijët e tanishëm nuk dinin asgjë nga dasmat që bëheshin dikur. Ato ishin me pak shpenzime, por me shumë vlera e shumë klas. Nxënësit e talentuar të kësaj shkolle na kthyen në kohë, vite më parë.

Kapllan Kosiqi luajti mjeshtërisht rolin e dhëndrit, Ardita Rustani, atë të nuses. Ismail Kurtulla ishte daja i dhëndrit. E luante krejt natyrshëm këtë rol, me një gjuhë të pasur e plot kolorit, i ulur këmbëkryq në krye të valles, me veshje popullore të qëndisura bukur, duke ftuar miqtë të zinin vendet në odë. Kjara Liçaj ishte nëna, kurse Erol Turshilla, babai i dhëndrit.

Momente të bukura të dasmës ndiqnin njëri tjetrin. Veshjet popullore të qëndisur bukur, këngët, folklori, ardhja e dajave, pritja e përcjellja e krushqve, bluarja e drithit, bërja gati e nuses dhe e dhëndrit, u luajtën nga nxënësit, tamam si aktorë profesionistë. Këngë popullore të zbehura ndër vite, vinin si nga një planet i largët, për tu ricikluar në kohët tona moderne.

...O Ferit, të shkoftë marë,
Na bjer miell, sa më parë,
Ta bëjmë bukë për pashallarë...

Njerëzit e pranishëm u emocionuan deri në përlotje. Ata ishin nënat dhe baballarët e këtyre nxënësve të talentuar. Kujtonin dasmën e tyre të bërë në këtë lloj formati dhe vërtetë sot kishin përjetuar momente të bukura. Falenderonin pa kufi dhe stafin e mësuesve , që realizuan këtë program, ku evokoheshin vlerat e kohës së kaluar, traditat e bukura të zonës, që aq mirë ishin ruajtur në kujtesën popullore.

Vallet popullore të djemve dhe vajzave, veshur me kostume që vinin nga lashtësia, ishin vërtetë të mrekullueshme. Por gjithsesi, ata kishin një aktor dhe dirigjent profesionist, Gjuran Ilnicën. Ai është prej kohësh pjesë e pallatit të kulturës në Peshkopi, por dhe pjesë e aktiviteteve të ndryshme artistike. Ka marrë pjesë në festivalin e Gjirokastrës, kurse shumë shpejt do të jetë në Kosovë në një turne folklorik.

Festa akoma nuk kishte mbaruar. Një surprizë e veçantë i priste të gjithë të ftuarit. Në katin e dytë të shkollës, në sallonin e dekoruar aq bukur, ishin vendosur, ekspozuar dhe servirur për të pranishmit dhjetra lloje gatimesh popullore. Të gjitha ishin kontribut i mësuesve të palodhur të kësaj shkolle, që aq shumë aktivitete e gjëra të bukura na kanë dhuruar në këto vite. Bakllava, sheqerpare, sarma, lloje të ndryshme byreku, jufka, trahana, fli me renda, krepa, zahire dimri, e plot asortimente të tjera, ishin gatuar e servirur për vizitorët e shumtë. Tradicionalja ndërthurej e gërshetohej bukur me të tashmen, duke na dhënë një kolorit vlerash, që nuk harrohen lehtë. Thamë që gjithë stafi ishte tejet i përkushtuar, por Brikena Tonuzi, Lutfie Muça, Brikena Erebara, Fllanxa Muça, Brixhilda Gjoni, mund të quhen heroina me plot kuptimin e fjalës. Jo vetëm ato, por gjithë familjet e tyre u angazhuan në këtë event të bukur dhe jetuan me shqetësimin, nëse do të dilte ashtu siç donin ato.

TE TJERA EVENTE MBRESELENESE

Të shumta janë aktivitetete kësaj shkolle, por dhe trofetë e fituara janë të shumta. Data 5 qershor 2021. Pesë shkollat nëntëvjeçare të zonës së Maqëllarës do të përfshiheshin në një konkurs të titulluar: "Në udhën e më të mirëve". Do të ishin zërat më të bukur të fëmijëve në zhanrin e recitimit. Nga tre çmime të vëna në dispozicion, dy të parat i fiton shkolla e Pocestit. Kejsi Spahiu me poezinë "Zemra e nënës", dhe Kjara Liçaj me "Poemë kosovare", fituan admirimin dhe duartrokitjet e të pranishmëve.

Një vit më vonë, Kejsi Spahiu fiton sërish vendin e parë në një konkurs recitimi të organizuar nga "Ardhmëria". Poezia titullohej "Ndihmo nevojtarët".

Një tjetër konkurs u organizua me pesë shkollat e zonës së Maqëllarës. Këtë radhë bëhej fjalë për gjuhën e huaj, lënda e anglishtes. Pata nderin dhe kënaqësinë, që ta organizoja e drejtoja unë këtë aktivitet. Të gjitha ekipet me nga pesë pjesëmarrës ishin përgatitur më së miri, aq sa rezultati u vendos në dy pyetjet e fundit. Shkolla e Pocestit vinte pas një rezultati jo të duhur të viteve më parë, por të vendosur për të ndryshuar historinë. Mësuesja e palodhur e lëndës, Brikena Erebara kishte punuar fort me klasën e katërt. Fëmijët e përzgjedhur, Arsi Spahiu, Rian Rustani, Klea Rustani dhe Lorena Erebara nuk njihnin pengesë e vështirësi, pasi dinin më së miri të gjithë programin e tekstit. Madje kishin përgatitur dhe një dramë në anglisht, që u kushtohej 12 muajve të vitit. Lorena Erebara kishte përgatitur dhe një poezi, po në anglisht, që i dedikohej stinës së verës, të titulluar "Summer".

Vendin e parë e meritoi shkolla e Pocestit, ndërsa të dytin ajo e Kërçishtit. Tuana Sala e shkollës së Majtarës u dallua më së shumti në aspektin individual. Gjejmë rastin të falenderojmë mikun tonë të nderuar, biznesmenin Musa Riçku, që mbështeti dhe sponsorizoi këtë event të bukur, siç ka bërë dhe shumë herë të tjera.

Trofetë e fituara nga nxënësit e kësaj shkolle shtohen e shtohen vazhdimisht. Vetëm pak muaj më parë ato u shpallën më të mirët e zonës në një konkurs gjuhe të organizuar nga ministria e arsimit. Mësuesja Brikena Tonuzi kishte bërë më të mirën e mundshme me nxënësit e talentuar, Kejsi Spahiu, Briselda Halili, Orsina Rustani, Rosalba Novaku dhe Aleksandra Hoxha.

Nuk mund të linim pa përmendur në këto pak rreshta të këtij shkrimi dhe festën e abetares, në klasën e parë. Dhe pse jo me shumë vite eksperiencë, por me shumë pasion e këmbëngulje, mësuesja Ketjona Rama kishte bërë një përgatitje të shkëlqyer. Dekori dhe interpretimi i fëmijëve ishin në lartësitë maksimale. Englantina Tonuzi, Rea Rama, Imelda dhe Xhejda Liçaj e shumë fëmijë të tjerë lanë mbresa të veçanta.Kishin ardhur prindër nga fshati, mësues nga shkolla të ndryshme dhe përfaqsues nga drejtoria arsimore. Ishte një event i bukur, që do mbetet për gjithë jetën në memorjen e këtyre nxënësve të vegjël.

Jo vetëm aktivitetet kulturore e mësimore, por dhe ato sportive janë pjesë e përditshmërisë së kësaj shkolle. Besmir Xholi, mësuesi i edukimt sportiv, tregon se kanë pasur shumë aktivitete të tilla, ku në një pjesë të tyre janë shpallur fitues, si në volejboll, për djem e vajza.

ME SYTE NGA E ARDHMJA

Drejtoresha Nexhmie Sula është e kënaqur me arritjet e deritanishme, por sërish synon të tjera më të mëdha. Shkolla e tyre ka fituar dy projekte, atë të pikturës dhe tjetrin për mjedisin. Stafi i tyre nuk pret për ditën e fundit, por ndajnë detyrat e përgjegjësitë për të bërë një paraqitje dinjitoze e për të qenë fitues të projektit. Pasi kanë transformuar mjediset e brendshme të shkollës, kërkojnë të bëjnë të njejtën gjë me infrastrukturën e jashtme. U bë krasitja e bredhave, veshja me pllakë të bukur e shkallëve të jashtme dhe është bërë ndarja e një këndi të ideuar bukur. Kontributi i stafit vazhdon të jetë i fuqishëm, por do të duhej të vlerësonim dhe donatorët, që u janë bashkuar plot dëshirë projekteve të këtij stafi të mrekullueshëm. Do të veçoja Seit Fishtën, kampionin e dikurshëm të mundjes shkodrane dhe asaj kombëtare, por dhe kampion i vlerave njerëzore. Nuk është hera e parë, që ai bën bamirësi të tilla në zonën e Maqëllarës, ashtu siç bën dhe në shumë zona e krahina të tjera në Shqipëri.

Emra të tjerë kontribues janë nga Pocesti, si profesori në pension, Gëzim Hoxha, dhe dy miqtë e mi të nderuar, doktor Sefer Liçaj nga Italia dhe Landi Spahiu, djali fisnik i këtij fshati, që punon e jeton në Amerikën e largët. Tek Zoti asgjë nuk humbet, ndaj lutemi, që kjo punë e mirë e tyre, dhe këto kontribute t'u kompensohen në mënyrë të shumëfishtë.

botim i ri

Me historitë që shpërfaqin këngët epike, me emrat e njerëzve pjesëmarrës në bëma të ndryshme, me emërvendet, me tërë ato veprimtari historiko-shoqërore në Dibër, me shpjegimet tekstologjike, me tërë kulturën popullore dibrane të dasmave e të gëzimeve etj., libri është shumë i vyer e shumë i këndshëm për të gjithë.

Një botim i ri folklorik: *Në gjurmë të këngës dibrane*

***Nga* HAJRI SHEHU**

Libri është botuar nga shtëpia e mirënjohur botuese M&B, Tiranë, 2023. E ka përgatitur për botim Mirdash Shehu. Redaktore është Miranda Goleci.

Janë 320 këngë: këngë historike e këngë trimërie, këngë legjendare, këngë kurbeti e elegji, lirika e këngë fejese e dasme. Libri mbyllet me një fjalorth me fjalë nga të folmet krahinore, për t'i ardhur në ndihmë lexuesit.

Libri paraprihet nga një siparathënie, me titullin *Dy fjalë për autorin* nga Mirdash Shehu. Mirdashi është biri i profesor Munirit, muzikantit dhe folkloristit të shquar dibran. Por ai flet e shkruan pa qibër, pa kryelartësi për babanë. Ai spikat thukët jetën e jetëshkrimin e profesorit. Thënia lapidare e profesorit, "Nuk kërkoj vlerësim tjetër nga ju, (dua) të më vlerësoni vetëm shojet e këpucëve që kam grisur duke punuar për mbledhjen e këtij folklori" është një sintezë e karakterit të tij fisnik. Vetëm kaq ka thënë profesori, kur mund të kishte folur me zë të lartë për shumë më shumë se kaq. Pse, a thua ka sot kaq idealistë si profesor Muniri? Ndoshta, jo gjithkush e di sa e lodhshme është të gjurmosh një krijim popullor, të gjesh subjektin e duhur, ta regjistrosh ashtu siç e thotë ai etj. Profesor Muniri e ka bërë këtë punë që në vitin 1930. Ka kërkuar e ka mbledhur folklor, të paktën gjysmë shekulli. Është, vërtet për t'u vlerësuar shumë e shumë.

Brezi im i pedagogjikasve të Peshkopisë e kemi pasur mësues muzike profesor Munirin. Bëhet fjalë për vitet 1956-1960. E kemi vlerësuar shumë atëherë për integritetin e tij dhe seriozitetin, me të cilin na e zhvillonte lëndën e muzikës dhe mësimin e violinës. Dhe kemi mall për kabinetin e muzikës. Nga duart e profesor Munirit dolën violinistë të shquar – Nuredin Mazari (Peshkopi), Shefqet Doda (Burrel) e të tjerë. Dhe shumë të tjerë e mësuan muzikën te profesori për të qenë mësues në këtë a në atë fshat. Muzika ishte lëndë mësimore. Dhe për profesorin vjen mirënjohja e të gjithë nxënësve të shkollës pedagogjike të Peshkopisë. Te profesori vjen kujtimi i pashuar për tingujt e ëmbël të violinës së vetë profesorit, që na kënaqte e na gëzonte në raste të veçanta, edhe në atë kabinetin e vogël të muzikës në shkollë. Profesori, me grupin artistik të shkollës ka kënaqur e ka gëzuar edhe qytetin e Peshkopisë. Janë të paharruara koncertet që janë dhënë në sallën e kinemasë së Peshkopisë, këngët e kompozuara nga profesori – për Nazmi Rushitin, Hibe Palikuqin e dëshmorë të tjerë, vallet popullore të kënduara, të përpunuara nga profesor Muniri. Profesori i solli gjallërinë kulturore dhe artistike qytetit të Peshkopisë.

E kemi dashur dhe vlerësuar mësuesin si muziktar, por nuk e kemi pasë ditur atëherë që ishte shumë më shumë se kaq. Me fjalë shumë vlerësuese, i pari që më ka folur për profesorin si studiues, ka qenë mësues Sami Shehu. Pastaj kam lexuar 7 botimet e profesorit. Një ndër to është "Shteg më shteg e skutë më skutë". Jam habitur me saktësinë e thënieve. Edhe më i habitur jam tani, me librin "Në gjurmë të këngës dibrane", Tiranë, 2023.

E kemi dashur dhe vlerësuar mësuesin si muziktar, por nuk e kemi pasë ditur atëherë që ishte shumë më shumë se kaq. Me fjalë shumë vlerësuese, i pari që më ka folur për profesorin si studiues, ka qenë mësues Sami Shehu. Pastaj kam lexuar 7 botimet e profesorit. Një ndër to është "Shteg më shteg e skutë më skutë". Jam habitur me saktësinë e thënieve. Edhe më i habitur jam tani, me librin "Në gjurmë të këngës dibrane", Tiranë, 2023. Edhe shënime e ditar të rregullt po të mbajë njeriu, vështirë se mund të jetë kaq i saktë. Libri ka 320 këngë. Përveç subjektit nga është marrë kënga, jepen poshtëshënime për kuptimin a përdorimin e fjalëve e të shprehjeve të caktuara popullore. Te këngët historike e të trimërisë ka shpjegime parahyrëse për ngjarjen, ndodhinë, momentin, personin etj., për të cilin këndohet kënga dhe poshtëshënime për emra të tjerë që dalin si pjesëmarrës në ngjarje. Ngjarjet vijnë kronologjikisht, jo thjesht si kohë e si vite, por edhe si pjesë të vitit a të ditës. Personazhet vijnë e parakalojnë si në një revistë para paradës. Dhe kushdo, që do të dijë për ngjarje e personazhe të Dibrës, i ka të skalitura këtu. Kjo pjesë e librit është edhe një enciklopedi e vërtetë vitesh dhe ngjarjesh.

Mjaft shpesh, jepen edhe variantet e këngës sipas krahinave dhe të folmeve. Është një ndezëlli (zell) e skrupulozitet i një mbledhësi dhe studiuesi të afirmuar e të përkushtuar. Kësisoj, vërtetësohet edhe kënga, edhe ngjarja. Shih, p.sh., *Kanga e Mahmut Dacit* (2 variante), *Kanga e Hajredin Pashës* (6 variante) etj.

Një vend mjaft të madh në libër zënë këngët lirike – këngët e dashurisë, këngët e fejesës e të dasmës (138). Ka edhe elegji. Këto – me përmbajtje e fjalë që të murrëtejnë zemrën. Kurse këngët lirike - të dashurisë, të fejesës e të dasmës ta çelin zemrën me cilësime, krahasime poetike, epitete etj. për dy personazhe – për dy dashatarë: nusja e dhëndri. Dhe lexuesi mund të lumturohet me artin poetik popullor. Por jo veç me poetizmat. Edhe me rimën e përkryer. Edhe me bukurinë e melodisë së tyre.

E lamë si për në fund: E veçanta e botimit të profesor Munir Shehut janë notat muzikore për çdo këngë. Kështu kënga bëhet e këndueshme. Pa melodinë kënga lexohet, thjesht si tekst, si poezi. Me melodi bëhet këngë. Me melodi këndohet. Pa notat muzikore, siç thuhet edhe në siparathënie, puna do të ishte e paplotë. Profesor Muniri e ka të plotë punën e tij. Me ndezëlli ka gjurmuar e regjistruar edhe melodinë. Dhe kështu, kënga folklorike dibrane nuk do të bjerret asnjëherë.

Me siguri, folkloristët do ta analizojnë dhe vlerësojnë librin si profesionistë. Unë, si i gjuhës, dua të përveçoj dy vlera të tjera të librit.

Një vlerë e veçantë e librit është se na vë përpara një varg të folmesh të Dibrës. Ato janë pjesë e së tërës. E tëra është gjithë e folmja e Dibrës. Gjuhësisht, këngët na ndihmojnë për të përdalluar veçoritë e aksh të folmeje. Njëherësh, na ndihmojnë për të gjeografizuar vetë këngët. Kësisoj, ato janë një lëndë e vyer për dialektologun dhe folkloristin. Në disa këngë, gjuha na duket edhe si mbidialektore. Kjo ka shpjegimin e vet: Gjuha e këngës popullore rron te bartësit e së folmes. Prandaj çdo krijim gojor folklorik është edhe tekst i së folmes së dhënë. Por, po ta shohim çështjen më tej, na rezulton që gjatë shtegtimit të saj kënga (sidomos e sotmja) del ose mund të dalë tej kufijve të mjeteve gjuhësore të së folmes së truallit ku është krijuar, domethënë, fut në variantin e vet edhe mjete gjuhësore (fjalë, shprehje etj.) nga një burim tjetër. Kjo ndodh edhe për arsye të bashkëndikimit e të bashkëveprimit ndërmjet të folmeve. Edhe për arsye të veprimit të gjuhës standarde. E shpjeguar pak më thjeshtë: Përderisa kënga rron, është përherë në krijim të pandërprerë. Dhe aty ku « rikrijohet », merr elemente të së folmes. Dhe e mira është se kënga bëhet më e këndueshme. «Prishet punë» (sepse humbet autenticiteti (vërtetësia) i krijimit folklorik), nëse mbledhësi fut subjektivisht elemente « të huaja ».

Vlera tjetër e çmuar e librit është se na vë përpara edhe fjalë e shprehje, të ashtuquajtura «të rralla», të panjohura për gjuhën standarde. Mjaft prej tyre janë me vlerë letrare potenciale, domethënë, sjellin vlera pasuruese për standardin (shih, p.,sh., *vetullhalë, vetulldrapën, sygozhdë, sygogël, fytyrërrjepur, kicavec: a t'ka ngucë ai kicavec* / me ngjyrim kuptimor përçmues, *dukakeq* etj.). Nuk mund të ketë fjalor krahinor vetëm me të folmen e gjallë. Nuk mund të ketë fjalor krahinor pa gjuhën e folklorit. Atëherë, vepra e profesor Munirit shërben si burim autentik, shumë i besuar për fjalorin e së folmes së Dibrës. Me historitë që shpërfaqin këngët epike, me emrat e njerëzve pjesëmarrës në bëma të ndryshme, me emërvendet, me tërë ato veprimtari historiko-shoqërore në Dibër (shih, sidomos te këngët epike), me shpjegimet tekstologjike, me tërë kulturën popullore dibrane të dasmave e të gëzimeve etj., libri është shumë i vyer e shumë i këndshëm për të gjithë.

E veçanta e botimit të profesor Munir Shehut janë notat muzikore për çdo këngë. Kështu kënga bëhet e këndueshme. Pa melodinë kënga lexohet, thjesht si tekst, si poezi. Me melodi bëhet këngë. Me melodi këndohet. Pa notat muzikore, siç thuhet edhe në siparathënie, puna do të ishte e paplotë. Profesor Muniri e ka të plotë punën e tij... Dhe kështu, kënga folklorike dibrane nuk do të bjerret asnjëherë.

Rruga e Arbërit nr. 195-196.

vendlindja

Avantazhet e zhvillimit në perspektivë të Peladhisë lidhen me fondin e konsiderueshëm të tokës arë, mundësitë për të shtuar pemëtoret, për të rritur turizmin dhe aktivitetet e biznesit, pasi nëpër fshat kalon rruga e Arbrit, kjo arterie e rëndësishme rrugore që përshkon qarkun e Dibrës.

Peladhia

- fshati magjik rrëzë Temlës, katund i arsimtarëve dhe trashëgimisë historike

Nga **ADRIATIK BALLA**

Sot do t'u njohim me një fshat të veçantë, Peladhinë, që shtrihet në qarkun e Dibrës, në Bashkinë Bulqizë.

Peladhia është pjesë e njësisë administrative të Grykës së Madhe, njohur sot si Zerqani. Është një nga 13 fshatrat e kësaj njësie, pozicionuar në anën VP, në luginën e Zallit të Bulqizës dhe njësinë malore kufizuese në veri të saj.

Peladhia shtrihet nga ura e Qytetit në JP e deri në kufi me fshatin Godvi në lindje. Në jug kufizohet me Zallin e Bulqizës i cili e ndan atë nga fshatrat Valikardhë e Zerqan, kurse në perëndim e veri perëndim kufiri i këtij fshati ndjek kurrizin e malit të Temlës, që e ndan nga fshatrat Fushë-Bulqizë dhe Dushaj. Brenda këtyre kufinjve, Peladhia ka një spërfaqe 9.5 km katrore.

Fshati Peladhi shtrihet nga kuota më e ulët 545 m në zalli i Bulqizës në kufirin me Godvinë në lindje, e deri në 1702 m që është maja e malit të Temlës në perëndim. Territori i fshatit ka shtrirje gjatësore 3 km e gjerësi maksimale 4 km që nis nga zalli në fjalë e deri në qafën e Shesheve në kufirin ndarës (lugu i Peladhisë) mes malit të Temlës e Homeshit (të dy pjesë e njësisë së Arithit).

Administrativisht kufizohet në perëndim me Fushë-Bulqizën, në jugperëndim me Valikardhën, në jug me Zerqanin, në lindje me Godvinë dhe në veriun ekstrem me fshatin Bllacë.

Territori i katundit përfshin një gjeologji të pasur, sidomos sa i takon tektonikës, ndërsa

litologjia përfaqësohet me shkëmbinj granitikë pranë gurrave të Peladhisë, karbonatikët e Triasit të sipërm e Jurës së poshtme që ndërtojnë malin e Temlës, pjesërisht terrigjenë neogjenikë si dhe depozitimeve kuaternare.

Vetë Fshati Peladhi shtrihet në dy lagje, Peladhi e Sipërme dhe Peladhi e Poshtme (regjistrimi austriak i vitit 1916, botuar me 1918, i jep mehalla e eperme dhe mehalla e poshtme, te dyja me 57 shtepi dhe 373 banore). Katundi i sipërm ka tipologjinë e një vendbanimi të grupuar dobët, me shtëpi të shpërndara, kurse Peladhia e Poshtme është një katund linear me shtrirje perëndim-lindje, gati 1.5 km përgjatë rrugës nacionale Bulqizë-Peshkopi e paralel me zallin e Bulqizës në jug të tij. Dy shekuj më parë më e zhvilluar ka qenë Peladhia e Sipërme, por pas vitit 1800 përqendrimi më i madh i popullsisë është në lagjen e poshtme, ku ndodhet edhe fondi kryesor i tokës bujqësore.

Emri i katundit lidhet me një ngjarje që ka rrjedhur ndër shekuj në gojëdhënën popullore. Gjatë epokës së artë skënderbejane, ushtarët skënderbegas hodhën në rrëkenë juglindore të Temlës, poshtë kalasë së Skënderbeut, tek Shkëmbi i Kullës, një pelë të dendur me grurë. Turqit që u afruan



pranë vendit të ngjarjes panë një kafshë të plasur nga ushqimi i tepërt dhe pyetën "pelë apo dhi". Truku skënderbegas ishte i tillë që krijonte tek armiqtë bindjen se kalaja edhe po të rrethohet nuk merret sepse ka ushqim të mjaftueshëm, aq sa plasin nga tepria edhe kafshët. Prej mesit të shekullit XV e deri më sot, gati 560 vjet, ky fshat ka të njëjtin emër.

Në lindje të fshatit ndodhen rrënojat e një vendbanimi, gjë që e jep edhe harta topografike, por ende nuk kemi të dhëna mbi moshën, përmasat dhe stadin e zhvillimit të tij.

Peladhia është fshat ku vetëm 1/3 e sipërfaqes është luginore, pjesa tjetër është malore e shprehur. Sektori luginor ku ndodhet Peladhia përbën zgjerimin e parë të madh në pjesën lindore të luginës së Bulqizës. E veçanta e luginës në Peladhi është asimetria strukturore e saj. Ku krahu verior në të majtë të zallit është disi i sheshtë dhe i kultivuar, por skaji tjetër i luginës ku kalon zalli lartësohet përnjëherë me shkallën strukturore Zerqan-Valikardhë, me diferencë 200-250 m më në lartësi. Pozita e Peladhisë është mjaft e favorshme, qoftë si vendbanim, por edhe për kushtet bujqësore që ofrohen. Bimësia natyrore është relativisht e pasur, ku vërehet një katëzim perfekt i saj. Rrjeti hidrografik përfaqësohet nga Zalli i Bulqizës që në këtë sektor ka meandrime të shumta, si dhe burimet karstike ku shquhen gurrat e Peladhisë në perëndim të katundit.

Tokat janë kryesisht të kafenjta te tipit te kuqerremte, e pjesërisht aluvionale pranë zallit të Bulqizës.

Peladhia është një fshat mesatar në kuadër të njësisë administrative Zerqan. Për nga numri i popullsisë renditet pas Sopotit, Valikardhës, Strikçanit e Zerqanit. Numri i popullsisë së Peladhisë ka pësuar rënie të ndjeshme gjatë viteve të fundit, si pasojë e emigrimit masiv të rinisë. Në vitin 1997 ky fshat kishte 509 banorë. Në vitin 2001 ra në 446 banorë, në vitin 2007 ra në 388 banorë. U stabilizua në vitin 2011 me 426 banorë, por pas këtij viti ka rënë në më pak se 350 banorë.

Peladhia është fshat historik, me emër të madh në Dibër e më gjerë për ngjarjet që kanë ndodhur gjatë epokës skënderbejane. Ky katund, u vu në ndihmë dhe dha kontribut të rëndësishëm krah Sheh Zerqanit në luftën e Drinit kundër Hajredin Pashës në vitin 1844. Peladhia do të goditej ashpër nga agresioni serb i vitit 1913 dhe shumë shtëpi të këtij fshati u dogjën. Masakra të rënda përjetoi ky katund gjatë viteve 1913-1921, por që i përballoi me shumë sakrificë. Kontribut të rëndësishëm Peladhia dha gjatë LANC-it, e radhitur me dinjitet në ▯etën Partizane të Grykës së Madhe. Të shumtë janë dëshmorët nga ky fshat që kanë dhënë jetën në luftëra të ndryshme për liri, pavarësi e dinjitet kombëtar.

Fiset kryesore që përbëjnë këtë katund janë Hysa, Kamberi, Plaku, Pata, Kala, Gjura, Rama, Alla, Deda, Dufi, Gjoka, Meta etj.

Peladhia ka një popullsi aktive me punëtorë të zellshëm por edhe një popullsi të arsimuar, e shquar në të gjithë Dibrën.

Personalitetet e dala nga ky katund janë të shumtë, por këtu po përmendim disa prej tyre, si Ahmet Kamberin, ministër i shëndetësisë në vitet e fundit të diktaturës, gjuhëtarin e madh, profesorin Enver Hysa, si dhe i ndjeri Bujar Pata, ish-drejtues i minierës së Bulqizës.

Peladhia është fshat i arsimtarëve të shumtë, me kontribut të rëndësishëm në të gjithë Dibrën për përcjelljen e dijeve, përfshi këtu mësuesin tim të gjeografisë Hasan Gjura.

Ekonomia e katundit është e orientuar nga bujqësia e më pak blegtoria, e shumë më pak nga artizanati. Edhe pse në një luginë të ngushtë, Peladhia ka një fond të konsiderueshëm toke bujqësore që shkon mbi 100 hektarë, nga të cilat 70 hektarë mjaft prodhuese. Mes për mes fshatit kalon një kanal ujitës i ndërtuar mbi gjysmëshekulli më parë, e që vë në ujë mbi 200 hektarë tokë, gjë që ka sjellë një rritje të ndjeshme të prodhimeve të misrit, foragjereve dhe perimeve në këtë pjesë të luginës së zallit të Bulqizës. Nje pjese e rendesishme e krahut te punes ka punuar e punon ne minieren e kromit Bulqize.

Peladhia ka disa monumente natyrore e kulturore, shumicën e të cilëve i ndan me fshatrat e tjerë. Një i tillë është Shkëmbi i

Kullës, pranë Urës së Qytetit, shpella pranë urës, shpella e zezë, kalaja e Skënderbeut në Shkëmbi i Qytetit, qarri i Peladhisë (në këtë foto të bërë nga unë më 31 maj 2005 me porosi të profesor Qiriazit), ura e vjetër e qytetit etj. Më herët ky fshat ka pasur një mulli uji. Ka një shkollë fillore dhe një rrjet rrugor relativisht të mirë.

Avantazhet e zhvillimit në perspektivë të Peladhisë lidhen me fondin e konsiderueshëm të tokës arë, mundësitë për të shtuar pemëtoret, për të rritur turizmin dhe aktivitetet e biznesit, pasi nëpër fshat kalon rruga e Arbrit, kjo arterie e rëndësishme rrugore që përshkon qarkun e Dibrës.

Nisur nga pozita gjeografike, e ardhmja e Peladhisë duket e begatë dhe e sigurt, madje shumë më e mirë sesa e Zerqanit që është qendër administrative.

cyan magenta yelloë black

turizëm

Ngjitje në Korab, emocione që nuk duhen humbur

Mali i Korabit është një nga malet më të larta të Evropës Juglindore, i cili shtrihet përgjatë kufirit shtetëror të Shqipërisë me Republikën e Maqedonisë së Veriut. Majat e maleve të Korabit janë jashtëzakonisht të pjerrëta, mjaft të aksidentuara dhe të latuara nga shumë dukuri erozionalo-tektonike ku, në disa vende, vihen re shtresa masive kryesisht gëlqerore që krijojnë një morfologji me rrëpira gati vertikale, të cilat arrijnë deri në 100 metra thellësi.

Një e treta e malit është e pasur me pyje gjetherënëse dhe gjysmën e rripit alpin e përbëjnë kullotat. Është i pasur me përrenj dhe përroska, të cilat kanë rrjedhë të shpejtë mbi kanione dhe lugina. Bukuri plotësuese i japin liqenet akullnajore.

Vend i pasur me bukuri të rralla natyrore, me blloqe shkëmbore e shkëmbinj, me kullota, i cili vizitohet nga shoqata të shumta alpinistësh të cilët arrijnë të ngjiten edhe deri në majën e saj më të lartë me lartësi 2764 m (2754 m). Nga ana e Maqedonisë së Veriut mund të udhëtohet deri në fshatrat e Rekës duke udhëtuar nga Dibra e Madhe e në disa prej këtyre fshatrave siç janë: Nistrovë, Bibaj, Zhuzhnjë, Rimnicë, Grekaj, Tanushaj, Nivisht si dhe në pjesën tjetër të Strazimirit nga organizohen ngjitjet alpinistike çdo vit.

Në Shqipëri ngjitjet drejt Korabit zakonisht nisin nga fshati Tejs, ish lagje e Radomirës, një fshat i vogël rrëzë këmbëve të malit Korabit dhe Rrafshit me të njëjtin emër. Pas tij përshkohen shtigje e lugina që disa herë lagen nga ujërat e Drinit të Zi. Rruga është e gjatë, duhen disa orë ndaj merrni me vete pajimet dhe ushqimet e nevojshme. Vishuni lehtë me teshat që përballojnë udhëtime të tilla dhe me këpucë alpine që nuk rrëshqasin mbi shkëmbinj.

Nga Tirana drejt fshatit Tejs dikur ish lagje e Radomirës, duhen rreth 2 orë e gjysmë me makinë sepse distanca për t'u përshkuar është rreth 130 km. Një tjetër rrugë kryesore që përdoret më shpesh është nga Tirana drejt Kalasë së Dodës dhe më pas grupet ndahen sipas shkallëve të vështirësive që mund të përballojnë. Zagradi është gjithashtu një fshat i vogël që zakonisht përdoret si vend fushimi apo çlodhjeje për të marrë forcat drejt ngjitjes apo në të kundërt.

Majat e maleve të Korabit janë jashtëzakonisht të pjerrëta, mjaft të aksidentuara dhe të latuara nga shumë dukuri erozionalo-tektonike ku, në disa vende, vihen re shtresa masive kryesisht gëlqerore që krijojnë një morfologji me rrëpira gati vertikale, të cilat arrijnë deri në 100 metra thellësi.

Mali i Korabit është i vendosur në jugperëndim të maleve të Sharit dhe nuk ka lidhje me kufirin e Republikës së Kosovës. Korabi është një masiv malor vende vende shumë i thyer i përbërë kryesisht nga rreshpe dhe gëlqerorë të Paleozoikut, mesosoikut, jurasikut etj. si dhe takohen edhe shkëmbinj magmatik si granite, serpentinite etj. Formacionet shkëmbore paraqiten me struktura të rrudhosura, me zhvillim të tektonikës, si dhe në afërsi të tij në pjesën lindore ka shfaqje të mëdha të masivëve evaporitikë, kryesisht të gjipseve, anhidriteve, seleniteve, dolomiteve etj. të moshës së Permian – Triasikut, shkëmbinj të prekur shumë nga erozioni duke na dhënë pamje të mahnitshme të dukurive të tilla, ku ndër to është Gryka e Përroit të Gramës etj.

Në anën perëndimore në në disa vende shkëmbinjtë gëlqerorë bien thikë si rasti mbi Gurët e Pëllumbave që duket që nga maja e Thekanushit në Arras. Ana veriore e lindore përbëhet po ashtu nga shkëmbinj të thepisur kryesisht gëlqerorë sidomos në zonën e Përroit të Thellë pas Portave të Korabit

Korabi ndodhet në Parkun Natyror Korab-Koritnik dhe njihet për bimësi e faunë fantastike që nuk është dëmtuar nga fenomenet e zhvillimit urban. Në këtë park takohen liqene alpine, hone mbresëlënëse të cilat mbështeten mbi vargmale që fshihen pas pemëve të harlisura. Pranë tyre frymojnë fshatra të vegjël me pak banorë.

Parku dhe mali vizitohen çdo vit nga mijëra vendas dhe të huaj. Dikush pëlqen të eksplorojë natyrën dhe përrenjtë e fshehur mes luginave, dikush është bërë gati për shëtitje (hiking), dikush tjetër vështrimin e ka ngulur në kreshtat e Korabit dhe është gati për sfidën e radhës në alpinizëm. Nuk mungojnë edhe ata qe thjesht shkëputen nga qytetet e mëdha me të vetmin qëllim, të takojnë natyrën dhe t'i dorëzohen asaj pa kushte. Parku është fillesa e turizmit malor dhe natyror. Zona e malësive të Dibrës njihet për më shumë se 60 monumente natyre (shumica e të cilave janë gjeomonumente) të cilat ruhen me fanatizëm nga banorët.

Zona ka infrastrukturë të përzier disa herë modeste, disa herë të mirë por ende banorët lokalë janë në sfidë për turizëm masiv. Grupet e alpinistëve sfidojnë lartësitë që arrijnë retë dhe prezenca e tyre është e zakonshme tanimë për fshatarët e zonës afër këmbëve të Malit të Korabit. Guidat lokale janë të përgatitura për të udhëhequr një udhëtim fantastik, rrethuar nga natyra e virgjër e paprekur nga dora e njeriut.

Përgatiti: Grehans Uka
Fotot ilustruese: Artur Xhediku

BUJTINAT MIKPRITËSE

BUJTINA KONAKU I DIBRËS
Vendndodhja: **Tomin** Tel: **0692053492**
E-mail: **aminasalkurti@gmail.com**

NËNA DASHURI AGROTURIZËM
Vendndodhja: **Peshkopi** Tel: **069 937 7337**
E-mail: **nenadashuri@gmail.com**

GUEST HOUSE SABRIU
Vendndodhja: **Rabdisht** Tel: **069 511 4003**
E-mail: **guesthousesabriu@gmail.com**

KULLA HUPI
Vendndodhja: **Dushaj, Bulqize**
Tel: **068 837 3793**
E-mail: **kullahupi5@gmail.com**

BUJTINA ARBRI
Vendndodhja: **Arras, Fushë-Çidhën**
Tel: **068 650 6061**
E-mail: **markuvladimir@yahoo.com**

GUESTHOUSE TERSHANA
Vendndodhja: **Peshkopi** Tel: **0218 20306**
E-mail: **bujtina.tershana@outlook.com**

BUJTINA GOLECI
Vendndodhja: **Rabdisht** Tel: **069 642 9888**
E-mail: **fitimgoleci1@gmail.com**

cyan magenta yelloë black

Rruga e Arbërit nr. 195-196.
botime

Vlerat e Ujemujës së Dibrës në librin e Hidajet Lahit

Nga dr. **HAJRI MANDRI**

Pas librit "Atdheu është i bukur në çdo cep të tij", Hidajet Lahi del me librin e dytë kushtuar vendlindjes së tij: UJEMUJA PËRBALLË LUFTRAVE DHE ZHVILLIMIT. (Ndikimi i familjeve, intelektualëve, personazheve me kontribute, për rritjen e vlerave kombëtare)".

Autori fokusohet në rolin e familjeve me ndikim në zonë, apo " familjeve të mëdha" siç u thoshin ndërkohë. Ai ndalet në persona të veçuar klerikë, mësues të kohës së tyre, intelektualë dhe njerëz të tjerë të mëparshëm e të sotëm që me aftësitë e tyre kanë qenë kontribues në zhvillimin ndaj luftërave, në udhëheqjen e proceseve zhvilluese në komunitetit e Uj'e Mujës. Këto kanë vepruar sipas kohërave e situatave të ndryshme. Ndërsa zhvillimi i tyre praktik është kryer sipas përvetësimit të lartësisë të vlerave kombëtare të njerëzve (individëve) të jetuar në këtë territor.

Autori i librit ka një histori pune të ngjeshur dhe detyra përfaqësuese, e cila i ka dhënë shansin të njohë dhe të kundrojë nga afër historinë transformuese të zonës.

Në vitet 1978 – 1986 ai pati mundësi të përfaqësonte zonën në organin më të lartë të shtetit, si deputet i Kuvendit Populllor të Shqipërisë.

"Ka patur luftëra fetare që para kohëve të hershme të antikitetit, ka patur luftëra kundra pushtuesve të huaj, që në periudhën e Rilindasve, gjatë luftës së Parë e së Dytë Botërore, si dhe zhvillimet e Luftës Nacionalçlirimtare e në të gjitha për Ujemujen. Luftërat e drejtuara nga Elez Isufi, Isuf Xhelili etj., kanë qenë heroike të etiketuara nga njerëz të ditur, diplomatë të huaj, kanë qenë gjithpërfshirëse dhe Ujemuja në këtë drejtim është quajtur kryeqendra e Dibrës. Këto luftra janë zhvilluar në mbrojtje të krahinës se Ujemujës e përkufizuar nga përroi i Veleshicës, përroi i Gramës, Drini i Zi, e në situata që nuk kishte shtet apo shteti i cilësuar pushtues.

Si mund të lihen në harresë roli i intelektualëve klerikë siç ishte Hoxhë Kalla, Sheh Zumani, Hoxhë Puci e Hoxhë Çenjeva.

Apo lufta kundër pushtuesve të huaj nga Elez Isufi, fisit Ndreu, fisit Daci, nën komandën e legjendarit Mahmut Daci e Cen Daci dhe i gjithë krahinës të familjeve intelektuale e të personazheve të rëndësishëm me kontribute të Ujemujës.

Ndikimi i klerikëve, si Hoxhë Kallës, i cili ishte ndihmës, ndërmjetës në takimin e Elez Isufit me Turgut Pashën në Kaush në vitin 1907. Ishte një takim delikat dhe përfundoi shumë i suksesshëm, pasi Ujemuja fitoi autonominë edhe përse ishte i pjesshëm. Nga klerikët, Hoxhë Kalla e fisi Ndreu u ndërtuan dy shkolla në Sllovë, një shkollë në Trojak, mejtepe sipas kërkesave të komunitetit, duke e kthyer Ujemujën nga krahinat më të zhvilluara të asaj kohe në Dibër.

Si mund të mohohet lufta gjithpërfshirëse e Elez Isufit, Isuf Xhelilit dhe i gjithë fisit Ndreu? Ato kanë qenë heroike dhe në Ujemujë, ku u zhvilluan 8 luftra të tilla, të cilat janë fituar, apo vazhdimësia e tyre në krahinat e tjera të Dibrës, Arras, Llasen, Lurë, Dibra e Madhe, Gostivar Kosovë edhe këta ishin gjithpërfshirëse e heroike.Apo marrëveshja në Shkodër për themelimin, mbrojtjen kombëtare të Shqipërisë e Kosovës me pjesëmarrës Elez Isufin, Bedri Pejani, Sotir Peci etj. Elez Isufi ishte një kundërshtar i ashpër i aneksimit të tokave shqiptare sipas vijës strategjike të projektuar nga gjenerali francez Franchet Esperui për mos ndarjen e tokave shqiptare.

Libëri përshkohet nga stili optimist duke rrezatuar shpresë dhe ardhmëri. E ardhmja do të jetë më e mirë, për të jetuar në ekosistemin, biodiversitetin i cili është i vlerësuar nga më të lartët e krahasuar me krahinat e tjera me një bazë më të qëndrueshme për ndërtimin e strategjive të reja me performancë turistike në zhvillimin e turizmit e të gjithë llojeve.

Vendosja e terrenit kodrinor-malor dhe alpin, me kullota, bjeshkë të lartësuara, por me terren edhe fushor, i përbërë me 7500 ngastra e në stadet kohore më të hershme mbi 100 mijë ngastra me 350 deri 2752 metra mbi nivelin e detit, përbën një territor mjaft interesant të leverdisshem, që është i dukshëm në zhvillimin e produkteve me origjinë organike me tokën e trajtuar si një organizëm i gjallë. Dikur herët, njerëzit për të jetuar shfrytëzonin produke të prodhuara nga toka, kollotat, bjeshkët, pyjet, që bimësia e re zhvillohej mbi bimësinë e vjetër, apo drunjtë e rinj të rriteshin e të zhvilloheshin në shtresat e drunjve të vjetër. Kerkesa ishte, e thuhej, se bimësia e re të mund, ta zaptojë të vjetren, duke krijuar shtresa organike të përvitshme e të vazhdueshme për prodhimin organik, që konsumohej nga njerëzit. Kjo shprehte zhvillimin me të lartë të vlerësuar mbi biodiversitetin.

Në mënyrë të detajuar dhe profesionale përshkruhet histori-gjeneza e vreshtarisë së krahinës, që në kohët para-historike, antikitetit, sidomos të besimi fetar i krishterë për fshatrat që përbëjnë Ujemujën.

Autori e hedh vështrimin historik deri te zbatimi i politikës ekonomike të Perandorisë Turke në marrjen e taksave e cila për mushtin (prodhim nga rrushi), apo taksën e marrë nga prodhimi i linit, kërpit, mellit, etj. që sipas emërtimit të tokave të mbjella si linishte etj.

Përshkruhet në libër se lufta në Uj'e Mujë ndryshon. Qëndron e veçanta në zhvillimin e luftërave. Ata janë zhvilluar ndryshe nga krahinat e tjera, të cilat luftuan edhe në bashkëpunim me qeveritë e krijuara kukulla që ishin në vartësi të tyre.

Në një periudhë shumë të shkurtër nën shembullin e fisit Ndreu, bashkërisht me familjet vendase në të gjithë fshatrat, Sllovë, Trojak, Shumbat, Vleshë, Kallë, Lugjej, Palaman, Venisht, Sllatinë, banorët e vendit u krijuan shtëpi të tjera me kontribute në Ujemujë. U kthyen në një krahinë me lëvizje të mëdha të fuqishme patriotike, u lidhën fort me njëri-tjetrin duke ruajtur familjet e tyre, duke ruajtur një unitet që ishte një fuqi e madhe për çështjen kombëtare, mbrojtjen e krahinës nga pushtuesit, konfliktet e hasmëritë.

Uniteti i fortë i krijuar u kthye në një traditë të vyer në të gjithë krahinën. Ky unitet ishte i dukshëm sidomos në periudhën e lëvizjeve të mëdha, kundërshtitë me anë të luftrave të drejta, të Luftës së Parë e të Dytë Botërore dhe gjatë Luftës Nacionalçlirimtare. Në këtë periudhë dolën individë, familje, fise, personazhe me shumë kontribute si edhe heronj të përmasave kombëtare si Elez Isufi e Isuf Xhelili. U afirmuan fise, familje me ndjenja të larta patriotike e kombëtare.

Elez Isufi, Isuf Xhelili, fisi Ndreu si dhe fise e familje të tjera qe janë përmendur në libër krijuan një fuqi të madhe të mbinatyrshme si prijësa populllorë me ndikim të theksuar publik.

Gjatë historisë së Ujemujës, janë vlerësuar dy figura "Nder i Kombit" Elez Isufi, organizator i shquar në luftën kundra Serbisë dhe tjetri, Dali Isuf Ndreu, organizator i Luftës Nacionalçlirimtare. Rasti i rrallë që nga një familje në dy gjenerata të këtë vlerësim kaq të lartë kombëtarë.

Për intelektualët e sotëm, Ujemuja radhitet në krahinat më të zhvilluara të Dibrës, me një pasuri intelektuale e cilësi të lartë.

Disponohen intelektualë të shquar, të cilët kanë punuar e punojnë në institucione të ndryshme shtetërore e private me detyra të larta e profesione si; ekonomistë, pedagogë, mjekë, inxhinierë të profileve të ndryshme, agronomë, juristë, zooteknikë e veterinerë, biznesmenë si dhe në institucionet shkencore-akademike jo vetëm në shkallë vendi, në rang kombëtar por edhe ndërkombëtar.

Disa prej tyre kanë punuar dhe kanë lidhje me univeristetet prestigjioze të vendit, Europës por edhe me gjerë, siç janë, prof. dr. Hajri Shehu, prof.dr.Selami Xhepa si dhe prof.dr.Sherefedin Shehu.

Tashmë mbi 100 intelektualë të shquar kontribuojnë në kryeqytet dhe janë pjesë integrale e inteligjencës sonë kombëtare. Janë me kualifikim të lartë akademik, edhe disa intelektualë të tjerë si: Nehat Çollaku, Neshat Fana, Uran Abazi, Jordan Daci e mjaft intelektualë të tjerë që spikasin në fusha të caktuara.

Në Ujemujë janë edhe dy gjeneralë, Dali Ndreu Gjeneral-Major i cili në mënyrë subjektive dhe opurtuniste, siç shkruan autori, u dënua me pushkatim.

Ndërsa Gjeneral Major i Dytë Zyber Dushku i vlerësuar nga ushtarakët e artë, shërbyer Shef Shtabi i Përgjithshëm i Forcave tona të Armatosura, sot në pension, punon në sektorin studimor e shkencor në ushtri.

Intelektualët e Ujemujës kanë dhënë e po japin kontribute në zhvillimin e Ujemujes, të Dibrës, Shqipërisë, si dhe jashtë saj. Për këtë, komuniteti i Ujemujes është krenar për elitën e saj. Ujemuja është vendi ku jetuan shkrimtarët e njohur Xhelal Ndreu, Naim Plaku, Sami Shehu, Hajri Shehu etj.

Urime Hidajet Lahi në pasqyrimin e vlerave të Ujemujës së Dibrës!

profil

"Jehona e Shqipes", një zë i fuqishëm për shqiptarët në Bruksel dhe mbarë Belgjikën!

"Jehona e Shqipes" dhe Sakip Skepi si histori suksesi!

Nga **MINA HYSA**

Dibranët kanë ditur të spikasin me profesionalizimin e tyre, fal dhe guximit në sipërmarrjet në fusha të ndryshme kudo ku kanë shkuar në metropolet e Europës, Amerikës e më gjerë. Sipërmarrja e tyre ka qenë e ndryshme, por më të guximshmit dhe me një mision human dhe patriotik kanë qenë ata që kanë guxuar të ngrenë një media në gjuhën shqipe. Në profilin e sotëm e kemi fjalën për një dibran të suksesshëm, i cili veç të qenit fisnik si njeri, me atë çfarë mundësoi në vitin 1986 në Bruksel, kreu dhe një akt patriotik, atë të zëdhënies së gjuhës shqipe tek bashkatdhetarët tanë në Belgjikë e më gjerë, përmes një radioje e cila,ndonëse fillimisht u mendua si jetëshkurtër, tashmë po i ofrohet katër dekadave!

Më 21 shkurt 2023, në sheshin karakteristik 500 vjeçar "Grand Place" në Bruksel përfaqësues të elitës së komunitetit shqiptaro-belg u mblodhën në mjediset e qendrës kulturore "Shqipville" duke uruar: "Gëzuar Ditëlindjen! Ky urim i shoqëruar me mbresa dhe kujtime ishte për 37-vjetorin e Radios "Jehona e Shqipes". Themeluesi dhe arkitekti i kësaj medie është një emër që për atë çfarë ka dhënë meriton vlerësimin, jo vetëm të shqiptarëve që jetojnë dhe punojnë në Belgjikë, për faktin se për ta ai nuk ka qenë dhe është thjesht pronari i një radioje, por njëderë e hapur për çdo shqiptar, e radio mbetet një vikamë e madhe që dëgjohet në veshët e çdo bashkëpatrioti tonë,tek e cila marrin informacionet e nevojshme në gjuhën amtare.

Quhet Sakip Skepi, me origjinë nga Blliçja e Dibrës! E kujt më mirë se një dibrani do t'i shkonte për shtat akti atdhetar i hapjes së një

mediumi në gjuhën shqipe,i cili përveç ruajtjes së gjuhës shqipe do të përçonte më tej kulturën dhe ruajtjen e identitetit shqiptar në kryeqendrën e Europës, Bruksel! E sigurisht i frymëzuar nga familja, i brumosur me dashurinë për atdheun në shtëpi, mbajtur mbi shpatulla peshën e historisë së zonës nga vinte si Dibra dhe mbiemrit të një familje patriotike, Sakip Skepi do ia dilte të ishte dhe mbetet një histori suksesi dhe referencë për shqiptarët në Belgjikë! Ai për çfarë ka arritur dhe ka dhënëe ka skalitur emrin e tij për mirë,ndaj meriton falenderime dhe përgëzime. Institucionet e Shqipërisë zyrtare dhe jo vetëm, por dhe të shtetit të Kosovës dhe të qeverisë së Maqedonisë për pjesën shqiptare, duhet ta konsiderojnë Sakip Skepin dhe veprën e tij si pjesë së historisë së rrugëtimit shqiptar ndër vite dhe sigurisht vlerësuar të paktën moralisht me medalje,sepse Sakipi materialen as e njeh, sepse është mësuar vetëm të japë!Të shkruaj një profil për këtë personalitet është sa kënaqësi aq edhe përgjegjësi për të mundur të konstatosh dhe pohosh kontributin e dhënë nga ai prej gati 4 dekadash!

"JEHONA E SHQIPES", ZËDHËNIA SHQIPTARE NË KRYEQENDRËN E BE!

20 Shkurti 1986 do të ishte një gur i rëndësishëm për "murin" e madh shqiptar mediatik në kryeqendrën e Bashkimit Europian, Bruksel. Atë ditë mori udhë një projekt shumë i rëndësishëm i arkitektit Sakip Skepi. Radio "Jehona e Shqipes" do të niste transmetimin në gjuhën shqipe, me miratimin e Ministrisë së Kulturës së

Rajonit të Brukselit. Që nga ajo ditë Radio "Jehona Shqipes" u kthye në zërin e shqiptarëve. Dëgjohej kudo. E diela në 105.4 FM lëshonte nga Belgjika valë që më në fund bashkonin!. "Kur mbusha 27 vjeç, mua më dhimbte shpirti tek shihja që komuniteti shqiptar këtu në Belgjkë ishte aq i përçarë, po aq sa më vinte inat që të tjerë komunitete si; ai italian, grek, arab, ishin aq të unifikuar, e mbanin fort kulturën e tyre" – thotë Sakipi. Prandaj ai trokiti në Ministrinë e Kulturës në Bruksel dhe kërkoi hapësirë radiofonike. Mundi ta marr këtë mbështetje fal këmbënguljes shumë të madhe dhe argumentuese ku Sakipin e këshilluan që të drejtohej tek Radio Panik, ku nga Brukseli u fol për herë të parë shqip. Emocionet ishin të pafundme, por garanci për vazhdimësinë e projektit nuk kishte. Grupi nismëtar i hapjes së Radios, ishin; Sakip Skepi i cili mund të konsiderohet si pionieri i kësaj nisme së bashku me të ndjerin Idriz Basha si dhe Gani Sheta, Ali Islamaj, Durak Duraku, Avni Islamaj, Naim Likaj. Projektit iu bashkua dhe bashkëshortja e Idriz Bashës, Kimete Basha –Mitrovica.

Ky grup idealistësh dhe patriotësh nisi të reduktohej pasi secili kishte nevojat për të përballuar jetesën, ndërsa Sakipi nuk do të dorëzohej. Pjesë e rrugëtimit të historisë së radios që ka punuar më shumësi periudhë kohe në radio veç themeluesit Skepi janë politologu Kolë Gjeloshaj, i cili iu bashkua radios në shtator të vitit 2000, ndërsa më e reja është gazetarja Ledja Canaj. Kur në Shqipëri u hapën kompanitë e para celulare "Jehona e Shqipes" pati angazhuar një gazetare nga Tirana dhe po ashtu edhe një gazetar nga Prishtina. Vështirësitë në këto 4 dekada ishin të mëdha dhe të ndryshme! Radio si projekt dhe urë komunikimi mes shqiptarësh në emigracion u duk se do ishte jetëshkurtër, punë muajsh,por "Jehona e Shqipes" sapo festoi 37 vite transmetim.

"Duke mos patur asnjë kontakt me shtetin amë, detyrimisht na lindi ideja e ngritjes së një ure komunikimi e ku më mirë se me radio do ta mundësonim një gjë të tillë. Për ne ishte një kohë e vështirë. Kishim nevojë që të shpreheshim dhe radio ishte mënyra më e mirë dhe me u interesu nga afër për vendin tonë, dhe mbi të gjitha, për ruajtjen dhe përçimin e kulturës

sonë. Ishte fat për ne që autoritetet belge, na përkrahën"- thotë pionieri, themeluesi i kësaj radioje, dibrani fisnik Sakip Skepi.

Në kuadër të vështirësive me të cilat është përballur, Sakip Skepi kujton një episod kur Sigurimi i Shtetit në Bruksel ka tentuar në vitin 1987 të prishte radion me antenat e tyre që i kishin vendosur atje!Transmetimi i radios kishte trazuar regjimin në Tiranë sepse iu shkoi zëri deri në Shqipërinë komuniste. Në vitin 1988 kishin mbërritur në Bruksel nga Ministria e Jashtme e Shqipërisë për t'i vënë kyçin asaj radioje që po u prishte punë. Sigurisht nuk ia arritën as me kërcënimet, as letrat anonime, as telefonatat e as ofertat e nëndheshme politike. Sakip Skepi i ka refuzuar të gjitha. "Jehona Shqipes" ishte radio e fuqishme, dëgjohej e komentohej gjithandej duke qenë e pavarur.

Sakipi është një qytetar model, një intelektual i mirëfilltë, një administrator dhe profesionist i zoti.Duke qenë një njeri me zemër të madhe dhe mendjehapur, radion "Jehona e Shqipes" e ka kthyer në një markë të spikatur shqiptare në mes të kryeqytetit europian. Radio ka shërbyer për shqiptarët edhe për të shijuar muzikën, si dhe tema në emisione të ndryshme për artin, kulturën dhe letërsinë shqipe. Sakip Skepi është i vendosur që të mos heqë dorë nga radioja!"Le të fryjnë sa të duan erëra moderne, le të vijë interneti e kush të dojë tjetër. Unë jam i bindur se "Jehona Shqiptare" do vazhdojë të ketë jetë e frymë dhe mbetet besnike e dëgjuesve të saj dhe udhërrëfyese e tyre" thotë ai.

Në këtë përvjetor të 37-të u nderua dhe kontributi i bashkëpunëtorëve të parë dhe aktivë të "Jehona e Shqipes" disa prej të cilëve janë bërë personalitete të nderuar të diasporës në Belgjikë – i ndjeri Idriz Basha, ish ambasadori ynë në Belgjikë me bashkëshorten Kimete Basha – Mitrovica, Durak Duraku, ish zyrtar në Ministrinë e Brendshme Federale, Ali Islamaj, deri më 2018 për dy dekada drejtor i Shkollës së Mesme Profesionale të Turizmit dhe Hotelerisë, Gani Sheta, Avni Islamaj dhe Naim Likaj. Radio ka qenë dhe do të jetë radio jo politike, por Kombëtare. "Jehona e Shqipes" është në rrjetet sociale Facebook, Instagram si dhe kanalin në You tube si dhe ka bashkëpunim me disa radio në Shqipëri.

KUSH ËSHTË SAKIP SKEPI?

Sakip Skepi ka 56 vite që jeton dhe banon në Belgjikë. Ishte i vogël kur prindërit e tij u arratisën nga Shqipëria komuniste si shenjë proteste ndaj një regjimi vrastar, i cili kishte izoluar Shqipërinë. Ishin 7 familje ku përbënin 26 veta qëmë11 maj 1958 organizuan superarratisjen më të madhe ndodhur ndonjëherë në veri të Shqipërisë. Shqipërinë e la 5 vjeç, Arratisja u bë nga bjeshkët e Dibrës e përfundoi në ish-Jugosllavi. U nisën më 11 maj, kur kishte ende borë e ushtarët nuk ngjiteshin deri lart. Babai i tij e njihte mirë terrenin sepse ishin bjeshkët e tyre. "Rojet e kufirit na pikasën. Filloi breshëria e mitralozëve. Plumbat ranë mbi borë e fatmirësisht nuk kapën asnjë. Ishte shumë ftohtë. Humbëm rrugën dhe u ndalëm.

Nga frika se mos hynim sërish në kufirin shqiptar nëpër errësirë, pritëm derisa u zbardh e u dorëzuam pastaj tek autoritetet jugosllave, që pasi na mbajtën 8 javë nënjë kamp, na njohën statusin e refugjatit dhe ne kemi jetuar afër 10 vite në ish-Jugosllavi e më pas erdhëm në Belgjikë" – thotë Sakip Skepi. Pas qëndrimit gati 10 vite në rrethinat e Shkupit familja e Sakip Skepit do të zhvendosej në Bruksel nga muaji nëntor i vitit 1967."Në Belgjikë, rinia ishte, si e gjithë të tjerëve. Në shkollë, në sport dhe me shokë. Në shtëpi flisnim vetëm shqip, me prindërit. Bisedat e shumta i bënim për vendlindjen. Në fakt, kur u arratisëm lamë dy motrat e mia atje, se ishin të martuara dhe nuk i merrnim dot. Nuk dinim çfarë bëhej me to. Nga Shqipëria mund të vinte një letër në 4-5 vjet, për raste shumë të rralla. Prindërit e kanë vuajtur shumë mungesën e tyre. Nëna mbylli sytë pa i parë më kurrë!.Kështu, malli për vendlindjen ishte shumë i madh"- thotë z.Skepi themeluesi i radio "Jehona e Shqipes".

Sakipi nuk e ka të lehtë t'u kthehet atyre viteve. Nëna dhe babai i dhanë një të ardhme tjetër, një jetë të lirë. Por Shqipëria mbeti pengu i tij, që se la të qetë derisa më në fund e pa të lirë në vitin 1991. "Nuk doj aqë të kthehesha në Shqipëri si turist. Në 12 maj 1958 ne jemi dorëzuar në ish-Jugosllavi, në 12 maj 1991 unë kam shkelur në Shqipëri si një nga misionarët e "Mjekëve pa kufij"-thotë Sakip Skepi. Si e gjeti Shqipërinë post-komuniste?! E rrënqethën radhët e gjata për qumësht në tre të mëngjesit, po aq sa do ta tmerronin pamjet e spitalit distrofik të fëmijëve, prej nga filloi misioni shëndetësor. Tani, pas shumë vitesh, Shqipëria është sërish shtëpia e tij, ku Sakip Skepi shkel sa herë e merr malli. Kujtojmë që dëshira e të nxënit të sa më shumë dijeve bëri që Sakip Skepi të mbaronte studimet, për Ekonomi –Fiskalitet dhe të niste nga puna. Në vitin 2005 nisi punën duke u marrë me imobilare dhe sigurimin e Kredive Bankare pasi dhe është diplomuar dhe për sigurimin e kredive.

Por dashuria e parë për Sakipin mbetet radio prej së cilës nuk hoqi dorë në asnjë moment, madje përkushtohet sa më shumë që të mbetet një zë i fuqishëm për shqiptarët në Bruksel dhe mbarë Belgjikën!

vijon në faqen 22

MUHARREM GJOKA

"Mjeshtër i Madh" dhe "Qytetar Nderi" i Qarkut Dibër

Nga **HALIL RAMA**

Zall – Dardha, Dibrës dhe madje gjithë Shqipërisë i ka dhënë kulturën dhe artin, duke e furnizuar me artistë, këngë e valle. Të shumtë janë artistët nga Zall Dardha të njohur jo vetëm brenda vendit, por edhe ndërkombëtarisht. Muharrem Gjoka është njëri prej tyre, i cili vjen në 80 vjetorin e ditëlindjes (këtë 16 qershor) me bukuri të rrallë fizike e shpirtërore, (si edhe në moshën e tij rinore), i përmbushur në të gjitha aspektet e jetës si askush tjetër; me memorien e freskinë e mendimit e të veprimit, me një familje shembullore dhe me miq e shokë të shumtë nga e gjithë Shqipëria, Kosova e hapësira mbarëshqiptare në botë.

Ai ka kontributin e tij të spikatur në krijimin dhe drejtimin artistik të Ansamblit 'Hazis Ndreu' – "Nderi i Kombit", si president i këtij amsambli prej më se një dekade. Duke evidentuar dhe vlerësuar talentet krijuese e interpretuese si dhe veprimtarinë e shumanshme organizative, ai i ka shërbyer lartësimit të folklorit, etnografisë, valleve dhe kulturës popullore shqiptare dhe veçanërisht, asaj dibrane.

Të nderosh artin dhe njerëzit, që e krijojnë atë, që kontribuojnë kaq shumë, është jo vetëm një detyrë, por edhe një kënaqësi e veçantë. Folklorin, këngën dhe vallen, Dibra i ka në genet e saj, siç ka patriotizmin dhe besnikërinë ndaj Atdheut. Ndaj dhe Muharrem Gjoka nuk rresht për t'i promovuar këto vlera.

Të nderosh artin dhe njerëzit, që e krijojnë atë, që kontribuojnë kaq shumë, është jo vetëm një detyrë, por edhe një kënaqësi e veçantë. Folklorin, këngën dhe vallen, Dibra i ka në genet e saj, siç ka patriotizmin dhe besnikërinë ndaj Atdheut. Ndaj dhe Muharrem Gjoka nuk rresht për t'i promovuar këto vlera.

"MJESHTËR I MADH", TITULL I MERITUAR PËR MUHARREM GJOKËN

Muharrem Gjoka, President i Ansamblit Artistik "Hazis Ndreu" – "Nderi i Kombit" është dekoruar nga ish - Presidenti i Ilir Meta me titullin "Mjeshtër i Madh", me dekret Nr. 13092, datë 08.06.2021. Vetë motivacioni që mban dekorata: "Në vlerësim të veprimtarisë dhe mbështetjes së shumanshme në lartësimin e kulturës kombëtare, vlerave atdhetare, folklorit dhe muzikës popullore shqiptare,

veçanërisht asaj dibrane, si dhe të kontributit të veçantë në zhvillimin dhe përparimin e vendit", është vlerësimi më objektiv i rolit të këtij personaliteti dibran. Në fjalën e tij, kreu i shtetit do të vlerësonte se: "Prej vitesh pranë këtij grupimi artistik, si një dorë e ngrohtë, inkurajuese dhe mbështetëse, është një emër, i cili e nisi jetën e tij artistike si një talent i skenës dhe i valles dibrane . Dhe sot është president i këtij ansambli, ish-valltari virtuoz, një burrë Dardhe dhe Dibre, i vlerësuar edhe me Titullin 'Nderi i Qarkut Dibër', zoti Muharrem Gjoka. Roli i tij është i padiskutueshëm si artist dhe si njeri me zemër të madhe, me një kontribut më shumë se 50-vjeçar, duke gëzuar respektin e meritуar në shoqëri, edhe si një humanist".

Muharrem Gjoka, si mishërues dhe përçues i fjalës së mençur dibrane u "diplomua" në kantieret e ndërtimit e asfaltimit të rrugëve në gjithë vendin, ku implementoi suksesshëm dijet e marra në "Universitetin e Dibrës", leksionet e të cilit i përvetësoi nëpër odat e kuvendet dibrane....

Dhe jo vetëm në këto kuvende, por edhe nga miqësia e pandërprerë me ikonën e artit e kulturës kombëtare Hazis Ndreu, Muharrem Gjoka do të përvetësonte artin e fjalës së mençur e të komunikimit në mexhelise si dhe risitë nga studimet e thelluara të etnologut të shquar dibran për origjinën e Kastriotëve e vendlindjen e Heroit tonë kombëtar Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, si dhe për luftrat legjendare të dibranëve kundër pushtuesve serbë nën udhëheqjen e "gjeneralit me shajak" Elez Isuf Ndreu.

Muharrem Gjoka do ta mikpriste Artistin e Meritуar Hazis Ndreu në shtëpinë e tij në Laç dhe do ta shoqëronte atë në takimet në Tiranë me kolosin e letrave shqipe Dritëro Agolli si dhe në Shkodër, ku artistë me emër të Estradës e Teatrit "Migjeni" i rezevonin atij takime e pritje madhështore. Pikërisht këto takime do t'i shërbenin Muharrem Gjokës të ngjiste shkallë të reja në njohjen dhe përvetësimin e të rejave të artit e kulturës sonë kombëtare. Ndaj dhe ndjen krenari të ligjshme që me pasion e përkushtim të rrallë drejton Ansamblin Artistik, që mban emrin e ish-partizanit që mori pjesë në luftën heroike për çlirimin e Tiranës, (luftë ku ranë dëshmorë 3-4 djem nga Dardha) dhe që për vite e dekada, siç e kanë vlerësuar edhe të mëdhenjtë e letrave, të artit e kulturës: Dritëro Agolli, Moikom Zeqo, Kolë Jakova, Drago Siliqi, Agron Tufa, Prof. Bujar Kapexhiu, Prof. Ramazan Bogdani, Reshat Arbana, Skënder Sallaku e Luftar Paja, ngjiti me meritë majat e pushtetit vendor e të institucioneve kulturore artistike në Dibër dhe bëri emër si artist i rrallë i përmasave kombëtare..

PROMOVUES I VLERAVE ETNOKULTURORE DHE ATYRE TË LANÇ

Me Vendimin Nr.03, datë 24.03.2021, Këshilli i Qarkut Dibër i ka dhënë Nënkryetarit të OBVL MUHARREM MEHDI GJOKA Titullin "NDERI I QARKUT DIBËR", me motivacionin: "Për mbajtjen gjallë të vlerave etnokulturore, për kontributin e çmuar në mbështetjen dhe promovimin e vlerave të LANÇ, dhe si ish-drejtues në fushën e ndërtimeve dhe infra-

strukturës rrugore në gjithë vendin". Kryesia e OBVL ndjehet krenare me nënkryetarin Muharrem Gjoka, këtë burrë të nderuar, dibranin dinjitoz, kontribues dhe i përkushtuar në vite, profesionist i vërtetë në punën e tij, mjeshtër në kantjeret e rrugëve dhe hidrocentraleve, mishërues dhe përçues dinjitoz i mençurisë dhe urtësisë dibrane. Këto vlera të spikatura të tij janë evidentuar më së miri të premten më 17 prill 2021 në një ceremoni festive të organizuar në Peshkopi nga Këshilli i Qarkut Dibër.

Muharremi lindi në vitet e luftës, Në Zall Dardhë, Dibër më 16 qershor të vitit 1943. Kaloi një fëmijëri të vështirë, por kjo e bëri më të fortë dhe të vetëdijshëm për të çarë rrugët e jetës. Që në vitet e rinisë së tij u inkuadrua në kantieret e ndërtimit të rrugëve, fillimisht në Kantierin Skuraj ku nga tetor 1955 - 1962 punoi në ndërtimin rrugës Skuraj-Bulqizë, duke afirmuar cilësi të jashtzakonshme, të njeriut punëtor, korrekt, kreativ, por edhe drejtues i aftë. Vitet e shërbimit ushtarak e largojnë prej ketu dhe mbrojtja e Atdheut e kërkon në Bilishtin e largët, në kufirin me Greqinë. Prej aty, ai shërben syshqiponjë edhe në Poçarin e largët në Leskovik, duke lënë gjurmët e mira të një patrioti të guximshëm dhe të një ushtari e djali të mirë. Sërish pas shërbimit ushtarak në kantieret e ndërtimit, nga njëri fshat në tjetrin, si në Spaç, Shupal, Reps, Arrëz, Miliska, Fierzë, Gropa, Haprripe etj, Muharrem Gjoka stamponte çdo ditë me punën dhe sjelljen e tij, emrin e mirë, duke krijuar një personalitet të padiskutueshëm. Veçanërisht aftësitë e tij organizuese dhe drejtuese spikatën në vitet 1965- 1966 në ndërtimin në një kohë rekord të rrugës Qafë Mali – Fierzë dhe në vitin 1972 për asfaltimin e rrugës nacionale Peshkopi-Bulqizë. Më pas, cilësitë e tij dhe vrulli i punës e afirmojnë edhe në Vaun e Dejes, madje aty kreu edhe studimet e shkollës së mesme në teknikumin e ndërtimit, duke rritur më shumë nivelin e tij, jo vetëm profesional, por edhe intelektual. Tashmë shkollimi i jep mundësinë që të zgjidhet në detyra të rëndësishme, duke qënë edhe drejtuesi i transportit. Jo rastësisht ai mori përsipër mjaft punë të mira në asfaltimin e rrugëve të Pukës, Shkodrës, Kukësit, Bulqizës, Rrëshenit, etj. Viti 1979, solli një shpërblim të gjithë këtij angazhimi dhe pune titanike, duke u pozicionuar në qytetin e Laçit, ku zgjedh edhe të banojë me familjen e tij të re dhe aty vijon të jetojë e kontriboj për shumë vite. Këtu kryen edhe shkollën ekonomike, çka i mundësoi ngjitje në shkallët e karrierës, deri Shef i Transportit të Ndërmarrjes së Asfaltimit që mbulonte gjithë Veriun e Shqipërisë.

Pas viteve 90, kantieri ku ai punonte, Rruga Ura, u privatizua, konkretisht në vitin 1994, por Muharremi vijoi të ishte sërish aty, si drejtues kantieri deri në vitin 2002. Dy vjet më pas, pra në vitin 2004, ai del në pension, por kjo shkëputje, asnjëherë s'e ndali atë në vrullin e përjetshëm të angazhimeve dhe punëve të mira në dobi të familjes, vendlindjes dhe Shqipërisë.

Muharrem Gjoka, mbetet në ajkën e njerëzve të mirë dhe burrave të ndershëm e të përkushtuar, që përmes punës, fjalës, sjelljes, por mbi të gjitha veprave të mëdha në shërbim të komunitetit, kanë një vend të meritуar në shoqëri dhe komunitet.

Prej më shumë se dhjetë vitesh Muharrem Gjoka kryen funksionin e Presidentit të Ansamblitt Artistik "Hazis Ndreu" – "Nderi i Kombit", i cili ka konkuruar dhe fituar çmime të para në festivale ndërkombëtare, si në Ulqin, Tetovë, Shkup, Strugë, Stamboll e Prishtinë. Po ashtu, që nga Kuvendi i shtatë i OBVL është zgjedhur Nënkryetar i kësaj organizate, funksion të cilin e kryen me përkushtim të rrallë. Aktiviteti i tij i mësipërm është vlerësuar me Çertifikatë Nderi nga Shoqata Kombëtare e Miqësisë dhe Bashkëpunimit Shqipëri-Itali; me Mirënjohje nga Qendra për Kulturë në Ulqin; me Çertifikatë

Mirënjohje nga Ansambli Artistik "Kuvendi" Zall Dardhë, ndërkohë që mban edhe Titullin "AMBASADOR I PAQES", dhënë nga Federata e Paqes Universale.

Vlerësimi i kontributit të nënkryetarit të OBVL-së, **MUHARREM GJOKA**, me titujt **"Mjeshtër i Madh"** dhe **"Qytetar Nderi" i Qarkut Dibër**, parasëgjithash është vlerësim për Organizatën e Bashkuar të Veteranëve të LANÇ, e cila prej 29 vitesh që nga krijimi i është përkushtuar edukimit atdhetar të shoqërisë dhe të brezave.

profil

Intelektualët si Petrit Rama nuk e shpërdorojnë jetën dhe kohën për të përfituar për interesa personale, por e përdorin atë edhe në shërbim të të tjerëve.

Jeta dhe puna e **Petrit Ramës, shembulli** për t'u ndjekur

Nga **SHAQIR SKARRA**

Ishte e diel atë ditë. As vetë nuk e di se si një zë i njohur nëpërmjet telefonit më ftonte për një kafe.

-Alo! Jam Petrit Rama! Nëse keni kohë mund ta pimë një kafe të dy bashkë në Laprakë.

Ishte fund vjeshte dhe ai, pasi i kishte mbaruar të gjitha punët, si një fermer i mirë, kishte ardhur për një vizitë mjekësore dhe kafen e parë kishte shprehur dëshirën ta pinte me mua. Falë profesionit, unë kam shkruar për shumë ngjarje, histori, personazhe në Dibër e jashtë saj, por këtë radhë me të drejtë u ndala në Shumbat. Nuk di se si, por asnjëherë nuk më rastisi që qoftë edhe dy fjalë ti shkruaj për Petrit Ramën. Petritin e njohin jo vetëm në fshat, jo vetëm në zone, por edhe në Dibër se Petriti ka një aktivitet mbi dyzet vite që punon dhe drejton në sektorë të ndryshëm të ekonomisë.

Jemi rritur bashkë, jemi të dy nga e njëjta lagje, pothuaj moshatar. Petriti ka lindur, është rritur dhe edukuar në një familje atdhetare dhe mjaft arsimdashëse. Shkollën tetëvjeçare e përfundon në vendlindje me vlerësimin maksimal dhe shkollën e mesme bujqësore në Peshkopi në vitin 1973 me notë mesatare 9. 8.

Në ato vite Peshkopia kishte bërë emër të mirë në fushën e arsimit, ku shquheshin shkolla e mesme bujqësore, shkolla e mesme pedagogjike dhe gjimnazi i qytetit. Në shkollën e mesme bujqësore dhe në atë pedagogjike vinin nxënës edhe nga rrethet e tjera të vendit si Mati, Kukësi, Tropoja, Hasi etj. Ishin shkolla model në shkallë vendi dhe me konvikt. Edhe Petriti, si nxënës i rregullt, e përfundon shkollën me mesatare të lartë, ku nuk kishte asnjë pengesë për të vazhduar studimet e larta dhe e drejta e studimit i doli për në Institutin Bujqësor Tiranë, dega zootekni, të cilin e përfundon me rezultate të larta në vitin 1977.

Gjatë studimeve në shkollën e mesme Peshkopi Petriti fitoi olimpiadën e matematikës mes tre shkollave më të mira të qytetit të Peshkopisë.

Pas përfundimit të studimeve të larta, Petriti do të kthehet në vendlindje, kur për mbi dyzet vite me radhë do të punojë në institucione të ndryshme si Sllovë, Fushë-Çidhën, në filialin e përmirësimit racor, si specialist në drejtorinë e bujqësisë rrethit, mësues në shkollën e mesme Sllovë dhe më kryesore radhitet ndër kuadrot e parë që fitoi statutin e nëpunësit civil.

Kur sapo i diplomuar erdhi të punonte në Peshkopi ishte i ri, plot ëndrra për jetën, por që u përplas me vështirësitë e para, pasi në ato vite sektori më i vështirë ishte bujqësia dhe blegtoria. Dhe Petriti ishte diplomuar që të kontrollonte bazën ushqimore të blegtorisë dhe të ndiqte nga afër mbarëvajtjen e saj.

Por në fakt duhet pranuar se si bujqësia edhe blegtoria vlenin për të dëshiruar. Petriti nuk u step, nuk u tremb, nuk u tërhoq përballë këtyre vështirësive.

Petriti për vite me radhë ka shërbyer si mësues i jashtëm, ka dhënë lëndët biologji, e zootekni dhe si mësues aktiv ka dhënë histori, gjeografi, aftësim për jetën dhe filozofi. Preferencat e tija, edhe sot që i gëzohet pensionit të pleqërisë, është matematika, gjenetika dhe filozofia. Një mësues i mirë i respekton nxënësit e tij. Në një klasë të një mësuesi të mirë, idetë dhe mendimet e secilit person vlerësohen. Nxënësit ndjehen të sigurt për të shprehur ndjenjat e tyre dhe mësojnë të respektojnë dhe të dëgjojnë të tjerët.

Për shumë kohë Petriti ka punuar në pushtetin vendor si kryetar i parë pluralist për Shumbatin, antar i këshillit komunës Sllovë, kryetar i këshillit komunës Sllovë. Karakteri i njeriut formohet e forcohet në përpjekje për të arritur gjithmonë më të mirën, duke u kacafytur shpesh me të keqen, e cila ka për

Petriti është pa dyshim një emblemë e gjithë zonës së bukur të Ujemujës dhe në veçanti të fshatit ku lindi dhe u rrit Shumbat. Ai me punën e tij vetëmohuese ka hyrë tashmë në elitën intelektuale. Ai është një specialist mjaft i zoti në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë që e kalon stekën e kohës. Është simbol i njeriut të punës, që flet pak dhe bën punë shumë, që vrapon më shumë se sa koha. Tërë jetën e tij e ka kaluar me dinjitet, personalitet në çdo vend pune deri në majat e pushtetit lokal.

detyrë "të zërë rrugën", të të mundojë e të të lodhë shumë që të dorëzohesh, por në fakt Petriti nuk ishte i tillë, nuk u dorëzua kurrë nga rruga e minuar ku shkelte, se e hidhte hapin me kujdes e maturi.

E njohu mirë jetën, me uljet e ngritjet e saj, duke e filluar atë nga hiçi për të arritur më vonë shumë në formimin e tij, dhe dinte fare mirë sa jepte e merrte për të ndërmarrë më pas veprime, që në fund të fundit, do të ishin si një shtërngatë për ti dhënë vetë jetës drejtimin e duhur.

Gjërat më të bukura apo ato që të dëshpërojnë në jetë, nuk mund të dëgjohen, të shihen e të preken. Ato vetëm mund të ndjehen. Brezi i Petrit Ramës ishte i vështirë, përjetuan kohra shumë të vështira, por ata që deshën të mbesin njerëz, njerëz mbetën, ashtu siç mbeti edhe vetë Petriti.

Në jetën me plot ngjarje të lakmueshme tek Petrit Rama gjen njeriun e bindur për të kryer veprime të guximshme, pa e ditur se ai ato i bën nën trysninë e ndërgjegjes së pastër dhe të njeriut idealist.

Kam parasysh këtu veprimtari të tij, të cilat kur i sjellim e i ballafaqojmë me atë çka bëjnë brezi i ri për vendin, për flamurin të cilit i këndojnë nga mëngjesi në darkë e nga darka në mëngjes, të duket sikur atdheu është në dorë të intrigantëve, të cilët të drejtët dhe idealistët i marrin për naiv e budallenj.

Jeta ka provuar se ai që shpërfill mundimin, vuajtjet, përgjithësisht sakrificën për të arritur diçka të vyrtytshme.

Në fund ndjehet i lumtur dhe i plotësuar në shpirt e në ndërgjegje. Petrit Rama i ngjan pa dyshim i ngjan, është "binjak" me çdo njeri që i ngjit shkallët e karrierës me urtësi, duke e konsideruar pozicionin apo një detyrë të lartë si një premtim të mundimit për të arritur deri aty.

Janë vetë sfidat ata që e bëjnë jetën interesante e këto sfida nuk munguan as në jetën e Petritit. Ai nuk ishte vetëm një ëndërrimtar për ti kryer punët ashtu siç duhej. Kishte edhe bindjen se brenda vetes fshihej forcë, durim dhe pasion për të gjetur fjalën me të gjithë.

Tashmë që i gëzohet pensionit të pleqërisë dhe dalngadalë po feston 70 vjetorin e lindjes, ende punon, puno dhe lexon. Në shtëpinë e tij gjen mjaft libra jo vetëm të profesionit por edhe libra artistik, studimor, filozofi e psikologji . Edhe kohën e lirë nuk e kalon kot, ndaj në kohë pushimi, mjet çlodhje për të mbetet vetëm libri.

Në tokën e tij, në Shumbat, ka mbjellë mbi 20 dynim pemtore, duke iu kthyer kështu traditës së bujqëve të parë të fshatit. Ka mbjellë drurë frutor si kumbull, mollë, qershi, të cilat tashmë prej vitesh i ka në prodhim. Të gjitha shërbimet e nevojshme ua bën vetë, së bashku me familjen. Petriti ndihmon dhe bashkëfshatarët duke i këshilluar dhe mësuar për krasitjen, rolin e kimikateve, kujdesin në përdorimin e pesticideve, shërbimet e tjera teknike që duan pemët etj. Kot nuk thonë se bujku i mirë ia merr me zor prodhimin tokës, dhe pa dyshim Petriti është bujk, agronom, zooteknik. Mbi të gjitha është njeri, njeri i dashur dhe i vlerësuar jo vetëm nga bashkëfshatarët por edhe të tjerë. Dhe megjithatë ka rezervat e tij. "Dibranët janë puntor, nuk ka mbetur cep toke e pa mbjellë. I kultivojnë të gjitha si drithrat e bukës, drurët frutor, jonxha e foragjere për bagëti etj. Problemi kryesor për to mbetet tregu. Qershia, molla e kumbulla e Shumbatit kanë krijuar identitetin e tyre tashmë, ashtu sikurse dhe fasulja, por ndodh tamam në kohën e vjeljes dhe prodhimi është i mbarë, ato kalben në arë, mbeten stok në parcelë. Dhe pse? Neglizhenca e shtetit, politikat e tij të gabuara ndikojnë që i gjithë tregu ynë të mbushet me prodhime nga Maqedonia, Bullgaria, Greqia dhe prodhimet shqiptare të kalben në parcela. Nga kjo ka ndikuar shpesh rebelimi i fermerëve që i kanë prerë drurët frutor, i kanë hedhur prodhimet e mbledhura".

Jeta është një pasuri e çmuar, shumë vlerash, për kontribute personale e shoqërore. Ka plot intelektual që jetën e menaxhojnë thjeshtë për interesa personale dhe që i takojnë vetëm familjes së tyre. Por ka edhe të tjerë, që pasurinë e tyre intelektuale e vënë në shërbim të shoqërisë për ti kontribuar asaj drejt përparimit. Petrit Rama është njëri ndër ato intelektual që diellin e ka parë si burim energjie, jo thjeshtë për të ngrohur oborrin e tij familjar, por për të ngrohur e ndriçuar të gjithë .

Intelektualët si Petrit Rama nuk e shpërdorojnë jetën dhe kohën për të përfituar për interesa personale, por e përdorin atë edhe në shërbim të të tjerëve.

Petriti është pa dyshim një emblemë e gjithë zonës së bukur të Ujemujës dhe në veçanti të fshatit ku lindi dhe u rrit Shumbat. Ai me punën e tij vetëmohuese ka hyrë tashmë në elitën intelektuale. Ai është një specialist mjaft i zoti në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë që e kalon stekën e kohës. Është simbol i njeriut të punës, që flet pak dhe bën punë shumë, që vrapon më shumë se sa koha. Tërë jetën e tij e ka kaluar me dinjitet, personalitet në çdo vend pune deri në majat e pushtetit lokal.

Qetësia shpirtërore që pas shëndetit fizik është elementi kryesor për njeriun, ai e ka siguruar në mjedisin e shëndoshë familjar. Burimin e lumturisë dhe paqes shpirtërore, ai e ka gjetur tek puna pasionante për të komunikuar dhe shërbyer njerëzve. Edhe pse në sektorin privat, ai di ta menaxhojë punën, di të komunikojë dhe ti bëjë njerëzit për vete dhe kush futet njëherë të vetme në objektin ku punon , nesër do të vijë përsëri dhe do bëhet klient i rregullt i tij.

Raporti midis të mirës dhe të keqes, brenda vetëdijës së tij, ka ditur ti ndaj edhe nga ana morale dhe ajo intelektuale. Nuk është tunduar kurrë nga pasuria, se e di fare mirë se atë mund ta humbasësh një ditë, ndërsa emri dhe lavdia nuk humbasin kurrë por trashëgohen ndër breza. Emri dhe lavdia nuk vijnë fare rastësisht. Ato janë bilanci i një rruge të gjatë, plot punë, mund djersë e sakrifica. Njeriu vlen për atë, që mund të gjykohet nga personaliteti dhe vepra e mirë që lë pas.

Edhe pse tashmë Petriti në moshë të tretë, energjitë intelektuale nuk i kanë shteruar. Shkallët e dijes i ka ngjitur me vullnet, punë e këmbëngulje pa patur asnjë përkrahje politike apo shoqërore e miqësore.

Petrit Rama gjithmonë ka qenë vetvetja në çdo kohë, ka një individualitet superior i shprehur nëpërmjet punës pa shumë pretendime për tu dukur.

Pasuria ma e madhe e tij është padyshim personaliteti njerëzor dhe sjellja tepër e kulturuar me njerëzit. Dituria intelektuale dhe profesionale janë velloja e artë, që ia zbukurojnë personalitetin e tij shoqëror brenda dhe jashtë vendit.

Postet e larta që ka mbajtur, përfitimet hierarkike, privilegjet e pushtetit nuk e kanë larguar nga burimi i brendëshëm i qetësisë, që e ka gjetur në familje dhe shoqëri. Është i dashur gjithmonë me të vërtetën dhe i rreptë me pa drejtësinë. Nuk ka bërë e nuk bën kompromis me karakterin e tij. Ai është i paisur me dhunti shpirtërore të atillë, që e bëjnë të lumtur kur dhuron lumturi tek të tjerët.

Pasuria shpirtërore është pasuria ma e madhe që bën dallimin mes njerëzve. Lumturinë e vet, mes të tjerave e sheh të përfshirë te puna, ushtrimi i profesionit. Lumturia për vetë njeriun, është e lidhur me botën shpirtërore të individit, se si e koncepton dhe çfarë pretendimesh ka ai për jetën.

Njerëzit me ndjenja të mëdha shpirtërore, dhe me aftësi të mëdha intelektuale e profesionale janë tepër të ndjeshëm dhe shumë human në shoqëri.

Petriti ka një botë mjaft të pasur shpirtërore intelektuale, që rrezaton ëmbëlsi, mirësi e shumë dashuri. Ai ka një zemër të madhe, që në fakt shëron çdo lloj sëmundje që burojnë nga ligësia dhe lakmia e vetë njeriut. Nderimin dhe vlerësimin për shokët, miqtë dhe bashkëfshatarët i ka cilësi të lartë morale të trashëguara nga tabani i fortë dhe i qëndrueshëm familjar ndër breza.

Në shoqërinë e sotme, njeriu shikon deri tek pragu i interesave të ngushta, ku zilia dhe urrejtja sundojnë në jetën e përditëshme. Tek karakteri i fortë i Petritit nuk ka kanë gjetur shteg hapur të depërtojnë. Ai e ka gjetur veten tek e vërteta, e drejta, dituria, mirëkuptimi, inteligjenca, shpirtmadhësia, humanzimi dhe bashkëpunimi me të tjetër.

Është gati e pabesueshme se si tek ai kombinohen gati në një, tiparet njerëzore si karakteri pozitiv, energjia pozitive dhe për të gjitha ato që bën, pa dyshim është edhe një mik mjaft i mirë për këdo.

Rruga e Arbërit nr. 195-196

botim i ri

Libri "Eseistika e Kadaresë" është një vështrim kritik mbi esetë "Legjenda e legjendave", "Kushëriri i engjëjve", "Ra ky mort dhe u pamë" dhe "Ardhja e Migjenit në Letërsinë shqipe"

Librin "Eseistika e Kadaresë" dhe botime të tjera të shkrimtarit Xhafer Martini mund t'i gjeni në Tiranë te libraria jonë në rrugën "Isa Boletini", pranë kryqëzimit te Selvia ose te libraria Art's pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës. Lexuesit në rrethe mund ta porosisin te libraria në qytetin e tyre ose mund ta porosisnin në email: mbbotime@gmail.com, cel. +355 68 650 8441 (Whatsapp) ose me komente dhe mesazhe në fb. Posta brenda vendit është FALAS.

Eseistika e Kadaresë,

libri i ri i autorit Xhafer Martini

Me Ismail Kadarenë jam njohur kur ai ishte redaktor në gazetën "Drita" dhe unë student në fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë, dega e Gjuhës dhe e letërsisë. I çova tre-katër vjersha për t'i parë dhe botuar. Ishte e para herë që takohesha me shkrimtarin më të madh të vendit. M'i mbajti vjershat dhe më tha që do t'i lexonte. Të dielën, si zakonisht, u ngrita herët dhe mora gazetën "Drita", jo për vjershat e mia se, edhe nëse do të ishin pëlqyer, nuk shpresoja të botoheshin aq shpejt. Por, për çudi, vjershat e mia i pashë në faqen e dytë të gazetës. Kadare më botoi vjersha edhe dy-tri herë të tjera. Më përmendi si poet i ri i mirë në Konferencën e Talenteve të Reja disa vite më vonë. Të të përmendte Kadare, të të vinte në listën e më të dalluarve, ishte diçka me shumë rëndësi për një krijues të ri...

Kadarenë e kam pas një vit edhe pedagog. Na jepte letërsinë dekadente, siç quhej atëherë ajo lloj letërsie që në fakt përfshinte autorë të mëdhenj, si: Prusti, Xhojsi, Kamy, Sartri dhe të tjerë. Dita kur kishim leksion me të ishte si ditë feste, jo vetëm për ne studentët e gjuhës dhe të letërsisë, por për të gjithë Filologjikun. Dyert e sallës së madhe ku ai vinte për të dhënë leksion, rrinin hapur, se kishte plot studentë të degëve të tjera të Filologjikut, por edhe të fakulteteve të tjera që dëgjonin në korridor, i mbushur plot. Nuk pipëtinte asgjë veç zërit të Kadaresë. Ai të bënte për vete me mendimin e thellë, me fjalorin e pasur, me mënyrën se si i përcillte njohuritë që i kishte shumë të begatshme. Të bënte për vete edhe me staturën e tij: i ri, i bukur, elegant, me qëndrim të hijshëm dhe dinjitoz. Vajzat, kur kishim leksion me Kadarenë, zinin vendet e para në auditor, ndryshe nga ç'vepronin me pedagogët e tjerë kur strukeshin në fund dhe bënin çuçu gjatë gjithë orës.

Përmbajtja e leksioneve të Kadaresë ishte shumë interesante. Ai bënte sikur i kritikonte autorët e mëdhenj botërorë, në të vërtetë nxirrte në pah vlerat e tyre. Ai dinte që mbi një diçka të projektonte diçka tjetër. Kadare në çdo krijim kishte disa shtresa kuptimore. Kjo lëndë ishte vënë në program që studentët të mësonin dhe për një letërsi dekadente, borgjeze e revizioniste, që nuk zhvillohej sipas parimeve "të shëndosha" të realizmit socialist. Në të vërtetë mësuam se kishte një letërsi ndryshe nga ajo e realizmit socialist, një letërsi e pasur me autorë e vepra që kishin miliona lexues. Në vitet e demokracisë, kur këtë letërsi ne e kishim në dorë, kuptova se leksionet e Kadaresë kishin qenë orientuese, për të kuptuar një letërsi të madhe. Nuk e di ç'u bë me atë lëndë kur ne mbaruam shkollën. Sigurisht, nuk është zhvilluar më, se Kadare, që çdo ditë bëhej më i madh dhe më i njohur, i përkthyer jashtë, doli në profesion të lirë dhe, i zënë me vepra të tjera të mëdha,nuk kishte kohë për të punuar edhe si pedagog. Veç atij atë lëndë nuk mund ta jepte askush tjetër, të paktën, nuk do ta jepte si ai.

Kur mbarova shkollën e lartë, më emëruan mësues në Dibër, në shkollën tetëvjeçare të Fushë Alies, ku kisha dhënë mësim edhe para se të shkoja në fakultet. Aty, në qetësi dhe në vetmi, në paqësinë e jetës së fshatit që më pëlqente, megjithëse fshatin e kishte shkatërruar kolektivizmi, fillova të merresha me kritikën letrare. Shkrimet i dërgoja në gazetën "Drita". Përgjegjës për kritikën në këtë gazetë aso kohe ishte Vasil Melo, që i pëlqente shkrimet e mia dhe i botonte. Kam shkruar mjaft artikuj për vepra të veçanta të letërsisë sonë ose për probleme të ndryshme që dilnin para saj. Bëra gati edhe një shkrim për romanin e Kadaresë "Kronikë në gur", që u botua në gazetën "Drita" në një nga numrat e korrikut të vitit 1981. Shkrimi mbante titullin: "Jeta në gjerësi dhe thellësi".

Kur shumë vite më vonë lexova shkrimin e Arshi Pipës për këtë roman, (Arshi Pipa: "Kronikë në tre akte", në librin: "Subversion drejt konformizmit- fenomeni Kadare", Tiranë 1999) pashë që jo vetëm unë, por asnjë tjetër nuk e kishte kuptuar dukurinë shumështresore të këtij romani. Arshi Pipa pati meritën që karakterin dhe përmbajtjen antidiktatoriale të kësaj vepre ta pohonte qysh në vitin 1987, kur parathënia e tij për "Kronikë në gur" u botua në revistën amerikane "Telos", New York. Pipa, duke kuptuar artin e Kadaresë, arrin në përfundimin se dy të këqija e mëdha, lufta civile dhe lufta e klasave, e kanë burimin tek etja e Hoxhës për pushtet të pakufizuar, për ta pasur pushtetin vetëm për vete. Në një vend të parathënies së tij, Pipa thotë se Kadare, me mjetet e veta të sofistikuara, idealin komunist e quan një magji të zezë, si ato magjitë e magjistareve që i përgatisnin me lloj - lloj mbeturinash të ndyra që t'u bënin keq njerëzve.

Por shkrimi i Pipës për Kadarenë u mor si "punë armiqësore" e këtij shkrimtari, i cili, sipas mendësisë komuniste të kohës, përpiqej të denigrojë dhe të fajësojë shkrimtarin më të madh shqiptar. Edhe vetë Kadare ishte revoltuar me shkrimin e Pipës, duke e quajtur atë dashakeqës dhe denoncues. Ai shkruan: "Kur në fillim të viteve '80, shkrimtari I. Kadare është në gjendje të vështirë, shpejton ta shtyjë rrëzimin e tij në gropë. Shkruan një studim për të, ku rreket të vërtetojë se gjithmonë ky shkrimtar ka qenë kundër regjimit" (I Kadare: "Ftesë në studio", Tiranë 1990, f. 311)

Por qëndrimi i Kadaresë ndaj këtij shkrimi të Pipës për romanin "Kronikë në gur" ka ndryshuar. Ja si shkruan studiuesi i Kadaresë, Shaban Sinani: Kadare "Pasi e pati akuzuar A. Pipën si "denoncues" në fundin e viteve 1980, në librin "Ftesë në studio" dhe në mënyrë të vijueshme për disa vite me radhë, së fundi i është mbajtur mendimit se A. Pipa ishte njëri prej studiuesve më të meritуar të prozës së tij. Vëllimi i 4-t i botimit "Kadare - Vepra" , ku përfshihet romani "Kronikë në gur", paraprihet pikërisht prej studimit të A. Pipës, shoqëruar me shenjimin: "Në këtë botim për herë të parë romani shoqërohet nga parathënia e prof. Arshi Pipës, emigrant antikomunist, i dënuar i ndërgjegjes në Shqipëri dhe i arratisur më 1960." (Shaban Sinani: "Letërsia në totalitarizëm dhe "Dossier K"., Tiranë 2011, f. 421).

Shkrimi im qëndronte larg vështrimit të Arshi Pipës për romanin "Kronikë në gur". Dëshiroja të shkruaja një shkrim tjetër për romanin "Kronikë në gur", duke korrigjuar kështu të metat e shkrimit të parë. Por, me kalimin e kohës, kjo dëshirë u mposht nga interesat e tjera letrare. Iu vura punës për të studiuar dhe shkruar për eseistikën e Kadaresë, se kjo është pak e prekur nga vështrimi kritik. Gjithashtu, është shumë e pëlqyer nga ana ime. Kadare ka shumë ese. Është e pamundur për të shkruar për të gjitha. Zgjodha katër më të mira dhe shpresoj të kem bërë një vlerësim të meritуar dhe të drejtë të shkrimtarit dhe të kësaj pjese të krijimtarisë së tij.



Dita kur kishim leksion me Kadarenë ishte ditë feste, jo vetëm për ne studentët e gjuhës dhe të letërsisë, por për të gjithë Filologjikun. Dyert e sallës së madhe ku ai vinte për të dhënë leksion, rrinin hapur, se kishte plot studentë të degëve të tjera të Filologjikut, por edhe të fakulteteve të tjera që dëgjonin në korridor, i mbushur plot. Nuk pipëtinte asgjë veç zërit të Kadaresë.

ESEISTIKA E KADARESË
XHAFER MARTINI
ISBN 978-9928-387-46-2

Botimet M&B
Faqe: 160
Çmimi: 800 lekë

Librin dhe të tjera botime të poetit Artan Gjyzel Hasani mund t'i gjeni në Tiranë te libraria jonë në rrugën "Isa Boletini", pranë kryqëzimit te Selvia ose te libraria Art's pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës.
Lexuesit në rrethe mund ta porosisin te libraria në qytetin e tyre ose mund ta porosisnin në email: mbbotime@gmail.com, cel. +355 68 650 8441 (Whatsapp), 0692068603 (Viber) ose me komente dhe mesazhe në fb.
Posta brenda vendit është FALAS.

Idioticus, *nga Artan Gjyzel Hasani*

HOMO IDIOTICUS

fluturojnë në ajër edhe gomerët më në fund
me maska në fytyrë që të mos infektohet Marsi
kam lënë tymosjen që të shpëtoj planetin
një cigare e imja ndezur në Afrikë
shkrin ajsbergun tënd në Arktik
ujërat përmbytin trutë bashkë me qytetin
pikërisht kur ti je duke u martuar me një ndërtesë
natyrisht pasi je divorcuar nga një pemë
që të tradhëtonte me një burrë
që deri në orën 12 të mesditës është grua
janë shtuar shumë ata që hedhin gurin në lumë
aq shumë sa nuk ka kush ta kërkojë më
në këtë botë ku nuk humbet asgjë veç mendjes
dhe mendja e humbur është uterusi ku ngjizen idiotët
dema të lumtur pasqyruar kokëposhtë
në sytë melankolikë të lopës së jetës…
Homo Idioticus ndryshe nga vëllai i tij Sapiens
për një grusht para nuk i shet Djallit vetëm shpirtin
por edhe mendjen…

Homo Idioticus është çfarë ai thotë që është
dhe këtë ti duhet ta pranosh pa kushte
e për të ti je çka ai vendos sipas rastit të të quajë
misogjin, homofob, racist, fashist, armik i njerëzisë
ka mikrofonin në dorë, altoparlantin, kërbaçin dhe pushtetin
me peshoren sakate të drejtësisë jep verdikte
ku inteligjenca jote shpallet kriminale, e jashtëligjshme
e dëmshme për fëmijët e 50 hijeve të Gjinisë…

rri në shtëpi dhe në ekran më shfaqet veç fytyrë e tij
me nofulla katrore dhe pa tipare
Homo Idioticus *par exellence*
shtyp butonin, ndërroj kanalin
por s'kam ku ta çoj, kudo shfaqet ai
e mbyll dhe marr udhën për në dyqanin e armëve
tjetër zgjidhje s'ka
duhet blerë një pistoletë patjetër…
në mos për ata
për veten…

NEKROLOGJI PËR ATA QË S'KANË VDEKUR AKOMA

Njeriun Natyral e shpallën të vjetëruar
dhe mendjet perverse krijuan Njeriun e Ri
në laboratorët ku prej kohësh nuk ka më minj
siç krijuan më parë lule të bukura pa erë
dhe Delen Dolly dhe deledashët
me vështrimin e pikëlluar
krim dhe idiotësi përzjerë
në raportin një me një…

ruhuni nga zhdukja, o njerëz të vjetër,
po shtohen çdo ditë ata që nuk e dinë ç'janë
me sy metalikë si dyert e varrezës tuaj
krijesa plastike pa din e iman
kujdes, o të vjetëruar!
nëse nëna e idiotit gjithnjë vdes e mbarsur
Njeriu i Ri ka edhe babain shtatzënë…

PUTHADORE DHE DOREPUTHUR

ka edhe njerëz që iu pëlqen të poshtërohen
puthadorë mjeranë dhe dorëputhur arrogantë
ndihen mirë që nuk janë të harruar
në ekzistencën e tyre transparente
butakë njëqelizorë me bërthamë frikën
të lumtur kur edhe xhelati
në shfaqjen e radhës iu puth dorën
para se t'i çojë në djall…
fundja edhe poshtërimi
qënka një farë vëmendjeje…

idiotë poshtë e batakçinj lart
kombinacioni perfekt i Të Keqes
kryqëzimi ku dinjiteti humbet udhë
buzët e deformuara humbasin kuptimin
fytyra shndërrohet në surrat
gojët ngatërrohen aq lehtë me bythët
gjuha mbetet muskuli më i fuqishëm
dhe puthja nuk është më puthje



IDIOTICUS
ARTAN GJYZEL HASANI
ISBN 978-9928-387-22-6
Botimet M&B
Faqe: 120
Çmimi: 700 lekë

por lëpirje…
sa më i dobët të jesh ti idiot
aq më i fortë do të jetë batakçiu
se…
…jeni ju që njihni frikën
ndaj janë ata që s'njohin turpin…
pa ju ata vdesin
si derrat pa llucën
si hienat pa kërmën…
si mizat pa mutin…

MANASTIRI I KARMËS

e lodhshme të presësh Godonë
por e ke pritur ndonjëherë Karmën?

një ditë do të bien kambanat
brenda brinjëve të tua a të mia
nuk do të ketë më rrahje zemre
veç ding dong e kambanar askund
pa dëshmitarë kjo vetmi e gjallë
besimtarët shpartalluar qëkur
po këtë litar vallë cila dorë e lëkund?
gjoksi do të na shndërrohet në Manastir
dhe brenda tij do të dremisë Karma
do të rrimë zbathur e s'do të pipëtijmë
do harrojmë të flasim a të mbrojmë veten
do të zvarritemi, do të fshihemi sikur s'kemi qenë kurrë
dhe për të vrarë kujtesën do të harrojmë alfabetet
predikimet, psallmet e pakënduara dhe abatin
nga frika e Saj do të na merret fryma çdo ditë të jetës
dhe në qofshim me fat që Ajo të mos zgjohet
do të vdesim të padenjë por të padënuar
krenarisht të dhjerë dhe para afatit…

PARADOKS I PASHMANGSHËM

ti nuk ke pse të dëshpërohesh
që çastet e bukur janë aq të paktë
dhe shëmtia mbulon njerëz e vende
pluhur për t'u fshirë jemi, e dashur,
hallet e jetës nuk janë rastësisht aty
jane kujtesa e errët e mbijetesës
dhe mbrojnë lumturinë tënde
nga drita e tepërt
si gënjeshtrat të vërtetën…

IDIOTICUS MAXIMUS

në udhën e mundimshme të besnikërisë
të ndryshme e të kundërta në dukje
nëna dhe bija njëkohësisht
motra
binjake
nganjëherë e njëjta
tradhëtitë dhe dashuritë njësoj më deshën
dhe i desha…
besnik ndaj vetes a tjetrit
në të vërtetë kjo është çështja
ku ngatërrohen paragjykuesit,
moralistët dhe kontrabandistët e zemrave
predikuesit dhe poetët…

tradhëtia është dashuria për një tjetër
dashuria tradhëti ndaj vetes…

por sa më shumë njeh tjetrin
dhe e do
aq më pak njeh veten
dhe e përçmon
të duket e huaj
dhe ajo fillon të të urrejë
me zhgënjim pasqyrash…

Vetja - e keqkuptuara e përhershme
e pabesueshmja e pabesë
e panjohura e madhe
delja jonë e zezë
në bardhësinë tonë shtinake
akuzuar me krimin e Lirisë
në mungesë të provave
dënuar me jetëgjatësi…
vrasësja e përhershme e Tjetrit…
në dashuri me kufomën e tij…

pastaj vjen më e keqja e të këqijave
humbet veten dhe tjetrin….
ulesh përballë botës dhe filozofon
dhe shkruan poezi si kjo
mbi fajin që në të vërtetë
nuk ekziston
duke fajësuar planetet
horoskopët
e ndonjëherë edhe fshirësen e xhamave
të limuzinës që po pret
aty ku dikur shiu i ngjante asaj…
në mos nga flokët
të paktën nga sytë….

TRAU I DËSHIRAVE

idetë janë si lepujt
sa më shumë frikë të kenë
aq më shumë shtohen
nga mendja zbresin në gjoks
dhe bëhen dëshira
të etura
të verbëra
udhëhumbura
të hutuara zbresin teposhtë
avull mbi trup
zjarr nën lëkurë
me nxehtësinë e tyre
e zgjojnë nga gjumi…

ai ngrihet
ato kalojnë
ulet prapë
dhe unë i çlodhur për vdekje
nga kjo raskapitje kapitëse
ndez cigaren e famshme…

Poezia e Canametit të lë mbresa.
Ajo shpërfaq mendimin me fjalë prekëse.

Rruga e Arbërit nr. 195-196.
recensë

Poezia e Canametit, një kambanë e shqetësimit njerëzor

Nga **MEVLUD BUCI**

Në vite e ngjarje të Matit, Bajrami ka qenë dhe do të mbetet kronikani i dritëlirisë. Vargjet e tij pasyrojnë jetën, vlerat atdhetare, kullat, njerëzit e mirësisë. Që në moshë të re, Bajrami është marrë me poezi. Krijimet e para i botoi në gazetat "Adriatiku", "Zëri i Rinisë", "Puna" në revistën "Nëntori". Në vitin 1974 arriti të botojë një almanak me poezi dhe dramën "Vajza dhe pushka". Pas viteve "90 ka punuar gazetar në gazetat "Atdheu", "Liria" etj.

Poezia e Canametit të lë mbresa. Ajo shpërfaq mendimin me fjalë prekëse. Po sjellim një strofë:

Rremull, o i zjarrti Rremull
të shkëlqeftë e bardha zemër,
mos e ndal ti fluturimin,
preke veç gëzimin...

Vëmë re në këtë libër të arrirë se Bajrami u këndon pa pengim, me adhurim e mirësi mjaft figurave të kombit, njerëzve të artit dhe të kulturës, shkruan vargje domethënëse për Matin, Kosovën, ShënTrininë, për peizazhet e bukura të atdheut e të vendlindjes, këndon me zë buçimtar duke mallkuar hipokrizinë dhe duke uruar mirësinë.

Si poet, ai shigjeton me vargje të satirës, gati fishtiane, kobe e makabritete të përçudnimit social-politik. Kjo duket në poemën "Kohë e trishtë", me një ritëm rebelues, plot thirrmorë e klithma që burojnë nga dëshpërimi, por edhe nga përçmimi ndaj së keqes.

Në këtë vëllim ka shumë zëra, mjaft intonacione që ngrenë lart fuqinë e të shprehurit. Këto zëra burojnë prej një shpirti të trishtuar e të ngazëllyer, prej një mendimtari epik dhe lirik, prej një njeriu të shqetësuar. Ndaj dhe titulli "Kambana e dhimbjes" është mjaft i gjetur dhe arrin të përbashkojë kuptimin e poezive në një vlerë të përgjithësuar ideore.

Bajrami e njeh mirë artin e fjalës, forcën ndikuese të saj përmes qartësisë së idesë dhe veshjes së saj në mënyrë të natryrshme me figurën artistike. Ai është mjeshtër i ritmit dhe i organizimit të poezisë pa zgjatje, duke synuar thelbësorene. Kësaj ia ka arritur, ndaj ky vëllim mbetet libri i tij më i mirë me poezi, çka tregon punën e vazhdueshme të autorit në drejtim të gjurmimit të fjalës dhe të kontekseve të saj.

Gjithë poetika buron prej një frymëzimi të sinqertë duke e parë njeriun me dashuri. Poezia e tij ndikon prej cilësive të mira që zotëron. Vëllimi "Kambana e dhimbjes", që po i përcillet lexuesit, është një realizim i bukur, një libër i freskët dhe me tematikë të larmishme, me kënd perceptimi jo vetëm ideor, por edhe estetik.

Në Mat ka vëretet një brez bahçevanësh të fjalës, si Basir Bushkashi, Hamdi Hysuka, Dabaj,Cenaj, Stana, Gjestila, Canameti, Xhani etj."Kambana e dhimbjes" shoqërohet me një sërë vlerësimesh nga Basir Bushkashi,Dukagjin Hata,Faik Xhani(Mjeshtër i Madh),Mevlud Buci,Joana Lleshi,Fatmir Neli,si dhe pajiset me një parathënie nga redaktori Qazim D.Shehu.

Ky libër mjaft i arrirë përcjell mesazhe,vlera,motive,gdhend portrete ,duke përçuar dhimbje,fisnikëri,kujtesë,humanizëm ,shoqëruar e materializuar këto me një gjuhë plot figuracion të natyrshëm e lakonizëm.

Dritësojnë vlerat,përvijohen traditat,zbulohen gjurmë të mbuluara nga shurdhëria dhe indiferenca e kohës,jepet kalvari i mundimeve.

Fatmir Neli midis të tjerave shkruan:"Në këtë libër,Bajram Canameti është po ai poeti i metaforave të fuqishme;për mua nuk është aspak rastësi që në pesë poezitë e para të këtij libri janë shpalosur edhe pesë shtyllat që ngrenë muzën e tij letrare:jeta,nëna,mësuesi,mesazhi qiellor dhe vargu poetik"(gazeta "Mati",shkurt 2003,f.18).



Gjithë poetika buron prej një frymëzimi të sinqertë duke e parë njeriun me dashuri. Poezia e tij ndikon prej cilësive të mira që zotëron. Vëllimi "Kambana e dhimbjes", që po i përcillet lexuesit, është një realizim i bukur, një libër i freskët dhe me tematikë të larmishme, me kënd perceptimi jo vetëm ideor, por edhe estetik.

Poet me kulturim vargu,me mendim,Bajram Canameti i bie kambanës së tij jo vetëm përmes dhimbjes, por edhe për t`u dëgjuar... duke na sjellë një libër që të imonon respekt për fjalën krijuese të realizuar aq bukur.

Bajrami ësht poet i blerimit të muzave të vendlindjes,por edhe poet i stigmatizimit tribunal i shëmtive të dukurive sociale dhe politike.Me thjeshtësi dhe fjalën të spikatur ai afron shumëkuptimësi strofash e lexime mesazhore të kthjellta:

Dhe i trullosur o njeri,
Sa të mundesh largoje ti,
kapu e jepi shpirtit mirësi,
Larg cinizmit vrastar,
Me një besim të ri
Ngadhnjimtar...(poezia "Armiku").

Poezitë e Bajramit pasyrojnë kohën jo me regjistër të thatë,por me një Un të fuqishëm në raportin kohë-individ,sepse ai është gazetari,intelektuali,misionari,shpirtvluari e shpirtsinqerti.E në këtë shqetësim e disponim vjen pastaj edhe kumtimi:

Për të gjetur udhën e artë
Brenda vetes kërko çelësin,
Busulla jep shenjën e qartë
Rrit virtytin,mposht vesin...

Të një bukurie estetike janë dhe vijnë poezitë:"Kredo","Një pyetje popullit tim","Atje në bregun e një lumi","Udha e lotit",ku aftësia vëzhguese e poetit arrin në përbirime soc-psikologjike.Ndaj poeti urtëson:

Përherë e kam çmuar lotin,
Që buron nga zemra të sinqerta,
Por jo lotin që del së koti
Nga urrejtja...(Poezia"Loti").

Në të vërtetë udha e lotit bëhet një udhë metaforike që afron në vazhdën e saj shumë pamje prej të cilave poeti merr shkas:mërgimi,(temë mjaft e trajtuar),politika,diferencat sociale,padrejtësitë,hajnat,vrasësit etj.

Poezia përkushtuese është një arritje për Bajramin,se Bajrami i tillë është edhe si njeri:I përkushtuar ndaj njeriut,bujar,i sinqertë,fjalëmbajtës.Sa bukur shkruan ai për figurat e martirizuara ,ku lartësohet profili dramatik i tyre,për miqtë,për Basir Bushkashin,Mati Arefin,Esat Rukën,Agron Sejaminin,-Faik Xhanin,për Kosovën e bijtë e saj të mëdhenj:Ibrahim Rugovën,(prej tij edhe pëllumbi merrte butësi),Ramush Haradinaj,Ashim Thaçin,Kadri Veselin,për Mitrovicën(shpatull e thyer) ,për Preshevën(Krah i prerë),por jo vetëm, edhe për Matin,vendlindjen e tij ,si tokë të mbretërve dhe poetëve,për peizazhet e Ulëzës e malet,për gjurmët e Skënderbeut e Shën Trininë.

Dhe kështu libri e zgjeron kontekstin tematik,merr frymë jo vetëm përmes tij,por edhe prej fjalës së gjetur e këndvështrimit autorial mjaft origjinal.

Mund të përmendim disa poezi të cilat vetiu të ftojnë për rilexim:Kosovë hyjnore,Mitrovicë shpatull e thyer,Adem Jasharit,Mbret i dhimbjes,Akademik Tahir Mata,Bajram Currit,Shahin Doçit,Mati Arefit,Diamant(për Basir Bushkashiin),Dilaver Kurtit,Mevlud Bucit,Faik Xhanit, e plot të tjerëve.

Poezia e Canametit të fton për rilexim se ai ka ditur të krijojë e profilizojë me mjeshtëri veçorinë që ka secili,duke e parë tjetrin me dashuri e zgjuarsi,plot finesë e zotësi.

Si një kurorë e vëllimit vjen poema "Kohë e trishtë",një realizim estetik i epërm,me një ritëm nolian, plot realizëm e gjetje të mrekullueshme,një nga poemat më të mira të kohëve të fundit.

Jetë e fikur,jetë e mjerë,
Dhe pleqtë me sytë nga udha,
Nga dhimbja jeta do bjerë,
Të ndriçojë ato rrudha...(Poema "Kohë e trishtë").

Udhëtimi epiko-lirik rrëfen për muzë e muzikalitet me ngrohtësi,tejpamësi e vrull ndiesor.Vargu i Canametit flet për një shpërthim të strukturës së vjershës,ai është herë i matur e herë i lirë,organizuar vetishëm nga një mendim i qartë dhe një frymëzim spontan.Ai di t`i japë vargut shumëçka nga fantazia e tij,realiteti përjetues nga natyra e një artisti mendje hapur me profil emancipues.Herë- herë të kujton një Çajup matjan me nervin e satirës dhe rrjedhshmërinë e vargut.I eksploron mirë ngjyrat e vendlindjes përmes peizazheve të saj dhe ndërton në lartësi një tonalitet historiko-patriotik të kohës e të kohërave duke i ndërlidh idetë e duke i prurë në hullitë e atdhedashurisë.

Poet me kulturim vargu,me mendim,Bajram Canameti i bie kambanës së tij jo vetëm përmes dhimbjes,por edhe për t`u dëgjuar dhe me këtë vëllim ai dëgjohet jo vetëm si poet i spikatur i Matit,por edhe më gjerë,duke na sjellë një libër që të imonon respekt për fjalën krijuese të realizuar aq bukur.

traditë

Njeriu nuk kuptohet me vdekjen

Zoti, kur mësoi se ëngjëlli Xhebril po shkaktonte panik tek njerëzit, urdhëroi që ai të jetonte midis tyre, por me pamje të ndryshuar që të mos e njihnin. Por ata që dikur i ndruheshin dhe e urrenin, tani donin ta takonin për të mësuar sa më shumë rreth vdekjes, sepse vdekjet u bënë shumë të shpeshta, të pakuptueshme, të cilat vinin prej qindra shkaqesh, disa prej tyre mjaft banale. Karakateri mospërzgjedhes i vdekjes, që merr edhe ku nuk ka, që nuk mban radhë, erdhi duke u thelluar aq shumë, saqë u bë tronditës për njerëzimin. Nga vdekjet tek e tek, një këtu e një atje, një sot e një neser, u arrit tek vdekjet kolektive, kur në një çast, ndërrojnë jetë mijëra njerëz. Për këto arsye dhe për të tjera si këto, një burrë i lutej natë – ditë Zotit ta takonte me ëngjëllin Xhebril. Të afërmit i thonin të hiqte dorë nga kjo marrëzi, pasi Zoti vetë e kishte bërë Xhebrilin që të mos njihej, por ai nuk lëkundej nga asgjë. Dhe Zoti, më në fund, ia plotësoi dëshirën. I dërgoi një melek i cili i tha:

– Neser në mëngjes dil në udhë të madhe të katundit ; ai që do të kalojë me nji djep në krah është ëngjëlli Xhebril.

Doli ky burri neser heret në mëngjes, por aty nuk kaloi njeri tjetër me djep në krah, përveç një bashkëkatundari, të cilin nuk kishte përse ta ndalonte. Priti deri në mbrëmje, pastaj u kthye në shtëpi. Po besimi në Zotin në zemrën e tij nuk mori asnjë krisë. "Do të jetë ndonjë lajthitje imja, ja e melekut, se Zoti nuk gabon kurrë", mendoi më në fund dhe filloi të lutej prapë tek Zoti që t'ja plotësonte dëshirën. Po bash pse mendoi ashtu, Zoti ia dërgoi sërish melekun i cili i tha:

– Pse nuk e takove dje ëngjëllin Xhebril?

– Ai që kaloi me një djep në krah, ishte një bashkëkatundari im, të cilin e takoj dhjetë herë në ditë. Nuk kaloi asnjë njeri tjetër me djep në krah.

– Kë ka qenë ëngjëlli Xhebril, pasi ai transformohet dhe merr fytyrën e pamjen e cilitdo. Neser mund të shfaqet me një fytyrë dhe me një trup tjetër.

– Këtë nuk e kam ditur. Faleminderit Zotit, faji është imi.

– Neser dil prapë në udhë të madhe.

Të nesermen ai doli prapë në udhë të madhe dhe priti një copë herë të mirë derisa kaloi andej një burrë i panjohur me një djep në krah. E ndali dhe e pyeti:

– Ku po shkon kështu, o njeri?

– Për punë, – u përgjigj ai.

– A të vij me ty?

– Eja, po qe se nuk ke ç'bën tjetër.

U bënë bashkë dhe u nisën. Ecnin pa folur. Pas një ore udhë, arritën në një vend shumë të bukur: një livadh ende i bleruar, edhe pse vjeshta kishte trokitur. Livadhi ishte rrethuar me një gardh hidesh, me plepa të gjatë të bardhë, që e kishin lëvoren të lëmuar si vezët e pëllumbit. Një djalë i ri, rreth të njëzetave, kishte nisur punën për të prerë një trung arre. Nga brezi e lart ishte zhveshur i tëri dhe kishe qejf ta shikoje trupin e tij me një zhvillim të përsosur dhe harmonik. Nuk punonte as shpejt, as ngadalë. Bënte punë me një ritëm të caktuar, shprehje kjo e njeriut të fuqishëm, energjik dhe me vullnet. Kur i binte trungut të arrës me sopatë, bujashkat fluturonin disa metra tutje dhe përhapeshin nëpër livadh si tjegulla të vogla të bardha. Xhebrili u ndal në mejën e arës dhe po vështronte djalin. Në jetë nuk ka gjë më të bukur se sa forca, kur ajo është e pajisur me të drejtën dhe arsyen, siç nuk ka gjë më të urryer se forca, kur ajo nuk ka të drejtë dhe arsye.

Burri qe ishte me Xhebrilin, i mbante sytë tek djaloshi, që kishte hijeshi dhe forcë të madhe. Xhebrili filloi të mërmëriste diçka nën vete. Burri nuk ia merrte vesh fjalët, por vetëm shikonte lëvizjen e buzëve të tij. Pas dy – tre minutash ai heshti. Dukej mjaft i lodhur sikur të kishte mbajtur gurë në krah. U kthye me fytyrë nga shoku i rrugës dhe tha:

– Mbaroi dhe kjo punë.

– Cila punë? – e pyeti ai.

– Bëra një lutje Zotit që ky djali të vdesë sonte. Zoti e pranoi lutjen time.

– Si kështu, po a i merret jeta këtij djali?

– Këto janë punët e Zotit. Ne nuk kemi përse përzihemi në punët e Tij. Unë vetëm shikoj sa ua ka përcaktuar Ai jetën njerëzve. Nuk paksoj as shtoj gjë. Por, kur dikujt i sosen varrat, që i ka caktuar Zoti, unë i bëj lutje Atij. Me një fjalë, vetëm ia kujtoj atë që e ka vendosur Ai.

Si tha këto fjalë, vuri djepin në krah dhe u nis prapë për udhë. Burri i shkonte prapa, por pa qejf. E kishte zemrën të vrarë pasi ai djalë do të vdiste atë natë. Bënë edhe një orë udhë dhe ëngjëlli Xhebril u ndal anës së një vije uji. Matanë vijës, si nja njëzet metra më larg, ishte një shtëpi. Nën strehën e asaj shtëpie nën rrezet e vakta të diellit të vjeshtës, rrinte një plak kaq i vjetër dhe kaq i rrëgjuar, sa të vinte keq kur e shikoje. Atij jeta i ishte rënduar shumë dhe vdekja për të do të ishte shpëtim. Xhebrili filloi të pëshpëriste me vete si një orë më parë. "Këtu po bën punë me mend", tha me vete burri. Po ëngjëlli Xhebril u kthye nga bashkudhëtari dhe i tha:

– Ky plaku, me urdhër të Zotit, do të jetojë edhe dhjetë vjet. Vdekja e kërcënon, por jetën ia ka caktuar Zoti.

Burri u trondit aq shumë sa kujtoi se nuk kishte dëgjuar mirë. Pastaj, si e mori veten, tha:

– E Zotit shkoftë përherë. Po me ty nuk mund të rri më!

Dhe u ndanë. Nga ajo ditë e deri me sot përpjekja e njeriut për ta kuptuar vdekjen ka dështuar.

(Marrë nga libri "Kanuni i Dibrës", Xhafer Martini, Botimet M&B, Tiranë, 2016)

Anekdota

Mblodhi: Shaqir Skara

Jepi ujë kalit

Një udhëtar, hipur mbi kalë, u ndal tek një bunar në qoshe të fshatit me i dhanë ujë kalit. Aty ishte një nuse e re tue la tesha. Kjo i hapi vend udhëtarit me pi ujë kali, e udhëtari jabanxhi, duke pa nusen, filloi me fishkëllye.

Atëherë kjo nuk duroi ma, por mori një kovë me ujë të nxehtë edhe ia hodhi udhëtarit fytyrës, duke i thanë:

- Jepi kalit ujë e mos fishkëlle në bunar të huej!

Një burrë e dy gra

Për udhe ishin tre veta. I kishte marrë uria dhe u ndalën në shtëpinë më afër fshatit. Nusja e shtëpisë u doli në derë:

- Oj motër, a i ke burrat në shtëpi?

- Nuk i kam, por tani vijnë, por ju hajdeni brenda!

- Jo, jo brenda nuk vijmë, po vetëm na jep pak bukë në dorë!

- Besa, bukë në dorë nuk po u jap, por hajdeni brenda!

Pasi hangrën bukë, nusja i nxori deri në oborr. Në këtë kohë erdhi edhe i shoqi i kësaj shtëpie bujare. Pyeti gruen:

- Kush ishin ata që përcolle?

- Qe një burrë me dy gra, - foli nusja.

- Po ata ishin tre burra, unë i pashë me këta dy sy!

- Ai burri që u printe përpara, hangri bukë pa e çue kryet fare. Ata dy të tjerët mbetën pa ngranë bukë, tue më pa mue, - i foli nusja.

Tahmaqar mbi tahmaqar

Në fshat e njihnin të gjithë për tahmaqar. Kursente kudo e çdo gja. Një natë i shkon një mik për darkë. Ky, në fakt, nuk e deshi, por nuk pati çfarë me ba. Kishin ndodhë tahmaqarë të dy. Kur miku pa se u errësua dhe zoti i shtëpisë nuk po e ndizte llambën për të kursyer vajgurin, ma së fundmi hoqi tirqit që kishte veshë. I zoti i pas pak foli:

- Or mik, a ta ndezi llambën?

- Prit pak, sa t'i veshi tirqit, se i hoqa mos më prishen për mutafi!

- Vallahe, paska ma tahmaqar se unë! - foli i zoti i shtëpisë.

Hallall lopa me gjithë viç

Pas një dasme të madhe që banë në fshat, kur martuan djalin e vetëm që kishin, burrë e grua po bisedonin në shtëpi dhe bënin llogari borxhet që kishin për të paguar.

- Dasma na doli e mirë dhe të gjithë mbetën të kënaqun! - foli gruaja.

- E mirë e mirë, po borxhe kemi shumë dhe vështirë me i pague të gjitha!

- Shesim lopën, more burrë, e borxh kujt nuk po i rrimë, veçse të na dalë nusja e mirë.

Djali e dëgjoi gjithë bisedën në dhomën e tij.

- Hallall lopa me gjithë viç, se nusja na ka dalë e mirë, oj nanë! Vetëm borxh mos i rrini kujt!...

Si dava në venisht

Një natë i zoti i shtëpisë u ndau detyrat të gjithëve për ditën e nesërme.

-Ti, Davë, nesër do të shkosh në Venisht! - i tha. E Dava si Dava ma, se ishte pak i metë, ra në gjumë herët me mendimin se nesër do të shkonte në Venisht.

Nesër në mëngjes, pa pyetur asnjeri, u nis herët. Shkoi Dava në Venisht dhe u kthye i gëzuem se kishte përfunduar para të gjithëve detyrën që i kishin ngarkuar. Kur u kthye, i zoti i shtëpisë i pyeti të gjithë me radhë për detyrat që kishin mbaruar:

- Po ti Davë?

- Unë isha, babë, në Venisht!

- Po çfarë bane atje?

- Shkova, si më thae ti dhe u ktheva prapë.

Ende sot përdoret shprehja: "Shkon si Dava në Venisht"

Plegëria më e rëndë se çdo gjë tjetër

Në një odë në Shumbat ishin mbledhë shumë burra të mençur edhe nga katundet përreth. Në atë konak ndodhej edhe Xhetan Lima, një plak i bëshëm e që i kishte lezet konaku. Pas do kohe e merr fjalën Majrë Skarrra dhe e pyet:

- Desha të di, o Xhetan, se ç'gja asht ma e randë në këtë jetë?

- Asht toka, - foli Xhetani hazër xhevap.

- Unë them se asht fukarallajku, - ndërhyni në bisedë Qerim Leka.

- Unë them se as njana, as qetra nuk janë ma të randa se pleqnia. Kësaj nuk ke se çfarë i ban. Ka kohën dhe vjen pa të pyetur, - e mbylli bisedën Majra.

Të gjithë s'kishin ç'të flisnin më. Ishin të një mendimi me fjalët e këtij plaku të mençëm.

Legjendë

Thana e skënderbeut

Në fshatin Sinë ndodhen shumë toponime që lidhen me heroin tonë kombëtar, Gjergj Kastriotin, Skënderbeun. Një toponim i tillë është edhe "Thana e Skënderbeut". Thonë se pikërisht në këtë vend kulloste kali i Skënderbeut, në ditë pushimi, kur kryetrimi nuk kishte beteja. Kali hante e ujë s'pinte, pasi ishte toka e tillë që mbante ujë. Po si dhe pse i mbeti ky toponim? Legjenda thotë se në kohë shumë të hershme, edhe para epokës së Skënderbeut, fshati nuk ishte këtu ku është sot, por ndodhej shumë më poshtë.

Në fshat nuk kishte asnjë burim uji, ku njerëzit ecnin me orë për të gjetur ujë të pijshëm. Gratë e fshatit, ngaqë lodheshin shumë, filluan të dërgojnë një grua nga fshati, e cila ishte e urtë, e sjellshme dhe e papërtueshme e që nuk dinte t'i thoshte njeriu jo. Pikërisht, kjo grua, filloi të sjellë ujë për fshatin ditë me radhë, edhe pse ishte larg. Ajo shkonte e vinte në mënyrë të shpejtë, sa për njerëzit e zakonshëm ishte e pabesueshme. Një ditë e pyetën fshatarët:

- Po ku e mbush ujin ti?

- Ja atje sipër dhe u tregonte një kodër. Fshatarët e morën pas këtë gruan e mirë dhe ec e ec, por rruga nuk po mbaronte.

- Po ku është, moj, burimi? - i thonë fshatarët.

- Ja, ja, matanë. Pas një ore e ca rrugë më së fundi arritën, por aty nuk kishte fare ujë.

- Hë, pa na thuaj, ku e mbush ujin ti?

- Ja këtu tek trungu i thanës! - dhe uli dy shtambat, të cilat filluan të mbushen me ujë të pastër si kristali. Shtambat u mbushën e fshatarët çuditeshin se aty nuk kishte ujë fare. Filluan nesër gratë e fshatit të shkonin për ujë, por aty ujë nuk kishte. Sa herë që shkonte kjo gruaja e mirë, shtambat e saj mbusheshin me ujë. Edhe sot e kësaj dite, pikërisht në këtë vend, thonë se po të rrinë bagëtitë gjatë në kullotë, nuk kanë nevojë të pinë ujë! Ndoshta ...

Rruga e Arbërit nr. 195-196.
arsim

Shkolla e Ploshtanit duke marrë emrin e respektuar "Ramadan Gjorllaku" është një nder që i bëhet jo vetëm kësaj shkolle, por gjithë arsimit e banorëve të zonës Kala e Dodës.

Shkolla e Ploshtanit merr emrin e respektuar **"Ramadan Gjorllaku"**

Nga **METUSH SKEJA**

Këtë takim do ta quaja bisedë mes miqsh për kolegun, shokun e mikun tonë Ramadan Gjorllaku, që megjithëse nuk jeton na mbledh neve për ta kujtuar.

Shkolla e Ploshtanit duke marrë emrin e respektuar "Ramadan Gjorllaku" është një nder që i bëhet jo vetëm kësaj shkolle, por gjithë arsimit e banorëve të zonës Kala e Dodës.

Unë e kam pritur me emocion të veçantë këtë festë, pasi kam punuar me Ramadanin, duke respektuar personalitetin Ramadan Gjorllaku ne të gjithë respektojmë dijen, mësuesin, vetveten.

Duke menduar të shkruaj këto rreshta, aq më shumë e kuptoja se ishte e vështirë, pasi Ramadan Gjorllaku ishte personalitet kompleks, me prurje të shumta, si një lum që shpeshherë uji të del nga shtrati tij se nuk e mban dot, me temperament sanguine e të ekuilibruar, vende vende kolerik e i rrëmbyer.

Kjo që bëjmë sot është vetëm fillimi, fjalimet nuk janë aspak shterruese. Për Ramadan Gjorllakun do të flitet e do të flitet në të ardhmen. Që kur hyri në klasë të parë e më pas gjatë gjithë jetës nuk u nda nga librat, shkolla e arsimi, vetëm vdekja e ndau. Për 37 vjet i shërbeu zonës e kultivimit të fëmijëve për t'i bërë të aftë për jetën, për t'u nxitur e vënë në punë rezervat mendore të tyre të dhënë nga natyra, me një devotshmëri gati religjioze.

Unë vazhdoj të besoj se në formimin tonë si qenie të ndërlikuara sociale ndikojnë faktorë historik, edukativ, mjedisor e gjenetik. Në këtë këndvështrim do ta shikoj edhe formimin e Ramadanit.

Zona Kala e Dodës është e banuar herët, por me siguri që në shekujt e parë pas krishtit. Këtë na tregojnë kishat katolike të periudhës romake që gjenden në çdo fshat, e ndonjë vend ka edhe dy, që tregon se populllsia ishte e dendur. Fortesa kala është e periudhës së justinianit. Vetë emri kala mbart në vetvete për banorët e saj një simbolikë.

Gjatë sundimit osman në kala në fshatin Ploshtan mbaheshin kuvendet e gjithë krahinës së Lumës deri në vitin 1830, kur zhvendoset në Bicaj. Por kuvendet e 4 bajraqeve përsëri mbaheshin në Ploshtan te kalaja. Vendi organizator gjithnjë ka pluset e veta.

Dokumentat osmane tregojnë se zona jonë kishte një milion bagëti të imta në atë kohë,pasuri kjo që asnjë zonë tjetër nuk e kishte. Kjo është njëra anë. Kalaja kishte e ka pasuri shpirtërore sa ekonomike. Do të përmend vetëm një. Studiuesit kanë regjistruar afro 500 këngë burimore që këndohen në të gjithë trevat ku ka shqiptarë. Banori kësaj ane dinte të ruante delet, të mësonte fëmijët në mejtepet e kohës, të bënin tregti, të thurte këngë e vargje. Në këto këngë ka vargje me bukuri



të jashtëzakonshme të krijuar nga gjenia artistike e këtyre njerëzve.. Fisi Flisi i Ploshtanit për një kohë të gjatë kishte qenë bajraktar i bajrakut të Qafës. Kontributi i zonës Kalasë e Radomirës në betejën e Drinit nëntor 1912 është vendimtar për fatet e kësaj lufte. Në periudhën e mbretërisë shqiptare e më pas në regjimin komunist deri 1953 Ploshtani ishte qendër komune e lolaliteti ku përfshiheshin 16 fshatra. Duke qenë qendër shkolla e parë shqipe hapet në Ploshtan më 1922, po edhe shkolla e parë shtatëvjeçare më 1957 ku pati fatin të mësonte Ramadani

Fisi Gjorllaku ishte fis fisnikësh. Gjyshi i Ramadanit, Tefik Gjorllaku ishte imam i fshatit, kishte përcjellë në mënyrë aktive ngjarje me rëndësi kombëtare. Molla Mera është ndoshta shembulli i vetëm duke mbrojtur para femohuesive e fendaluesive të kohës shenjtërinë e besimit e të drejtuesit saj. Me prona në Prizren që ishte një ndër qytetet më të mëdha të Shqipërisë. Është i vetmi fis në krahinën e Lumës me hotel. Te dhoma e burrave të Molla Tefikut mblidheshin njerëz për kuvend, që me argumentat pro e kundra shkohej te e vërteta e racionalja. Studiuesit i kanë quajtur odat shkolla, parlamente, biblioteka. Të lindje këtu ishe me fat. Në këtë mjedis lindi shoku ynë Ramadani. Ky mjedis social, familja e shkolla janë socialigjizimet e para të tij.

Ai ishte krenar për vete, familjen, fisin e krahinën e tij.

Humbjen e hershme të atit e plotësojnë gjyshi, xhajet e sidomos nëna e tij fisnike.

Perëndia Ramadanit i kishte dhënë shumë, trupin e pamjen e bukur, mendjen e shpirtin e bukur që vetë e plotësonte me sjellje, karakter e veshje të bukur, vetëm jetën jo të gjatë, ndoshta është sekreti saj që s'ti jep të gjitha.

Në moshën 17 vjeçare fillon punën si mësues në Radomirë. Vazhdon shkollën e mesme e më pas të lartën që nuk e përfundon. Nxënësit e tij dalloheshin dhe e me krenari thoshin se jemi nxënësit e mësues Danit.

Unë shumë vite më pas kur Dani nuk ishte hapja dokumentet shkollore me lehtësi dalloja shkrimin e tij më shumë se të bukur dhe më binte në sy profesionalizmi me të cilat kishte plotësuar dokumentat. Unë kam punuar e mësuar prej tij.

Për 36 vjet punoi në arsim pa u lodhur, jashtzakonisht korrekt e i përkushtuar. Ai nuk ishte vetëm mësues, por ishte i pranushëm e i pëlqyer nëpër oda e mjedise sociale. Ishte elitë e kishte klas.

Dani kishte sens praktik në njohjen e psikologjisë së grupmoshave, psikologjisë së të mësuarit e edukimit, njohje shkencore e zbatim rigoroz të metodikave të mësimdhënies. Ky dhe përkushtimi ishte suksesi i tij në punë.

Ne mësuesit, nxënësit e banorët e kësaj zone jemi të vlerësuar sot e në të ardhmen me emrin e nderuar Ramadan Gjorllaku që i jepet shkollës së Ploshtanit. Ky emër përfaqëson punën, djersën, sakrificat e mësuesve dhe nxënësve që nga hapja e shkollës shqipe më 1922, sot e në të ardhmen.

Çdo prind, nxënës, mësues të jetë mik i dijes e shkollës siç ishte Ramadani, se edhe dituria do t'i bëjë miq të saj, binom ky pa të cilin jeta s'ka kuptim. Ne sot jemi mbledhur këtu pikërisht se Dani ishte mësues e i ditur. Emër më të mirë se Ramadan Gjorllaku nuk mund të gjendet.

"Jehona e Shqipes" dhe **Sakip Skepi** si histori suksesi!

vijon nga nga faqja 15

"JEHONA E SHQIPES" NJË DRITARE PËR POLITIKANË, ARTISTË, SPORTISTË DHE GAZETARË. VLERËSIMI NGA MEDIAT E HUAJA

Në radion "Jehona e Shqipês" të ftuarit e nderit kanë qenë për të folur shumë personalitete. Para vitit 90, pretendenti i fronit Shqiptar Leka ZOGU I e kishte si një dritare të tijën. Ndër personalitete e intervistuar në radio ndër të parët nga mikrofoni i Sakip Skepit është edhe Presidenti i nderuar i shqiptarisë

Ibrahim Rugova i cili ka dhënë disa intervista, pa harruar që radio si dritare ka qenë edhe për të tjerë si; Rexhep Qosja, profesor Zekria Cana, Femi Aganin si dhe Anton Çetën dhe shumë të tjerë nga Kosova. Ndër të intervistuarit janë edhe personalitete shumë të respektuar, si Mentor ÇOKU dhe Sami Repishti etj. Radio "Jehona e Shqipës" ka bashkëpunuar regjisoren Liria Begeja në realizimin e filmit të parë, me tematik shqiptare jashtë vendit " Prill i Thyer" në Korsikë, me artistë të ardhur nga Kosova dhe Franca. Radio ka siguruar 110 Figurantë nga Belgjika dhe Franca. Pas rënies së regjimit komunist në Shqipëri shumë personalitete, të artit e politikës kanë kaluar sa në studio, ose nëpërmjet telefonit. Disa prej tyre janë: Ismail KADARE; Dom Simon Jubani, Dom Lush Gjergji (Prift dhe themelues i Shoqatës bamirëse në fund të viteve '80 "Nanë Tereza" në Kosovë) Timo Flloko, Mirush Kabashi, Arif Vladi, Liri Rasha, Merita Halili, Zef Deda, Tefta Radi, Saimir Kumbaro, Isa Qosje, regjisor nga Kosova dhe shumë e shumë të tjerë. Me shembjen e Murit të Berlinit, në studion e radio "Jehona e Shqipes" kanë qenë përfaqësues të televizioneve të njohur perëndimore, si televizioni kryesor belg "RTBF" si dhe veprimtaria e radios në gjuhën shqipe është pasqyruar disa herë në edicionin e lajmeve qendrore."Nder shumë të madh na ka bërë edhe Televizioni francez "TF1 "(Televizioni Numër 1 në Europë). Ata na erdhën në studio dhe dhanë kronikën mbi radion tonë në edicionin qendror të lajmeve në orën 20h dhe 23h. Radio ishte i vetmi burim,

për ta që të sillnin lajme nga Shqipëria për zhvillimet politike. Mos të harrojmë se Shqipëria ishte e fundit që ra nga blloku komunist" - thotë Sakip Skepi. Autoritetet Belge e kanë respektuar dhe e respektojnë Radion. Për çdo fushatë zgjedhjesh (sepse dhe në Belgjikë ka shpesh zgjedhje) shkojnë politikanë të rangut të lartë për të promovuar politikën e tyre. Në Belgjikë tani ka një diasporë të madhe shqiptare dhe ata kanë nevojë për votat e tyre. Edhe sot që flasim në radio "Jehona Shqipes" vazhdojnë të hyjnë e dalin çdo të diel gazetarë, shkrimtarë, politikanë, ambasadorë, artistë, biznesmenë. Radioja vazhdon me mision kulturor, pa shkëputur kurrë fijet nga aktualiteti shqiptar, që çdo të diel flet shqip në Jehona Shqipes, e cila mbetet ajo që ka qenë këtu e 32 vjet të shkuara, pavarësisht se në Bruksel gjërat ndryshojnë ditë për ditë. E diela jo!

homazh

Lamtumirë nxënësi, shoku, miku im **Enver Laçi!**

Kur mësova, më 30 nëntor 2021, se nxënësi, shoku dhe miku im Enver Laçi me rrënjë në kullën tre katesh majë kodrës që sheh tërë luginën e lumit të Mallës, kullë që kisha bujt e kisha pirë kafen e veçantë që pjek Reçi, ishte i sëmurë, madje rëndë i shtruar në spital, siç më shkruante shoku i tij i ngushtë i shkollës bujqësore të Peshkopisë Hamza Hyka nxora nga shpirti urimin: SHËRIM TË SHPEJTË ENVER LAÇI !

Shkrova...

Mësova se je sëmurë miku im, nxënësi im, shoku im ENVER LAÇI

Më nderove si askush me ardhjen tënde për të më takuar në gusht 2021, në ditët e mija të pushimeve.

Bëmë edhe një foto bashkë. Po ta dërgoj.

Biseduam që verën e ardhshme të takohemi përsëri. Të pimë kafe e të udhëtojmë në Gjurë Reç, të ngjitemi në kullën në tre poda të

Suf Laçit, gjyshit tënd e të bisedojmë shtruar për kohët e njerëzit.

Kemi shumë për të folur e për të shkruar.

E di që do të vish!

Mirë u takofshim!

Abdurahim Ashiku
Athinë 30 nëntor 2021

Nuk qe fati të takohemi përsëri. Të realizonim ëndrrën e shprehur atë ditë.

ENVER LAÇI iku.

Lajmi i zi, me dhimbje dhe me lot në sy më erdhi mbrëmë nga miku i tij dhe imi Hamzai...

Ai më shkroi:

Mirëmbrëma!

Me hidhërim të thellë i u bëj me dije se u nda nga jeta Enver Laçi. Varrimi është lënë për nesër e enjte 20 prill ora 15. 00 në Yrshek të Kasharit

Numri i telefonit i Benard Enver Laçi është +355684110124

T'i rrojnë ç'ka lënë pas!

U prehtë në paqe.

I paharruar qoftë !

Fola me Benardin.

Ndjeva zërin që i dridhej, dhimbje që përjetonte.

Ikja e prindit nuk mund të ngushëllohet me asnjë fjalë...

Kërkova në arkivin tim fotografik.

E desha Enver Laçin të gjallë e të shëndetshëm, të gëzuar e plot humor si në takimin e mrekullueshëm në 70 vjetorin e Xhevat

Danit, si në kafen e fundit me të në gusht 2021...

Po e shoqëroj edhe me një moment humori dhe dashurie shokësh shkolle në një ditë të gëzuar në 70 vjetorin e Xhevat Danit me

titull: ENVER LAÇI SHTATËDHJETË VJEÇ... Enver Laçi ishte i gjallë, i dashurisë mes njerëzve, i humorit dhe respektit.

Lexojeni dhe merrni edhe ngushëllimet e mia...

Abdurahim Ashiku
20 prill 2023

ENVER LAÇI SHTATËDHJET VJEÇ...

Kush e gjen se çfarë dite ka qenë kur ka le Enver Laçi?

Enveri, atë ditë të bukur 9 gusht 2019, mes gëzimit të 50 vjetorit të maturës së shkollës së mesme "Nazmi Rushiti", në tubimin me rastin e 70 vjetorit të ditëlindjes së shokut të klasës Xhevat Dani e nisi bisedën me humorin karakteristik të tij me pyetjen në publik: "KUSH E GJEN SE ÇFARË DITE KA QENË KUR KA LE XHEVAT DANI"...

"...Të flasësh në një moment gëzimi është e vështirë. Unë do t'ju mërzis nja pesë minuta.\Në funksion të fjalës që mbajti vëllai, shoku im Ismet Boka. Diogjeni i famshëm, filozof i lashtësisë greke që ka vdekur në vitin 327 para Krishtit një ditë del në Athinë me një fener të ndezur.

E ndalin në rrugë dhe e pyesin se ku po shkon...

Zëra: Është e vërtetë kjo?

Po kërkoj një njeri...

Zëra: Kam hall mos na rrejë që tashti...

Jo, jo. Ky është njeriu, shoku, kolegu, drejtuesi i ndërmarrjeve dhe kooperativave. Xhevat Dani i biri i Shefkiut dhe Servetes ka lindur më 9 gusht të vitit 1949. Kush e gjen se çfarë dite ka qenë?....

Ka qenë ditë e martë... Krisi pushka dhe tha lagjja se i ka le një voc Shefki Danit. U flasin edhe daxhat në Gjoricë ke Leket se është fati që unë e dua shumë dhe...

Dy data mbaj mend unë.

Zëra: Mos na i ço dy gishtat lart se...

Dy data mbaj mend unë nga e marta, Lindja e Xhevat Danit në shekullin e 19-të dhe rënia e Kostandinopojës më 29 maj të vitit 1453.

Zëra: Me Xhevatin domethënë kombinon?

E marta nuk është ditë terse, është besëtytni pagane prandaj ty të ka ecë kaq mbarë. Elementi tjetër i gëzimit në këtë trapezë është se, siç tha Ismeti u hap një dritare e re për të parë kapacitetin kulturor të familjes dhe atë elementin tradicional që shumëkund mungon. Më të respektuarin këtu në trapezën tonë janë jabanxhinjtë jashtë Dibre që fillojnë me shkodranët se me Tiranën kemi simbiozë, me Gjergj Tonin, Engjëllin, Zefin, Ramizin nga Kruja, Halilin, demokrati im...

Pjesëmarrja e një mësuesit tonë, nuk e kishim pritur që profesor Ashiku të jetë pjesëmarrës në gëzimin tonë.

Gëtja i famshëm, gjermani Gëte thotë:***Zëra: Obobo, filloi...***

Zëra: Gjermani i fundit kur ka ikë...

Zëra: Më 28 nëntor...

Zëra: Nuk ka qenë luftëtarë Gëtja or ti...

Edhe Marksi e ka cilësuar gjermani më i madh... Johan Gëte thotë: Të gjithë ata që na japin mësim ne, presje, vërtet quhen mësuesit tanë, por jo të gjithë e meritojnë emrin të tillë. Profesor Ashiku bën pjesë në elitën e mësuesisë kombëtare. Nuk ia bëj kompliment sepse nuk kam asnjë interes. Pena e tij është me vlerë kombëtare e jashtë kombëtare. Dante Aligeri thotë një fjalë të drejtë: Ata që mbajnë qëndrim indiferent ndaj shoqërisë kur

ajo është në krizë sociale e kanë vendin në ferr. Ndërsa profesor Ashiku e ka përdorë armën - penë që nga artikulli i parë në numrin e parë të gazetës "Ushtima e maleve", ndonjëri s'e di, le ta mësojë, e deri në këtë moshë. Unë u befasova për rininë e tij që i ngjan një amerikani të cilët përdorin një fjalë: Amerikanët jetojnë gjatë por vdesin të rinj.

Unë: Mos vazhdo shumë se atëherë do të tregosh edhe historinë e tre mrekullive të Gjurë Reçit. A i din ato tre historitë?

Ai: Frigoriferi në shkëmb, burri me fustan dhe rrëzimi i sekretarit mbi saç... Rrofsh dhe na ftofsh në njëqindvjetorin e lindjes! Shëndeti i familjes Dani me gjithë brezat që ke...

Zëra: Ulu, ulu, shkurtoje pak shiritin...

Dhe paçim rastin që t'ju vijmë përsëri. Lum si ti për djem e vajza dhe për nipër e mbesa. Shëndeti i gjithë atyre që ne nuk i njohim por që i shohim sot këtu. Gjithë miqësia e gjakut që keni. Dhe kaq.

Hajde gëzuar Xhevat Dani!

Zëra: Të lumtë goja shoku Enver!"

* * *

Enver Laçi më 3 gusht më kishte ftuar në ditëlindjen e tij të shtatëdhjetë... Enverin e kam pas nxënës në shkollën e

mesme bujqësore "Nazmi Rushiti" një gjysmë shekulli më parë...

Enverin, kullën e Laçe në tre poda maj kodre, aty ku ndahet Gjurë-Reçi me Arrmollën, e kam në sy, në mendje, në shpirt...në gurët që e lartojnë, në trarët që ndajnë katet e mbajnë çatinë, në njerëzit aq mikpritës sa ta bëjnë borxh për tërë jetën. Me thënë atë të shpirtit doja që me Enverin dhe me shokët e tij të klasës të ulesha në Kullën e Laçe, atje ku lindi, atje ku u rrit, atje ku një ditë zbriti për tu shkolluar më lart e për tu bërë një njeri i ditur Enver Laçi...

Nuk qe e mundur...

Enveri tash ka zbrit ultësirave, atje ku ka më shumë bukë e më shumë punë... Shokët e Enverit, ata me të cilët jetoi dhe gëzoi katër vite të bukura të shkollës së mesme, kanë vendosur që ditëlindjet ti festojnë bashkë atje ku jetojnë e punojnë, atje ku kanë burrëruar djem e vajza, atje ku marrin përdore nipër e mbesa. Vitin e kaluar vendosën që ditëlindjet ti bëjnë duke më vënë në krye të vendit...

Jam i nderuar...

Madje, për të më lehtësuar mua thanë që ditëlindjet do ti bëjmë njëra pas tjetrës në muajin gusht të çdo viti...

Jam i respektuar si asnjëherë...

Ftesën ma përcolli organizatori, njeriu që tash sa vite për gëzime (por edhe për hidhërime) i bashkon në këngë dhe në lot, Hamza Hyka. Ai më shkroi:

Përshëndetje,

Uroj të jeni mirë familjarisht.

Herë pas here dhe shpesh herë kemi lexuar postimet tuaja në facebook, kemi pëlqyer apo dhe komentuar për ato.

Desha të di a vjen dhe kur vjen për pushime në Golem se me datë 3 Gusht Enver Laçi bën 70 vjetorin.

Enveri dhe koleget e tjerë duan të dinë për pjesëmarrjen tënde...

Më fal Enver Laçi...

Më fal Hamza Hyka...

Më falni nxënësit e mi...

Do të vija me vrap e me dëshirë të madhe...

Do të vija se ju nderoj dhe ju dua shumë...

Më falni po nuk mund të vij...

Nuk më lënë me ardhë...

Më dhemb zemra...

Më digjet shpirti...

Qëndroni bashkë...

Me zemër e shpirt siç keni qëndruar gjithnjë...

Kjo flamë do të kalojë.

Me siguri do të kalojë...

Dhe bashkë do të gëzohemi në ditëlindjet tuaja...

Dhe tash po u pyes: A iu përgjigj kush pyetjes:

KUSH E GJEN SE ÇFARË DITE KA QENË KUR KA LE ENVER LAÇI?

Ma tregoni... Më gëzon e më jep krahë.

Abdurahim Ashiku

Athinë, 10 gusht 2020

HOTEL CAMI

HOTEL CAMI

Shijoni magjinë e Dibrës

Për rezervime
+389 (0) 70 241 205
+389 (0) 46 841 555
hotelcami@hotmail.com
Dibër, Maqedonia e Veriut

HOTEL CAMI

hotel_cami

cyan magenta yelloë black